

Rehabilitimi dhe riintegrimi jashtë kontekstit të burgut për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm

Udhëzues për politikëbërësit dhe ofruesit e
shërbimeve* në Evropën Juglindore



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë

Botuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

Vjenë, janar 2020

©OSCE 2020

Formatimi dhe dizajni nga designMind

Shtypja nga red hot n 'cool

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem apo transmetohet përmes asnjë mjeti apo forme - elektronike, mekanike, fotokopjimit, regjistrimit apo formave a mjeteve të tjera, pa miratimin paraprak me shkrim nga botuesit. Ky kufizim nuk do të jetë i vlefshëm për kopje digjitale apo të printuara të këtij botimi për përdorim të brendshëm OSBE-së, si dhe për përdorim personal apo për qëllime edukuese jofitimprurëse dhe jotregtare, me kusht që kopjet të njohin OSBE-në si burim të informacionit.

ISBN 978-3-903128-55-2

Departamenti i Kërcënimeve

Ndërkombëtare Sekretariati i OSBE-së

Wallnerstrasse 6, A-1010 Vienna, Austria

www.osce.org/atu

Botimi i këtij udhëzuesi u bë i mundur falë një kontributi bujar të qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Përmbajtja e këtij botimi, përfshirë pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në të nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve. Ky nuk është një dokument që ka për bazë konsensusin e 57 shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së.

Sekretariati i OSBE-së nuk mban përgjegjësi për saktësinë apo plotësinë e çfarëdolloj informacioni, për udhëzimet apo këshillat që ofrohen apo për gabime shtypi. Sekretariati i OSBE-së nuk mund të bëhet përgjegjës për humbje apo dëme që shkaktohen nga përdorimi i informacionit të këtij publikimi, si edhe nuk është përgjegjës për përmbajtjen nga burime të jashtme, përfshirë faqe interneti të jashtme, të cilave u referohet ky publikim.

osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë

U.S. OSCE
U.S. Mission to the OSCE

Rehabilitimi dhe riintegrimi jashtë kontekstit të burgut për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm

Udhëzues për politikëbërësit dhe ofruesit e shërbimeve* në Evropën Juglindore

* Për qëllime të këtij Udhëzuesi, ofruesit e shërbimeve janë profesionistët që ofrojnë shërbime (të specializuara) për rehabilitimin dhe riintegrimin jashtë kontekstit të burgut.

Përmbajtja

FALËNDERIME	5
AKRONIME DHE SHKURTIME	6
FJALORTH	7
PARATHËNIE	11
PËRMBLEDHJE	12
1. HYRJE	15
2. KONCEPTE KYÇE	23
3. VEÇORITË DALLUESE TË R&R JASHTË KONTEKSTIT TË BURGUT	29
4. KUADRI LIGJOR DHE I POLITIKAVE	39
5. PROCESI	43
6. NDËRHRYJET	57
7. OFRUESIT E NDËRHRYJES	65
8. MUNDËSIMI I SHKËMBIMIT TË INFORMACIONIT NGA SHUMË AKTORË NË MËNYRË TË EFEKTSHME DHE BASHKËPUNIMI	79
9. OFRUESIT QEVERTARË PËRBALLË OFRUESVE JOQEVERTARË	85
10. NDËRTIMI I KAPACITETEVE	89
11. KATEGORI TË VEÇANTA TË INDIVIDËVE: TRAJTIMI I SFIDAVE UNIKE DHE NEVOJAVE TË GRAVE DHE FËMIJËVE	97
12. PËRFUNDIM: PARIME KYÇE	107
SHTOJCA 1: MANUALE, UDHËZUES DHE INSTRUMENTE TË TJERA NË LIDHJE ME R&R NË KUSHTE JASHTË BURGUT	115
SHTOJCA 2: SHEMBUJ NGA QASJE TË NDRYSHME PËR R&R JASHTË KONTEKSTIT TË BURGUT NË RAJONIN E OSBE-SË	121
BURIME TË OSBE-SË	132
BIBLIOGRAFI	133

Falënderime

Departamenti i Kërcënimit Ndërkombëtar në OSBE (TNTD), Njësia e Masave kundër Terrorizmit (ATU) dëshiron të falënderojë Eric Rosand për rolin e tij në hartimin dhe shkrimin e këtij Udhëzuesi. Ky publikim dhe veprimtaritë që e kanë shoqëruar atë u përgatitën dhe zhvilluan nga ATU-ja nën drejtimin e Georgia Holmer, Këshilltare e Lartë për Çështjet kundër terrorizmit, Agnieszka Hejduk, Asistente Oficere e Programit; dhe Katerina Koçi, Asistente e Projektit.

ATU është mirënjohëse për bashkëpunimin dhe komentet e marra nga personeli i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Misioni në Bosnje-Hercegovinë, Misioni në Kosovë, Misioni në Malin e Zi, Misioni në Serbi dhe Misioni në Shkup, si dhe nga subjekte të tjera të OSBE-së dhe institucione që kanë ofruar kontributin e tyre tejet të vlefshëm. Falënderojmë edhe Nigel Quinney për mbështetjen editoriale.

ATU u shpreh mirënjohje për ekspertizën teknike dhe sugjerimet e dhëna personave të mëposhtëm, gjatë përgatitjes dhe rishikimit të këtij Udhëzuesi:

Torben ADAMS

Bashkëpunimi Ndërkombëtar për Korrektimin, Bremen, Gjermani

Maartje BUTER

Safety House, Hagë, Vendet e Ulëta

Christopher DEAN

Global Center, Identify Psychological Services, Mbretëria e Bashkuar

Hadelin FERRONT

De-Rad Center, Bruksel, Belgjikë

Johannes HEILER

Çështjet e Antiterrorizmit, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

Melinda HOLMES

Women's Alliance for Security Leadership (WASL) International Civil Society Action Network (ICAN)

Sofia KOLLER

Këshilli Gjerman për Marrëdhëniet me Jashtë, Gjermani

Ryan McEACHRAN

Trupa mbi Kuaj e Policisë Mbretërore, Kanada

D. Elaine PRESSMAN

Instituti Hollandez për Psikiatrinë dhe Psikologjinë Ligjore dhe Universiteti Carleton, Otava, Kanada

Vera TKACHENKO

Seksioni i Parandalimit të Krimit dhe Drejtësisë Penale, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin

Steve WEINE

Qendra për Shëndetin Global, Unversiteti i Illinoisit në Çikago, Illinois, SHBA

Ariane WOLF

Rrjeti për Parandalimin e dhunës, Gjermani

Akronime dheshkurtime

ATU	Njësia e Masave kundër Terrorizmit
CREST	Qendra për Kërkim dhe Evidencë për Kërcënime të Sigurisë
CI0	Kryetar i Radhës
CRC	Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
CTED	Komiteti i Kombeve të Bashkuara Kundër Terrorizmit, Drejtoria Ekzekutive Kundër Terrorizmit
CVE	Kundërvënja ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm
BE	Bashkimi Evropian
PR	Përfaqësitë Rajonale
LHT	Luftëtar i Huaj Terrorist
GCTF	Forumi Global Kundër Terrorizmit
ICCPR	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe ato Politike
ISIL	Shteti Islamik në Irak dhe Levant
LISC	Qeliza Sigurie të Integruara Lokale
MC DOC	Dokument i Këshillit Ministerial
OJQ	Organizatë joqeveritare
OJF	Organizatë jofitimprurëse
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
ODIHR	Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
PTSD	Çrregullime të stresit post-traumatik
P/CVERLT	Parandalimi dhe Kundërvënja ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që çon në Ekstremizëm
PVE	Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm
RAN	Rrjeti për Ndërgjegjësimin kundër Radikalizimit
RCC	Këshilli për Bashkëpunimin Rajonal
R&R	Rehabilitim dhe Ri-integrim
RCMP	Trupa mbi Kuaj e Policisë Mbretërore, Kanada
SAFIRE	Qasje shkencore për gjetjen e treguesve dhe reagimit ndaj radikalizimit
SNC	Konferenca e rrjetit social
TRAP-18	Protokolli për Vlerësimin e Radikalizimit Terrorist
TNTD	Departamenti i Kërcënimeve Ndërkombëtare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICRI	Instituti Ndër-rajonal i Kombeve të Bashkuara për Krimin
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNOCT	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Kundërvënien ndaj Terrorizmit
VERA	Vlerësimi i Rrezikut të Ekstremizmit të Dhunshëm
VERLT	Ekstremizmi i Dhunshëm dhe Radikalizmi që çon në Terrorizëm

Fjalorth

Ky Fjalorth ndihmon për qartësimin e disa prej termave kryesore të përdorura në këtë udhëzues. Përkufizimet në këtë Fjalorth janë vetëm për qëllimet e këtij udhëzuesi dhe nuk përbëjnë përkufizime zyrtare të OSBE-së

Masa alternative — një gamë masash që mund të përdoren si alternativë ndaj paraburgimit apo burgosjes pas dhënies së dënimit për individë të akuzuar, apo të dënuar, për shkelje që lidhen me terrorizmin. Këto masa mund të ndryshojnë në varësi të juridiksionit. Në kontekstin e paraburgimit, ato mund të përfshijnë garancinë pasurore, arrestin në shtëpi, monitorimi elektronik, lirimi me kusht që mund të kërkojë paraqitjen pranë forcave ligjzbatuese apo autoriteteve të tjera të drejtësisë penale. Në kontekstin pas dënimit, masat alternative mund të përfshijnë disa prej atyre masave të përdorura në kontekstin e paraburgimit, si dhe vendosjen në shërbimin e provës apo mbikëqyrjen gjyqësore, detyrimi për paraqitjen e përditshme, monitorimi elektronik në shtëpi, vendime të pezulluara apo të shtyra, shërbim në komunitet, dhe dëmshpërblimi.

Komuniteti — gratë, burrat, grupet shoqërore dhe institucionet që ndërveprojnë në fusha të njëjta dhe/ose kanë interesa të përbashkëta.

Shoqëria civile — grupime të aktorëve të ndryshëm joqeveritarë, komunitete dhe formacione shoqërore, të regjistruara zyrtarisht ose jo, që angazhohen në jetën publike për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe objektivave të përbashkëta.

Aktorë të shoqërisë civile — anëtarë të komunitetit, përfshirë gra, të rinj, udhëheqës fetarë dhe udhëheqës të tjerë të komunitetit, përfshirë ata që kanë një pozicion solid, me qëllim që të japin një kontribut që sjell ndikim dhe që zgjat në kohë për mirëqenien e shoqërisë.

Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm — veprime proaktive, joshtrënguese për t'iu kundërvënë përpjekjeve të ekstremistëve të dhunshëm për radikalizimin, dhe mobilizimin e ndjekësve të tyre në akte të dhunshme, si dhe veprime për të trajtuar faktorë specifikë që mundësojnë rekrutimin për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që çon në dhunë. Përpjekjet CVE nuk përfshijnë mbledhjen e informacionit apo kryerjen e hetimeve për qëllime të ndjekjes penale.

Kundërvënia ndaj terrorizmit — politikat, ligjet dhe strategjitë e hartuara nga aktorë shtetërorë dhe të zbatuara kryesisht nga organet ligjzbatuese, agjencitë e shërbimeve informative, dhe disa herë nga agjencitë e mbrojtjes, të cilat synojnë të vrasin apo të kapin terroristët, të zbulojnë dhe parandalojnë komplete terroriste dhe të çmontojnë organizata terroriste.

Heqje e lirisë — ky term u referohet burgjeve dhe konteksteve të tjera të ndalimit në të cilat liria e lëvizjes së individit kufizohet me anë të një urdhri nga gjykata.

Shkëputja — një proces social dhe psikologjik në të cilin angazhimi i një individit ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe përfshirja në të reduktohet deri në atë masë që ai apo ajo nuk rrezikojnë më përfshirjen dhe angazhimin në veprimtari të dhunshme. Ky proces përfshin ndryshim të sjelljes (nuk e përdor më apo nuk e përlligj përdorimin e dhunës), por nuk përfshin domosdoshmërisht ndryshim në angazhimin e individit ndaj një kauze radikale apo ekstremiste.

Deradikalizimi — procesi i ndryshimit të sistemit të bindjeve të individit në mënyrë që ai apo ajo të refuzojë ideologjinë ekstremiste dhe të përqafojë vlerat e përgjithshme, dhe jo të dhunshme të shoqërisë. Ai nënkupton një ndryshim themelor të të kuptuarit, që rrjedh nga veprimtari që kanë për synim të ndihmojnë individët që të heqin dorë nga idetë dhe bindjet radikale apo ekstreme, si dhe nga grupe që kanë lidhje me dhunën.

Ish-ekstremistët e dhunshëm “ishët” — individë të shkëputur nga rruga e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm, të cilët mund të luajnë rol të dobishëm për ndërgjegjësimin dhe tejçimin e praktikave të besueshme kundër terrorizmit.

Këndvështrimi gjinor — ndërgjegjësimi dhe shqyrtimi i nevojave, i përvojave dhe i statusit të të grave dhe burrave, bazuar në kontekstin shoqëror dhe kulturor.

Programet e ndërhyrjes — programe që u drejtohen personave apo grupe të personave “në rrezik” dhe synojnë të ndërhyjnë në rrugëtimin e një personi drejt radikalizimit terrorist, para se të kapërcehet vija e veprimtarisë kriminale. Programet janë, në mënyrë tipike, vullnetare dhe përfshijnë mbështetje psiko-sociale, debate teologjike/doktrinare, dhe trajnim dhe mbështetje për arsim dhe/ose punësim. Në kontekstin e shëndetit publik, kjo njihet si “parandalimi dytësor” dhe është në fokus të mekanizmave të referimit për P/CVERLT.

Pa heqje të lirisë — ky term u referohet programeve Rehabilituese dhe Reintegruese (R&R) që jepen jashtë kontekstit të burgut, si për shembull në komunitete apo si pjesë e masave alternative.

Programe parandalimi — programe të hartuara për të ndërtuar rezistencën e komuniteteve ndaj VERLT dhe kohezion social për t'i rezistuar joshjes së VERLT. Këto programe u adresohen komuniteteve të paradikualizuara dhe janë në forma të ndryshme. Në kontekstin e shëndetit publike, ky njihet si “parandalimi parësor”.

Shërbimi i provës — një hallkë kyçe e sistemit të drejtësisë penale për të rregulluar sjelljen e të dyshuarve dhe shkelësve duke u kërkuar të jenë të monitoruar deri në një masë të caktuar. Veprimtari dhe ndërhyrje tipike të shërbimit të provës përfshijnë mbikëqyrjen e sjelljes, ofrimin e udhërrëfimit, dhe dhënien e asistencës materiale, psiko-sociale, edukative, dhe të tjera. Shërbimi i provës ka dy objektiva të barasvlershme: nxitjen e përfshirjes sociale të të dyshuarve dhe shkelësve, dhe kontributin për sigurinë e komunitetit.

Radikalizmi që çon në terrorizëm — procesi dinamik, përmes të cilit një person e pranon dhunën që çon në akte terroriste si një veprim të mundshëm, ndoshta madje edhe të ligjshëm. Kjo mund ta çojë, por jo domosdoshmërisht, një person të dalë në mbrojtje, të veprojë në mbështetje apo të angazhohet personalisht në terrorizëm.

Programet e rehabilitimit dhe riintegrit (R&R) — programe që u drejtohen individëve të radikalizuar për akte të dhunshme (përfshirë, po jo vetëm, ata që kanë kryer vepra që lidhen me terrorizmin) dhe disa herë edhe familjet e tyre, si dhe atyre që nuk kanë hyrë në sistemin e burgjeve, por mund të shfaqin në një farë mase mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm, përfshirë ata që janë kthyer nga territori nën sundimin e Shtetit Islamik në Irak dhe Levant (ISIL) -Da'esh. Programet R&R zhvillohen brenda burgjeve, jashtë konteksteve të heqjes së lirisë, në komunitete, ose si pjesë e shërbimit të provës. Programet mund të ofrojnë trajnim arsimor dhe profesional, këshillim, mundësi punësimi, dhe riedukim ideologjik. Në kontekstin e shëndetit publik, ky njihet si “parandalimi tretësor”.

Vlerësimi i rrezikut dhe i nevojave — një proces që përshin mbledhjen sistematike dhe interpretimin e informacionit që kanë të bëjnë me një individ për të ofruar të dhëna për profesionistët e trajnuar si duhet me qëllim vlerësimin e gjasave që një individ specifik të angazhohet në veprime të dëmshme, natyrën dhe seriozitetin e dëmit, dhe nevojën e individit që, nëse trajtohet, të mund të reduktojë rrezikun.

Instrument për vlerësimin e rrezikut — një kuadër për mbledhjen, analizimin dhe interpretimin e të dhënave për të ndihmuar vendimmarrjen që jep një metodë jodiskriminuese për shqyrtimin e gjasave dhe seriozitetit të dëmit në bazë të informacionit të disponueshëm nga burime të shumëfishta.

Qasje e tërë shoqërisë — në qasje ndaj P/CVERLT që mbrohet nga politikëbërësit dhe ushtruesit e profesioneve që parashikon një rol për aktorë nga sektorë të ndryshëm dhe nga shoqëria civile për parandalimin, ndëryrhjen, shkëputjen dhe programet R&R.

Parathënie

Tituj të lajmeve anekënd rajonit të OSBE-së na sjellin përballë një realitet të zymtë çdo ditë. Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi janë një kërcënim i vazhdueshëm për paqen dhe sigurinë. Ata kërkojnë të dëmtojnë pikërisht vetë vlerat mbi të cilat bazohet OSBE-ja - vlera të tilla si toleranca, përfshirja dhe diversiteti. Për të mbrojtur vlerat tona dhe qytetarët tanë, ne duhet të reagojmë ndaj dhunës kur ajo ndodh, por idealisht ta parandalojmë dhunën para se ajo të ndodhë.

Kthimi i Luftëtarëve të Huaj Terroristë (LHT) dhe i familjeve të tyre është një sfidë që mbetet një nga prioritetet kryesore në listën e shqetësimeve aktuale në shumë Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. Një çështje madhore që ka të bëjë me sigurinë dhe të drejtat e njeriut është të sigurohet që këta individë, të cilët mund ta meritojnë ose jo ndjekjen penale apo burgosjen, të mund të integrohen në shoqëri. Për trajtimin e problemit, qeveritë duhet të pajisen me instrumentet e duhura që lejojnë politika dhe programe që janë të efektshme dhe respektojnë të drejtat e njeriut. OSBE-ja ndihmon për avancimin dhe mbështetjen e praktikave të mira në lidhje me këto çështje si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me to.

Ky udhëzues është pjesë e një serie të prodhuara nga Njësia e Masave kundër Terrorizmit (ATU) në Departamentin e Kërcënimit Ndërkombëtar (TNTD) të Sekretariatit të OSBE-së. Ai përqendrohet kryesisht te programet e rehabilitimit dhe integritit jashtë kontekstit të burgut dhe është hartuar për të qenë plotësues i shumë prej instrumenteve ekzistuese që përqendrohen në përpjekje të bazuara në kontestin e burgut. Udhëzuesi thekson rolin e rëndësishëm të komuniteteve dhe aktorëve joqeveritarë dhe parashton parimet kyçe për të ndihmuar në orientimin e zhvillimit të programeve dhe nismave. Ai është përpiluar duke mbajtur parasysh vendet e Evropës Juglindore, duke u bazuar në konsultime me përfaqësitë e OSBE-së si dhe aktorë të tjerë kyç në rajon. Megjithatë, shumë prej nocioneve të paraqitura në udhëzues janë të përshtatshme dhe mund të përdoren edhe në rajone të tjera.

Ne presim që ky udhëzues dhe publikime të tjera të ngjashme me të të jenë burime të vlefshme për politikëbërësit dhe praktikuesit, të cilët punojnë për të ndihmuar në mbështetjen e individëve të radikalizuar që të shkëputen nga dhuna dhe të forcohen komunitete të paqta dhe të sigurta.



Thomas Greminger
Sekretar i Përgjithshëm i OSBE-së

Përmbledhje

Shtetet në të gjithë rajonin e OSBE-së po e përqendrojnë gjithmonë e më shumë vëmendjen te mënyrat e vënies në funksionim të qasjeve gjithëpërfshirëse për trajtimin e kërcënimeve që vijnë nga terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që çojnë në terrorizëm (VERLT), qasje të cilat balancojnë masat tradicionale kundër terrorizmit të tilla si arresti, ndalimi dhe kufizimi i lëvizjes me masa të ndryshme për të parandaluar dhe për t'iu kundërvënë VERLT-it. Këto masa të fundit përfshijnë parandalimin, ndërhyrjen dhe politikat dhe programet e rehabilitimit dhe riintegritit (R&R).

Koncepti R&R po merr gjithmonë e më shumë vëmendje nga politikëbërësit, praktikuesit e profesioneve, qeveritë kombëtare, dhe institucione shumëpalëshe për një numër arsyes. Këto arsye përfshijnë rritjen në ndjekjen penale të terrorizmit që ka çuar në rritjen e numrit të individëve të lidhur me VERLT që vuajnë dënim me burg, shumë prej të cilëve do të lirohen më pas në komunitet, në mënyrë tipike në një moshë relativisht të re; rritjen e njohjes së rolit kritik që kanë nismat R&R që përfshijnë shumë aktorë në minimizimin e përsëritjes së veprave që lidhen me terrorizmin; rritjen e numrit të individëve që kthehen nga zona konflikti në Irak dhe Siri, të cilët mund të jenë radikalizuar për dhunë por mund të përfundojnë në burg; dhe të kuptuarit se shumë vende nuk kanë aktualisht programe për të mbështetur përpjekjet R&R.

Nismat R&R mund të ndahen në dy kategori të gjera: nismat me fokus burgjet, ku terroristët apo autorë veprash penale, esktrmistë të dhunshëm vuajnë dënimin, dhe nismat me fokus kontekste jashtë burgut, ku programet R&R përqendrohen në trajtimin jo vetëm të autorëve të veprave por edhe të individëve të asociuar me terrorizmin dhe VERLT-in, por që nuk janë dënuar për kryerjen e veprave të tilla. Duke u fokusuar në hapësirën jashtë burgut, ky udhëzues i OSBE-së kërkon që të plotësojë shumë instrumente që janë përgatitur për të mbështetur përpjekjet R&R të bazuara në një kontekst burgu. Ai ofron një burim për vende të ndryshme, në veçanti në Evropën Juglindore, të cilin ato mund ta përdorin në angazhimin dhe përpjekjet e tyre për të trajtuar sa më mirë nevojat dhe sfidat jashtë mjedisit të burgut.

I shkruar me qëllimin për të mbështetur hartimin e programeve R&R gjithëpërfshirëse, jashtë kontekstit të burgjeve, ky udhëzues:

- Diskuton çështje që lidhen me kuadrin ligjor dhe atë të politikave që mbështesin programe R&R në një kontekst jashtë burgut;
- Rendit disa prej elementeve dhe çështjeve më të zakonshme që duhet të merren në konsideratë në procesin e hartimit dhe zbatimit të këtyre programeve;
- Përvijon disa prej kategorive për ndërhyrje dhe mbështetje - përfshirë mbështetjen psikologjike, social-ekonomike, dhe ideologjike - që duhet të japin këto programe për trajtimin e nevojave dhe vulnerabiliteteve, shpesh të shumëllojshme, të atyre që përfshihen në esktrmizëm të dhunshëm;
- Identifikon aktorët qeveritarë dhe joqeveritarë që ofrojnë ndërhyrje, të cilët shpesh ndihmojnë në përpjekjet R&R, larminë e tyre që pasqyrojnë shumëllojshmërinë e rreziqeve dhe nevojave të përfutësve të këtyre programeve;

- Trajton mënyrën se si të vihet në zbatim një shkëmbim informacioni dhe bashkëpunim i efektshëm midis aktorëve të shumtë;
- Thekson disa prej kërkesave dhe sfidave në lidhje me trajnimin dhe kapacitete të tjera - si në nivel institucional edhe në atë individual - me të cilat mund të përballen vendet përkatëse; dhe
- Diskuton rëndësinë që ka garantimi që nismat R&R jashtë kontekstit të burgut të marrin në konsideratë ndjeshmëritë gjinore dhe të moshës, në veçanti duke pasur parasysh nevojat dhe rreziqet unike, dhe rrjedhimisht edhe sfidat, që mund të paraqesin gratë dhe fëmijët.

Ndërkohë që njih nevojën për të përpiluar qasje që i përshtaten dhe janë të ndjeshme ndaj kontekstit dhe konfliktit në lidhje me sfidat e paraqitura, udhëzuesi identifikon **një sërë parimesh që duhet të mbështesin të gjitha përpjekjet R&R jashtë kontekstit të burgjeve:**

- Udhëheqësit politikë duhet që të shpjegojnë vlerën e programeve R&R ndaj pjesëve të publikut që shpesh janë skeptikë;
- Programet R&R duhet të trajtojnë të gjitha format e VERLT-it;
- Theksi duhet vendosur te shkëputja nga dhuna (ndryshimi i sjelljes), më shumë se sa te deradikalizimi (ndryshimi i bindjeve), ndonëse këndvështrimi ideologjik i një personi nuk duhet të shpërfilllet;
- Përfshirja e shumë aktorëve dhe shumë sektorëve është me rëndësi thelbësore;
- Proporcionaliteti dhe vazhdimësia e nismave R&R janë të rëndësishme;
- Nismat R&R duhet të trajtojnë dhe të zbusin stigmën ndërkohë që shmangin krijimin e përshtypjes se përfituesve të programeve R&R po u jepet trajtim i veçantë;
- Duhet bërë përpjekje për përgatitjen dhe angazhimin e komuniteteve, përfshirja e të cilëve në programet R&R dhe mbështetja e tyre janë me rëndësi kritike për sukses;
- Qasjet R&R duhet të jenë të ndjeshme dhe duhet të trajtojnë nevojat shpesh unike të grave dhe fëmijëve;
- Programet R&R duhet të mbështeten në kapacitete ekzistuese, por edhe t'i forcojnë ato kur është e nevojshme; dhe
- Të gjitha programet R&R duhet të përfshijnë një teori ndryshimi, përparësitë e së cilës përfshijnë edhe faktin që matja e ndikimit të bëhet më e lehtë.



1. Hyrje

Ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi janë, në themel, kundërshtim i vlerave demokratike të tolerancës, respektit, përfshirjes dhe diversitetit të cilat mbështesin punën e OSBE-së. Ndonëse 57 Shtetet pjesëmarrëse në OSBE përjetojnë lloje dhe nivele të ndryshme të kërcënimeve që lidhen me krimin ndërkombëtar, të gjitha kanë konfirmuar angazhimin e tyre për të punuar së bashku për t'iu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimin që çojnë në terrorizëm (VERLT).

Shtetet në rajonin e OSBE-së vijnë në përballen me sfida të shumanshme që kanë të bëjnë me parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm (PCVERLT). Këto përfshijnë trajtimin e faktorëve që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm; zbulimin dhe parandalimin e sulmeve që janë projektuar brenda vendit; menaxhimin e kthimit të “luftëtarëve të huaj terroristë” (LHT) dhe anëtarëve të familjes nga zonat e konfliktit; dhe lehtësimin e rifutjes paqësore në shoqëri të autorëve të veprave që lidhen me terrorizmin dhe ekstremizmit të dhunshëm. Trajtimi i aspekteve të ndryshme të këtyre sfidave ka qenë një përparësi për Kryetarët e Radhës të OSBE-së të kohëve të fundit, përfshirë Zvicrën¹, Serbinë², Gjermaninë³, Austrinë⁴, Italinë⁵ dhe më së fundmi Sllovakinë.

Gjatë Konferencës së OSBE-së Kundër Terrorizmit të marsit 2019 në Sllovaki, pjesëmarrësit theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me shumë aktorë, shumë sektorë dhe shumë nivele brenda secilit vend për të trajtuar VERLT-in. Ata theksuan rëndësinë e rehabilitimit dhe riintegritimit në shoqëri të ish autorëve të terrorizmit dhe “LHT” që kthehen dhe anëtarët e familjeve, duke vënë në dukje se “individët shpesh kthehen në të njëjtat mjedise, që kishin mundësuar radikalizimin e tyre në terrorizëm në krye të herës. Është e domosdoshme që të gjejmë kombinimin e duhur të përgjigjeve në mënyrë që të mbrojmë shoqërinë dhe të ndihmojmë ata që duan të shpengojnë veten.”⁶

1 Shih, për shembull, OSCE Chairperson-in-Office (CiO), *The Chairmanship Interlaken Recommendations*, 29 April 2014, <https://www.osce.org/cio/118146?download=true>.

2 Shih, për shembull, OSCE, *Ministerial Declaration on Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism*, 4 December 2015, <https://www.osce.org/cio/208216?download=true>.

3 Shih, për shembull, OSCE, *Declaration on Strengthening OSCE Efforts to Prevent and Counter Terrorism*, 9 December 2016, <https://www.osce.org/cio/288176?download=true>.

4 Shih, për shembull, OSCE/CiO, *Recommendations from the 2017 OSCE-wide Counter-Terrorism Conference on "Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism"*, Chairmanship's Perception Paper, May 2017, <https://www.osce.org/secretariat/327731?download=true>.

5 OSCE/ CiO, *The Reverse Flow of Foreign Terrorist Fighters (FTFs): Challenges for the OSCE Area and Beyond*, 10–11 May 2018, Rome, <https://www.osce.org/chairmanship/377557?download=true>.

6 OSCE, “As Terrorism Trends Are Evolving, We Need to Work Together to Stay One Step Ahead—Main Message from Opening of OSCE Conference in Bratislava”, press release, 25 March 2019, <https://www.osce.org/chairmanship/415163>.

Programet e efektshme dhe të qëndrueshme për rehabilitim dhe ri-integrim (R&R) janë me rëndësi thelbësore për trajtimin e VERLT-it në periudhën afatgjatë, dhe, siç është nënvizuar në strategjinë kombëtare të Kanadasë për kundërvënien ndaj radikalizimit drejt dhunës, këto programe mund të plotësojnë punën e agjencive të sigurisë dhe të policimit për monitorimin, hetimin dhe ndërtimit të një rasti për procedim penal. Programet e shkëputjes, të cilat kanë në fokus ata që janë përfshirë drejtpërdrejt në dhunë të motivuar nga ideologjia ... janë një tjetër mënyrë e zbutjes së kërcënimit të mundshëm që mund të vijë prej këtyre individëve.⁷ R&R është një fushë që po merr një vëmendje urgjente gjithmonë e më shumë nga Shtetet në rajonin e OSBE-së për një sërë arsyesh.

Së pari është rritja e numrit të ndjekjeve penale për çështje të lidhura me terrorizmin. Që prej sulmeve terroriste në Shtetet e Bashkuara të shtatorit 2001, kuadri ligjor kundër terrorizmit është zgjeruar në mënyrë progresive, çka ka çuar në rritje të numrit të autorëve të veprave që lidhen me terrorizmin që vuajnë dënimin me burg.⁸

Së dyti është periudha relativisht e shkurtër e dënimit me burg për autorët e veprave që lidhen me terrorizmin në didsa pjesë të rajonit të OSBE-së. Që prej vitit 2015, vetëm në Evropën Juglindore, dhjetëra individë janë dënuar për kryerjen e veprave që lidhen me terrorizmin dhe kanë vuajtur ose vuajnë dënime me burg. Gjithsesi, Evropa Juglindore shënon dënimet më të shkurtra në kontinent për vepra që lidhen me terrorizmin,⁹ ku autorët e këtyre veprave kalojnë mesatarisht vetëm shtatë vjet në burg.¹⁰

Së treti, shumë individë që kanë pasur lidhje me veprimtari terroriste do të lirohen dikur nga burgu, tipikisht në një moshë relativisht të re, dhe do të rifuten në shoqëri. Këta ish të dënuar do të kenë nevojë për mbështetje nëse do të bëhen pjesëtarë paqësorë dhe produktivë të shoqërisë. Në disa raste, duhet të merret në konsideratë shpërngulja në një qytet apo në një komunitet tjetër.

Së katërti është njohja gjithmonë e në rritje e rolit me rëndësi kritike që luajnë nismat R&R, duke u mbështetur në ekspertizë dhe kontribute të tjera nga institucione dhe aktorë të shumëfishtë nga një gamë e gjerë sektorësh dhe disiplinash për minimizimin e përsëritjes së veprave të lidhura me terrorizmin.

Së pesti është numri në rritje i individëve që kthehen nga zonat e konfliktit në Irak dhe Siri, të cilët mund të jenë radikalizuar drejt dhunës, por që, për arsye të ndryshme, mund të mos përfundojnë në burg. Për shembull, disa prej tyre

7 Public Safety Canada, *National Strategy on Countering Radicalization to Violence*, 2018, pp. 16–17, <https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrscs/pblctns/ntnl-strtg-cntrng-rdclztn-vlnc/index-en.aspx>.

8 Sarah Marsden, *Reintegrating Extremists: "Deradicalisation" and Desistance* (New York: Palgrave, 2017), p 7.

9 Adrian Shtuni, "Western Balkans Foreign Fighters and Homegrown Jihadis: Trends and Implications", *CTC Sentinel*, August 2019, p. 21, <https://ctc.usma.edu/app/uploads/2019/08/CTC-SENTINEL-072019.pdf>.

10 Vlado Azinovic, *Regional Report: Understanding Violent Extremism in the Western Balkans*, British Council, June 2018, p. 7, https://www.britishcouncil.me/sites/default/files/erf_report_western_balkans_2018.pdf.

mund t'i shpëtojnë dënimit për shkak të sfidave për sigurimin e dëshmisë së dëshmitarëve që përcakton praninë dhe rolin e të akuzuarit në një zonë konflikti.¹¹ Rifutja e këtyre të kthyerve në mënyrë të suksesshme në shoqëri është një domosdoshmëri sa në aspektin e sigurisë aq edhe në atë humanitar. Një numër vendesh në rajonin e OSBE-së, përfshirë Evropën Juglindore, po përballen aktualisht me këtë sfidë.

Arsyeja e fundit për rritjen e vëmendjes ndaj R&R-së është njohja e faktit se shumë vende nuk kanë programe për të mbështetur përpjekjet R&R. Disa vendeve u mungon ekspertiza, burimet dhe kapacitete të tjera - si në nivelin institucional edhe në nivelin profesional dhe të praktikuesve - që janë të nevojshme për të hartuar, zbatuar dhe mbështetur në mënyrë të qëndrueshme këto programe. Për shembull, disa vende në Evropën Juglindore dhe në pjesë të tjera të rajonit të OSBE-së vuajnë nga institucione që kanë mungesa të stafit në mënyrë kronike - të tilla si korrektimi dhe kujdesi psikosocial - si për nga numri i stafit edhe për nga ekspertiza e specializuar. Ato vende vuajnë edhe mungesën e besimit midis aktorëve të ndryshëm dhe të një kulture bashkëpunimi midis shumë aktorëve, që shpesh janë përbërësi kyç për zhvillimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse R&R.¹² Sipas një studimi të botuar në 2017, megjithëse strategjitë dhe planet ekzistojnë në letër, progresi për hartimin dhe zbatimin e programeve R&R në Evropën Juglindore nuk ka qenë i njëjtë.¹³

Nismat R&R mund të ndahen në dy kategori të gjera: ato që fokusohen në një kontekst burgu, ku terroristët apo autorë esktrëmistë të dhunshëm vuajnë dënimin e tyre, dhe ato që fokusohen në kontekste jashtë burgut, ku programet R&R përqendrohen në trajtimin jo vetëm të autorëve të veprave por edhe në individë që janë asociuar me terrorizmin dhe VERLT-in, por që nuk janë dënuar për kryerjen e veprave të tilla. Deri më sot, organet shumëpalëshe dhe organizata të tjera ia kanë kushtuar vëmendjen më të madhe kontekstit të burgut në proces duke gjeneruar një larmi udhëzuesish dhe korniza, praktika të mira dhe programe trajnimi si për parandalimin e kthimit të burgjeve në pika të nxehta për VERLT edhe për mbështetjen e programeve R&R për autorët e veprave që lidhen me terrorizmin dhe ata që mund të jenë radikalizuar gjatë vuajtjes së dënimit në burg (shih Shtojca 1).

Me fokusin *jashtë kontekstit të burgut*, ky udhëzues i OSBE-ja përpiket të plotësojë këto përpjekje. Ai ofron një burim për vende të ndryshme, në veçanti në Evropën Juglindore, të cilin ato mund ta përdorin në angazhimin dhe përpjekjet e tyre për të trajtuar sa më mirë nevojat dhe sfidat jashtë mjedisit të burgut. Pavarësisht nga ky fokus në hapësirën jashtë burgut, ky udhëzues njih rëndësinë e nismave

11 Po aty.

12 Regional Cooperation Council (RCC), *A Waiting Game: Assessing and Responding to the Threat from Returning Foreign Fighters in the Western Balkans*, 2017, <https://www.rcc.int/pubs/54/a-waiting-game-assessing-and-responding-to-the-threat-from-returning-foreign-fighters-in-the-western-balkans>.

13 Shtuni, "Western Balkans Foreign Fighters", p. 21. Shih edhe Albina Sorguc, "Bosnia Has Plan, But No Money, to Fight Radicalization," *Detektor*, December 28, 2018, <http://detektor.ba/en/bosnia-has-plan-but-no-money-to-fight-radicalisation/>.

R&R për të ndihmuar autorët e veprave ndërsa ata janë ende në burg dhe vëren se R&R është një parim i të drejtave themelore të njeriut për një kontekst në burg.¹⁴

Një botim i publikuar së fundmi nga OSBE/ODIHR-i për trajtimin e sfidës së “LHT-ve” në kuadrin e të drejtave të njeriut përvijon disa nga parametrat bazë të këtyre nismave. Për shembull, ky botim vë në dukje se ato parime duhet të kërkojnë të sigurojnë që individët të shkëputen dhe ta riorientojnë të ardhmen e tyre larg VERLT-it, çka mund të reduktojë kërcënimet që ata mund të paraqesin dhe në disa raste të ndihmojnë të tjerë të shkëputen; të jenë gjithëpërfshirëse, me dëshirë, të kujdesshme të mos përforcojnë stigmatizimin dhe të tregojnë kujdes ndaj diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë; dhe të pasqyrojnë nevojat dhe sfidat specifike në bazë gjinore për riintegrimin e grave (si dhe të burrave) në një kontekst shoqëror tejet të kontestuar.¹⁵

Ky udhëzues ndërton më tej mbi atë që është shtjelluar në botimin e OSBE/ODIHR-it duke u dhënë politikëbërësve, profesionistëve dhe aktorëve lokalë udhëzime praktike për çështjet që duhet të merren në konsideratë, për sfidat që duhet të kapërcehen, për partneritetet që duhet të zhvillohen, për ekspertizën që duhet të mobilizohet, dhe për kapacitetet që duhet të forcohen për hartimin e programeve dhe mbështetjen e shkëputjes dhe risocializimin jo vetëm për “LHT-të” dhe familjarët që kthehen e që nuk janë të ndjekur penalisht, por edhe për autorët e veprave të ekstremizmit të dhunshëm që e kanë kryer dënimin me burg. Ky udhëzues është gjithashtu i rëndësishëm për përgatitjen e programeve për individë që u nënshtrohen masave alternative, si shërbimit të provës apo vendimeve gjyqësore të mbikëqyrura, të pezulluara apo të shtyra, shërbimi në komunitet dhe dëmshpërblimi, dhe zotimi për të mos kryer vepra penale.¹⁶

Ndërkohë që njeh nevojën për të përpiluar qasje që i përshtaten dhe janë të ndjeshme ndaj kontekstit në lidhje me sfidat e paraqitura, udhëzuesi thekson një sërë parimesh që duhet të mbështesin të gjitha përpjekjet R&R në një kontekst jashtë burgut:

Ndërkohë që njeh nevojën për të përpiluar qasje që i përshtaten dhe janë të ndjeshme ndaj kontekstit në lidhje me sfidat e paraqitura, udhëzuesi thekson një sërë parimesh që duhet të mbështesin të gjitha përpjekjet R&R në një kontekst jashtë burgut:

14 Neni 10, paragrafi 3 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike parashikon që “Sistemi ndëshkues – korrektues përmban një trajtim të të dënuarëve që ka për qëllim thelbësor riedukimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.”

15 Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), Guidelines for Addressing the Threats and Challenges of “Foreign Terrorist Fighters” within a Human Rights Framework, [hereinafter, OSCE/ODHIR FTF Guidelines], September 2018, f. 61–62, <https://www.osce.org/odihr/393503>. Këta udhëzues parashikojnë, *ndër të tjera*, se këto nisma duhet të mbështeten në vlerësime të individualizuara për rrezikun dhe nevojat që marrin parasysh, ndër të tjera, motivimet personale, natyrën dhe nivelin e përfshirjes në vepra të dhunshme dhe viktimizimin e mundshëm që ata vetë mund të kenë përjetuar; dhe janë të mbështetura në mënyrë të qëndrueshme në një kontekst më të gjerë të masave parandaluese të VERLT-it që trajtojnë në mënyrë të efektshme shkeljet dhe kushtet strukturore sociale që kanë qar në radikalizim terrorist”. Shih f. 53.

16 Për një diskutim mbi përdorimin e masave administrative në çështjet për terrorizëm dhe VERLT, shih, për shembull, UN Counter Terrorism Executive Committee (UNCTED), Concern at Potential Risks Posed by the Forthcoming Release of Imprisoned FTFs, UNCTED Trends Alert, July 2018, https://www.un.org/sc/ctc/wp-content/uploads/2018/07/Trends_Alert_July_2018.pdf; and Global Counterterrorism Forum (GCTF), *Initiative to Address the Life Cycle of Radicalization to Violence: Recommendations on the Effective Use of Appropriate Alternative Measures for Terrorism-Related Offenses*, September 2016, <https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Lifecycle%20Toolkit-documents/English-Effective-Use-of-Appropriate-Alternatives.pdf?ver=2016-09-13-141050-207>.

- Udhëheqësit politikë duhet që të shpjegojnë vlerën e programeve R&R ndaj pjesëve të publikut që shpesh janë skeptikë;
- Programet R&R duhet të trajtojnë të gjitha format e VERLT-it;
- Theksi duhet vendosur te shkëputja nga dhuna (ndryshimi i sjelljes), më shumë se sa te deradikalizimi (ndryshimi i bindjeve).
- Përfshirja e shumë aktorëve dhe shumë sektorëve është me rëndësi thelbësore;
- Proporcionaliteti dhe vazhdimësia e nismave R&R janë të rëndësishme;
- Nismat R&R duhet të trajtojnë dhe të zbusin stigmën ndërkohë që shmangin krijimin e përshtypjes se përfituesve të programeve R&R po u jepet trajtim i veçantë;
- Duhet bërë përpjekje për përgatitjen dhe angazhimin e komuniteteve, përfshirja e të cilëve në programet R&R dhe mbështetja e tyre janë me rëndësi kritike për suksesin e programeve;
- Qasjet R&R duhet të jenë të ndjeshme dhe duhet të trajtojnë nevojat shpesh unike të grave dhe fëmijëve;
- Programet R&R duhet të mbështeten në kapacitete ekzistuese, por edhe t'i forcojnë ato kur është e nevojshme; dhe
- Të gjitha programet R&R duhet të përfshijnë një teori ndryshimi për të ndihmuar në matjen e ndikimit.

Publikimi është shkruar për **politikëbërësit** që punojnë për hartimin e politikave, strategjive, plan-veprimeve dhe programeve P/CVERLT. Gjithashtu, ai synon të rrisë ndërgjegjësimin për sfidat dhe çështjet kyçe që duhet të merren në konsideratë si dhe të nënvizojë rëndësinë e bashkëpunimit midis politikëbërësve dhe praktikuesve të profesionit në hartimin dhe vënien në zbatim të programeve që fokusohen në R&R në një kontekst jashtë burgut. Ai sugjeron mënyra për të kapërcyer sfidat dhe për të forcuar bashkëpunimin.

Ky udhëzues është shkruar edhe për **aktorët lokalë**. Këtu përfshihen bashkitë dhe autoritete të tjera nën-kombëtare, praktikuesit dhe profesionistët në nivel vendor, si dhe aktorë të shoqërisë civile, të cilët duhet të përfshihen në hartimin dhe zbatimin e programeve R&R në një kontekst jashtë burgut. Udhëzuesi hedh dritë mbi spektrin e çështjeve të duhet të merren në konsideratë dhe pyetjeve që duhen shtruar gjatë hartimit dhe vënien në zbatim të këtyre programeve.

Pas Seksionit të parë të hyrjes, Seksioni 2 shpjegon konceptet kyçe të përdorura në këtë udhëzues. Seksioni fillon me shqyrtimin e natyrës dhe objektit të termave të tillë si “radikalizim që çon në terrorizëm”, dhe më pas përvijon spektrin e politikave dhe programeve që përfshihen brenda sferës së P/CVERLT.

Seksioni 3 përshkruan interesin në rritje për R&R dhe debatet aktuale për faktin nëse objektivi duhet të jetë “shkëputja” apo “deradikalizimi” apo një ndërthurje e të dyjave. Seksioni 3 sqaron edhe ndryshimin ndërmjet programeve R&R në një kontekst jashtë burgut dhe ndërhyrjeve P/CVERLT që fokusohen te individët në një hapësirë jokriminale, dhe se si versioni i kontekstit jashtë burgut ndikohet nga ai i kontekstit në burg.

Seksioni 4 fokusohet te kuadri ligjor dhe ai i politikave që do të mundësonin hartimin dhe zbatimin në kohë, në mënyrë të duhur dhe të përshtatur sipas nevojave të programeve dhe masave R&R në kontekst jashtë burgu.

Siç e shpjegon edhe Seksioni 5, procesi i hartimit dhe zbatimit të programeve R&R në kontekst jashtë burgut synon të përfshijë marrjen në konsideratë të një grupi çështjesh kyçe dhe elementesh të përbashkëta. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të njihet dhe pranohet se këto nisma janë në forma dhe përmasa të ndryshme, *ndër të tjera*, duke pasur parasysh grupet specifike që synojnë të arrijnë (përfshirë individë dhe familje dhe anëtarë të tjerë të komunitetit) si dhe në varësi të kontekstit lokal e shoqëror, kulturor dhe historik, marrëdhënieve në komunitet dhe të kapaciteteve.

Seksioni 6 përvijon disa prej kategorive kryesore të ndërhyrjeve apo mbështetjes që japin këto programe për trajtimin e nevojave dhe vulnerabiliteteve të ndryshme të atyre që përfshihen në ekstremizëm të dhunshëm. Këtu përfshihet mbështetja psiko-sociale, social-ekonomike dhe ideologjike.

Fokusi i Seksionit 7 vendoset te ofruesit e ndërhyrjes - një gamë e gjerë profesionistësh, praktikuesish, dhe aktorësh të tjerë nga disiplina të ndryshme si brenda edhe jashtë qeverisë. Ata përfshijnë “ishët”; psikologë; psikiatër dhe ofrues të tjerë të kujdesit psikologjik; këshillues fetarë; organizata të shoqërisë civile (OSHC); oficerë të shërbimit të provës; dhe pjesëtarë të familjes. Kjo shumëllojshmëri në përfshirje i shton gjasat që çështje komplekse që e kanë çuar individin në rrugën drejt VERLT-it të mund të trajtohen në mënyrën e duhur.

Seksioni 8 trajton një prej çështjeve më komplekse që lidhen me vënien në zbatim dhe mbështetjen e qëndrueshme të ndërhyrjeve R&R jashtë kontekstit të burgut: mundësimin e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit të efektshëm midis shumë aktorëve. Seksioni paraqet shembuj se si një gjë e tillë është arritur në vende të ndryshme të rajonit të OSBE-së.

Seksioni 9 thekson disa prej avantazheve krahasuese të aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë në programet R&R jashtë kontekstit të burgut dhe thekson nevojën për të siguruar një ndarje të duhur të punës midis atyre me qëllim maksimizimin e kontributeve të tyre dhe ndikimin e programit.

Kërkesat dhe sfidat për kapacitete - si në nivel institucional edhe në nivel individual - me të cilat përballen vendet ndërsa përpiqen të hartojnë dhe të mbështesin programe R&R në kontekst jashtë burgu trajtohen në Seksionin 10. Diskutimi e bën të qartë se në mungesë të disa kapaciteteve bazë, shtetet do ta kenë të vështirë për të realizuar ndërhyrje të specializuara e të përshtatura si edhe shërbime të tjera përkatëse nëpërmjet në qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj R&R jashtë kontekstit të burgut.

Seksioni 11 diskuton rëndësinë e garantimit që nismat R&R jashtë kontekstit të burgut të marrin në konsideratë ndjeshmëritë gjinore dhe të moshës, në veçanti duke mbajtur parasysh nevojat e veçanta të grave dhe fëmijëve si dhe rreziqet unike me të cilat përballen ata. Ky seksion rendit disa prej mënyrave specifike për t'iu përgjigjur sfidave që mund të paraqesin gratë dhe fëmijët.

Seksioni 12 identifikon një sërë parimesh që duhet të mbështesin përpjekjet R&R jashtë kontekstit të burgut.

Ky udhëzues mbështet në përvojat dhe mësimet e nxjerra nga një larmi nismash në shumë Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së si dhe në doracakët, udhëzuesit dhe manualët ekzistues për R&R, shumë prej të cilëve fokusohen në kontekstin e R&R në burg. Shumë prej këtyre janë renditur në Shtojcën 1. Shtojca 2 paraqet shembuj të llojeve të ndryshme të programe R&R jashtë kontekstit të burgut në të gjithë rajonin e OSBE-së që trajtojnë çështje VERLT; këto përshkrime nënvizojnë një prej temave që përsëriten vazhdimisht në udhëzues: nuk ka një qasje të përgjithshme që u përshtatet të gjitha rasteve për hartimin dhe zbatimin e këtyre programeve.



2. Koncepte kyçe

2.1 Të kuptojmë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që çon në terrorizëm

Për “radikalizimin që çon në dhunë” dhe “ekstremizmin e dhunshëm” ka disa përkufizime të ndryshme ligjore, të politikave, dhe akademike. Këto përkufizime u shërbejnë qëllimeve të ndryshme dhe nuk kanë qenë gjithmonë të harmonizuar. Përpjekjet për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të shkëmbyer e promovuar praktikatat e mira, disa herë, janë penguar nga këto dallime.

Në të vërtetë, “**ekstremizmi i dhunshëm**” përkufizohet rrallë, por përgjithësisht i referohet veprave të dhunës që përligjen ose shoqërohen me një ideologji ekstremiste fetare, sociale apo politike. Koncepti i ekstremizmit të dhunshëm është më i gjerë dhe më i shtrirë se sa terrorizmi, sepse ai mirëpret çdo lloj dhune, për sa kohë që motivimi i tij gjykohet si ekstremist.¹⁷

Sipas Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës, për ta cilësuar “*nxitjen e mospranimit social, racial, etnik apo fetar*” si “veprimtari ekstremiste, përkufizimi duhet të kërkojë qartazi elementin e dhunës.”¹⁸ Megjithatë, Plani i Veprimit i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së 2015 për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm përcakton se “ekstremizmi i dhunshëm” përfshin një kategori më të gjerë të shpërfaqjes dhe ka një rrezik që shkrirja në një e termave [“ekstremizmi i dhunshëm” dhe “terrorizmi”] mund të çojë në përligjen e zbatimit tejet të gjerë të masave kundër terrorizmit, përfshirë format e sjelljes të cilat nuk duhen cilësuar si vepra që lidhen me terrorizmin.”¹⁹

17 Shih Andrew Glazzard and Martine Zeuthen, *Violent Extremism*, GSDRC Professional Development Reading Pack, No. 34, February 2016, https://assets.publishing.service.gov.uk/media/57a0895ae5274a31e000002c/Violent-extremism_RP.pdf; and Peter Neumann, *Countering Violent Extremism and Radicalisation that Lead to Terrorism: Ideas, Recommendations, and Good Practices from the OSCE Region*, OSCE, 28 September 2017.

18 Këshilli i Evropës, Komisioni për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), “Opinion on the Federal Law on Combating Extremist Activity of the Russian Federation,” Opinion no. 660 / 2011, miratuar nga Komisioni i Venecias në Sesionin Plenar 91 (Venecia, 15-16 qershor 2012), para. 36, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDDL-AD\(2012\)016-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDDL-AD(2012)016-e).

19 UN General Assembly, Plan of Action to Prevent Violent Extremism: Report of the Secretary-General, Seventieth Session, A/A/70/674, 24 December 2015, http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/70/674.

“**Radikalizimi**” u referohet proceseve me anë të të cilave individit përfaqon apo mbështet gjithmonë e më shumë ide që konsiderohen të jenë ekstremiste. Në mënyrë tipike, radikalizimi nuk shkaktohet nga një ndikim i vetëm, por nga një ndërthurje faktorësh dhe dinamikësh. Ai është një koncept me interpretime të ndryshme. Në disa raste, termi përdoret në një mënyrë që sugjeron një lidhje të nënkuptuar midis ideve radikale dhe dhunës. Kjo është problematike sepse jo të gjithë ata që kanë ide radikale (apo ekstremiste) do të angazhohen apo do të mbështesin veprim të dhunshëm, dhe se mundësia për të pasur ide - pavarësisht nga natyra e tyre - është e përcaktuar si një e drejtë themelore e njeriut.²⁰

Gjithashtu, ashtu siç është shprehur edhe Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias në vitin 2012, “nuk ka siguri pa media të lirë dhe lirinë e shprehjes”. Media nuk duhet të kriminalizohet për kontributin në debatin publik. Përkundrazi, mediat mund të kenë një rol vendimtar mbrojtës në shoqëri, duke e informuar publikun për rreziqet e terrorizmit dhe rritjen e ndërgjegjësimit për këtë kërcënim të vazhdueshëm.”²¹

OSBE-ja është e vetëdijshme për faktin se është e nevojshme që të tregohet kujdes më i madh kur përdoren disa terma në fushën e kundërterrorizmit. OSBE-ja e shpjegon “**radikalizimin që çon në terrorizëm**” si “procesi dinamik, përmes të cilit një person e pranon dhunën që çon në akte terroriste si një veprim të mundshëm, ndoshta madje edhe të ligjshëm. Kjo mund ta çojë eventualisht, por jo domosdoshmërisht, këtë person që të avokojë, të veprojë në mbështetje, apo të angazhohet në terrorizëm”.²² Në linjë me këtë kuptim, OSBE-ja përdor me qëllim termin “**ekstremizëm i dhunshëm dhe radikalizim që çojnë në terrorizëm (VERLT)**”, i cili nënkupton se disa raste të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit mund të mos çojnë në terrorizëm.

2.2 Programe dhe strategji për të parandaluar dhe për t’iu kundërvënë VERLT-it

Termi “**parandalimi dhe kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm (P/CVERLT)**” i referohet një spektri politikash, programesh, dhe ndërhyrjesh të që kanë për synim parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit lidhur me radikalizimin terrorist.

20 E drejta e lirisë së mendimit dhe shprehjes mbrohet nga neni 19 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Ai përcakton se secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje. Më tej, liria e shprehjes mbrohet edhe shprehjen e pikëpamjeve dhe ideve që shqetësojnë, ofendojnë apo shokojnë - të cilat sigurisht përfshijnë pikëpamje dhe ide të cilat disa njerëz mund t’i konsiderojnë si radikale apo ekstreme.

21 Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias “OSCE Media Freedom Representative Welcomes Russian Supreme Court Decisions Protecting Public Discussion of Terrorism, Extremism”, njoftim për shtyp, 13 shkurt 2012, <https://www.osce.org/fom/88117>.

22 OSCE, *Preventing Terrorism and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: A Community-Policing Approach*, February 2014, <https://www.osce.org/secretariat/111438?download=true>. Një publikim i përbashkët i OSBE/SiO dhe Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, Varshavë.

Ky formulim i miratuar nga OSBE-ja e vendos theksin te lidhja midis radikalizimit/ ekstremizmit dhe veprave të terrorizmit. Në këtë mënyrë, OSBE-ja e thekson qartë rëndësinë e mbrojtjes së lirive themelore kur punohet për parandalimin e këtyre rreziqeve ndaj sigurisë.

Parandalimi dhe kundërvënia ndaj VERLT-it nuk janë shtrënguese për nga natyra (p.sh. nuk përfshin arrestime, hetime dhe ndjekje penale). Theksi, në fakt, vendoset te procese parandaluese dhe luftuese kundër radikalizimit që mund të çojë në terrorizëm; trajtimi dhe reduktimi i mospajtimeve dhe kushteve strukturore, sociale, ekonomike dhe politike që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm; ndihma për ata që janë tashmë të radikalizuar në terrorizëm për t'u shkëputur dhe për t'u ri-integruar në shoqëri; dhe ndërtimi i komuniteteve rezistente ndaj VERLT-it.

Si i tillë, P/CVERLT ndryshon nga **“kundërvënia ndaj terrorizmit”**, i cili u referohet një sërë veprimtarish që ndërmerren më së pari nga agjencitë ligjzbatuese dhe ato të inteligjencës, dhe disa herë nga ushtria, “me synim shkatërrimin e kompleteve terroriste dhe çmontimin e organizatave terroriste” si dhe përgjigje të drejtësisë penale që hetojnë dhe sjellin para drejtësisë ata që kanë kryer krime terroriste.²³ Ndërsa strategjitë dhe planveprimet kombëtare P/CVERLT hartohen dhe nxiten nga autoritete shtetërore, zbatimi i tyre, në mënyrë tipike, nuk është i kufizuar te aktorë kombëtare qeveritarë dhe përfshin një spektër të gjerë të aktorëve nga palë të interesuara, përfshirë autoritetet lokale dhe nënkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat. Si të tilla, përpjekjet P/CVERLT mund të kuptohen si programe dhe politika që **plotësojnë** qasjet tradicionale kundër terrorizmit.

Terminologji të tjera analoge apo të mbivendosura që përdoren në komunitetin ndërkombëtar përfshijnë “kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm” (CVE), “parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm” (PVE), dhe “parandalimi dhe kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm” (P/CVE). P/CVE është një term i gjerë ombrellë që mbulon veprimtari të zbatuara nga aktorë qeveritarë dhe joqeveritarë që kërkojnë të parandalojnë apo të zbusin ekstremizmin e dhunshëm nëpërmjet masave joshtrënguese që bashkohen nga objektivi për trajtimin e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm. Organizatat dhe profesionistët e përfshirë në zhvillim, në veçanti, kanë preferenca individuale për zbatimin e termave “PVE” apo “CVE”. Për shembull, “PVE”-ja ka fituar më shumë tërheqje brenda Kombeve të Bashkuara (jashtë Këshillit të Sigurisë dhe organeve përkatëse në varësi të tij si Komiteti i Kundër Terrorizmit dhe Drejtoria e tij Ekzekutive Kundër Terrorizmit) si dhe mes agjencive që punojnë për zhvillimin. Theksi i tij është te trajtimi dhe zbutja, shpesh nëpërmjet instrumenteve dhe ndërhyrjeve zhvillimore, duke u përqendruar te kushtet dhe shkaqet bazë të terrorizmit, të tilla si qeverisja e dobët, struktura përjashtuese sociale apo ekonomike, dhe edukim i pamjaftueshëm.²⁴ Megjithatë, shpesh ka pak dallim

23 Neumann, *Countering Violent Extremism and Radicalisation that Lead to Terrorism*, pp. 71–72, <https://www.osce.org/chairmanship/346841?download=true>.

24 UNGA, *Plan of Action to Prevent Violent Extremism*.

në objektivat dhe veprimet specifike në terren midis PVE-së dhe CVE-së.²⁵ Ashtu si dhe në rastin e P/CVE-së, si PVE-ja edhe CVE-ja kanë përpjekje proaktive dhe parandaluese në thelb të tyre. Në fakt, sipas Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, “një dallim mund të bëhet zakonisht midis CVE-së, që fokusohet te kundërvënja ndaj veprimtarisë së ekstremistëve të dhunshëm ekzistues, dhe PVE-së, që fokusohet te parandalimi i përhapjes së mëtejshme të ekstremizmit të dhunshëm”. Megjithatë, “në praktikë, nismat punojnë shpesh në të dyja aspektet, me një qasje të kombinuar”²⁶. Kjo është veçanërisht e vërtetë në kontekstin e programeve apo ndërhyrjeve që fokusohen te shkëputja nga VERLT-i dhe rikthimi në shoqëri i individëve që janë përfshirë apo ekspozuar ndaj terrorizmit apo VERLT-it.

Spektri i aktiviteteve, programeve dhe llojit të angazhimeve që klasifikohen nën P/CVERLT është i gjerë dhe përfshin përpjekje në nivel ndërkombëtar, rajonal, kombëtar, nënkombëtar, komunitar dhe individual.²⁷

Në disa raste, politikëbërësit dhe praktikuesit në fushën e P/CVERLT-it janë munduar të përcaktojnë kufij të qartë midis programeve P/CVERLT dhe programeve të nisura brenda fushave të mirëpërcaktuara si zhvillimi, të drejtat e njeriut, zbutja e varfërisë, zgjidhja e konfliktit, ndërtimi i paqes, qeverisja dhe edukimi. Të dyja llojet e programeve janë hartuar për t’iu kundërvënë faktorëve që nxisin ekstremizmin e dhunshëm në vende specifike: rrjete sociale ekstremiste, këshillues të radikalizuar në dhunë, hakmarrja, në kërkim të një statusi, dhe një mori e tërë faktorësh motivues, mundësues dhe strukturorë. Në përgjithësi, këto përpjekje synojnë të arrijnë individë të identifikuar në mënyrë specifike si “në rrezik” ose “vulnerabël” për t’u tërhequr ndaj dhunës, si dhe ata që janë radikalizuar në dhunë ekstremiste apo janë të shoqëruar me terrorizmin ose VERLT-in.²⁸

Tri mënyra të zakonshme për kategorizimin e programeve P/CVERLT janë sipas **llojit**: ndërgjegjësimi dhe ndërtimi i besimit, trajnimi, dialogu, dhe komunikimi strategjik; sipas **përfituesve**: komuniteti/grupi (përfshirë familjen) ose individi; dhe sipas **funksionit**: parandalimi, ndërhyrja dhe R&R. Duhet theksuar se këto dallime midis këtyre kategorive janë të dobishme për qëllime planifikimi dhe vlerësimi, por rrallë janë të prera me thikë, sidomos në praktikë. Për shembull, disa programe mund të futen në më shumë se një funksion apo lloj.

²⁵ European Commission, EU Operational Guidelines on the Preparation and Implementation of EU Financed Actions Specific to Countering Terrorism and Violent Extremism in Third Countries, RUSI and CIVPOL, November 2017, https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/eu-ct-cve-guidelines-20171213_en.pdf.

²⁶ UN Development Programme, *Journey to Extremism in Africa: Drivers, Incentives, and the Tipping Point For Recruitment*, 2017, <http://journey-to-extremism.undp.org/content/downloads/UNDP-JourneyToExtremism-report-2017-english.pdf>.

²⁷ Georgia Holmer and Peter Bauman, *Taking Stock: Analytic Tools for Understanding and Designing P/CVE Programs*, US Institute of Peace, August 2018, <https://www.usip.org/publications/2018/09/taking-stock-analytic-tools-understanding-and-designing-pcve-programs>.

²⁸ James Khalil and Martine Zeuthen, *Countering Violent Extremism and Risk Reduction: A Guide to Programme Design and Evaluation*, Whitehall Report, RUSI, 8 June 2016, https://rusi.org/sites/default/files/20160608_cve_and_rr.combined.online4.pdf.

Programi i parandalimit është hartuar në mënyrë tipike me qëllim ndërtimin e rezistencës së komunitetit ndaj VERLT-it dhe kohezioni social për t'i rezistuar joshjes së VERLT-it. Këto programe, të cilat synojnë të arrijnë komunitete që nuk janë të radikalizuara në dhunë, janë të formave të ndryshme. Për shembull, ato mund të përfshijnë mësim për paqen dhe tolerancën; promovimin e të drejtave të njeriut dhe të mirëqeverisjes; trajnimin profesional dhe mentorimin; ndërgjegjësimin për kërcënimin e ekstremizmit të dhunshëm në shkolla dhe komunitet; fushata për informimin e publikut dhe debate në komunitet për tema të ndjeshme; dialog midis besimeve fetare dhe brenda besimit fetar; programe për fuqizimin e të rinjve dhe grave; ndërtimin e kapaciteteve të mësuesve dhe udhëheqësve të komunitetit për t'u angazhuar në përpjekje P/CVERLT; mesazhe në media dhe fushata me mesazhe pozitive alternative; dhe ndërtimi i besimit midis komuniteteve dhe aktorëve të ligjzbatimit. Në kontekstin e shëndetit publik, ky njihet si “parandalimi parësor”.

Programi i ndërhyrjes, në mënyrë tipike synon të arrijë audiencat në rrezik²⁹ dhe kërkon të ndërhyjë në rrugëtimin e një personi drejt radikalizimit terrorist para se të kapërcehet vija e kriminalitetit. Në mënyrë tipike, programet janë mbi baza vullnetare dhe mund të përfshijnë një ose më shumë nga sa vijon: mbështetje psikologjike, mentorim, këshillim familjar, veprimtari kulturore apo zbatimëse, debate teologjike/doktrinale, edukim dhe trajnim e mbështetje për punësim, dhe mekanizma të referimit. Këto, nga këndvështrimi i shëndetit publik, klasifikohen si “parandalim dytësor”.

Programet R&R u drejtohen individëve të radikalizuar për akte të dhunshme (përfshirë, po jo vetëm, ata që kanë kryer vepra që lidhen me terrorizmin) dhe mundet edhe familjet e tyre, si dhe atyre që, për arsye të ndryshme, nuk kanë hyrë në sistemin e burgjeve, por mund të shfaqin në një farë mase mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm, përfshirë ata që janë kthyer nga territori nën sundimin e Shtetit Islamik në Irak dhe Levant (ISIL) -Da'esh. Programet R&R mund të zbatohen në burgje ose jashtë kontekstit të burgut si për shembull në komunitet apo si pjesë e shërbimit të provës. Shpesh të hartuara për rikthimin në shoqëri, programet R&R mund të përfshijnë më shumë se një element të tillë si këshillimi fetar, psikologjik apo familjar; trajnimi profesional dhe vendosja në një punë; edukimi; veprimtari kulturore dhe zbatimëse; dhe mentorimi.

²⁹ Procesi i identifikimit për individët dhe grupet “në rrezik” has një shumëllojshmëri pengesash dhe ndjeshmëri. Indikatorët që përdoren për të identifikuar individët “në rrezik” duhet të merren në konsideratë me kujdes, në mënyrë që të shmangen implikimet e dëmshme, si për shembull identifikimi i gabuar që mund të çojë në stigmatizim apo marginalizim.



3. Veçori dalluese të R&R jashtë kontekstit të burgut

Ky seksion eksploron konceptin, praktikën dhe veçoritë dalluese të R&R në kushte jashtë burgu. Ai fillon me diskutimin mbi interesin në rritje për R&R në përgjithësi, më pas përshkruan debatin e vazhdueshëm se cilët duhet të jenë objektivat e tij, më tej kalon në shqyrtimin e dallimeve dhe ngjashmërive me ndërhyrjet P/CVERLT që synojnë të arrijnë individë që nuk kanë kryer një krim, dhe mbyllet me shpjegimin se si versioni jashtë kontekstit të burgut i R&R-së ndikohet nga forma e tij në kontekstin e burgut.

Vende në rajonin e OSBE-së po i kushtojnë gjithmonë e më shumë vëmendje faktit se si të operacionalizojnë një qasje gjithëpërfshirëse për trajtimin e kërcënimeve që vijnë nga terrorizmi dhe VERLT-i, e cila balancon masat tradicionale të anti-terrorizmit si arresti, ndalimi, dhe kufizimi i lëvizjes me masa të ndryshme P/CVERLT që përfshijnë parandalimin, ndërhyrjen dhe politikat e programet R&R.

3.1 Interesi në rritje për R&R

Koncepti i R&R, në veçanti, po merr një vëmendje të shtuar nga qeveritë kombëtare dhe autoritetet nënkombëtare, nga shoqëria civile dhe aktorë të tjerë joqeveritarë, si dhe nga organe shumëpalëshe si Kombet e Bashkuara, Forumi Global Kundër Terrorizmit, Bashkimi Evropian, dhe Këshilli i Evropës. (Arsyet për këtë rritje të interesit renditen në Seksionin 1 të këtij raporti.)

Në vitet e fundit, programe R&R, të përshtatura sipas rastit, të fokusuara te terrorizmi dhe VERLT-i kanë fituar më shumë vëmendje: disa prej tyre synojnë të arrijnë ekstremistët e dhunshëm në burgje; të tjerë punojnë me individë që janë në fazë transferimi nga burgju në shoqëri; dhe një kategori e tretë fokusohet te individët që kanë pasur një kontakt me terrorizmin apo VERLT-in, por nuk janë akuzuar apo dënuar për ndojnë krim (por mund t'u jenë nënshtruar “masave administrative”) ose po kërkojnë të shkëputen nga një grup ekstremist i dhunshëm. Gjithnjë e më shumë, këto programe po përdoren për të mbështetur ata që rikthehen apo po largohen nga Iraku apo Siria, të cilët nuk janë ndjekur penalisht dhe janë vlerësuar se kërkojnë mbështetje për t'u rikthyer në komunitetet e tyre.

Programet R&R ndryshojnë për sa u takon objektivit, komponentëve, ofruesve të ndërhyrjes, dhe natyrës së vullnetare të pjesëmarrjes. Disa udhëhiqen nga qeveritë, të tjerë nga OSHC-të dhe aktorë të tjerë joqeveritarë, ndërsa të tjerë akoma përfshijnë një partneritet publik-privat. (Shtojca 2 paraqet shembuj të llojeve të ndryshme të programeve.) Pjesa më e madhe e tyre trajtojnë një gamë ndërhyrjesh që mund të përfshijnë këshillimin ideologjik dhe/ose psikologjik, trajnimin profesional, vendosjen në punë, strehimin, edukimin, dhe veprimtari kulturore ose zbavitëse. Meqenëse individët që synohen të arrihen dhe familjet e tyre do të kenë një sërë vulnerabilitetesh dhe nevojash - praktike, psikologjike, dhe/ose ideologjike - një aktor apo institucion i vetëm ka pak gjasë t'i trajtojë ato të gjitha. Për këtë arsye, siç diskutohet në Seksionin 7, është zbatuar një qasje që lejon përfshirjen e praktikuesve dhe profesionistëve nga shumë fusha.

3.2 Objektivat: shkëputja përkundrejt deradikalizimit

Në mënyrë tipike, programet R&R (si në burg edhe në kontekstin jashtë burgut) kanë njërin ose të dy objektivat: *shkëputjen* (d.m.th. nxitja e përfituesve të programit që të heqin dorë nga përdorimi i dhunës - ndryshim i sjelljes) - ose *deradikalizimin* (d.m.th. ndryshimi i ideologjisë ose bindjeve të përfituesve - ndryshim konjitiv).³⁰

Sipas Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat (UNODC), ndërhyrjet që kanë të bëjnë me shkëputjen, në mënyrë tipike “kanë të bëjnë me një larmi aktivitësh, përfshirë: këshillim dhe mbështetje psikologjike; programe konjitive- të sjelljes; ndërhyrje të punës sociale; debat dhe dialog që bazohet te besimi; edukimi; trajnimi profesional; terapi krijuese; terapi fizike

³⁰ Për një diskutim të dallimeve dhe qëndrimeve pro e kundra për secilën, shih, për shembull Marsden, *Reintegrating Extremists*, and Daniel Koehler, *Understanding Deradicalization Methods, Tools, and Programs for Countering Violent Extremism* (Abingdon, UK: Routledge, 2016).

(p.sh. yoga, sport, ushtrime); veprimtari familjare; dhe aktivitete sociale, kulturore dhe zbavitëse.”³¹ Nga ana tjetër, ndërhyrjet për deradikalizim prirën të mbështeten në masë të madhe te studiues fetarë të trajnuar në mënyrë të posaçme; mentorë, psikologë, psikiatër, apo profesionistë të tjerë të shëndetit mendor; dhe te “ishët”.

Përkufizimi i rolit të një programi R&R - për të sjellë ndryshim në botëkuptimin apo në sjellje të individit të synuar - është e rëndësishme në veçanti për qëllime vlerësimi (shih Seksioni 5.7). Gjithashtu, disa qëllime mund të arrihen më me vështirësi se sa disa të tjerë. Shumë ekspertë pohojnë se ndërhyrjet R&R që fokusohen në ndryshimin e sjelljes kanë gjasë të jenë më të arritshme, më pak të kushtueshme, dhe më të efektshme se programet që kërkojnë të ndryshojnë bindjet.³² Të tjerë, megjithatë, pohojnë se “roli i ideologjisë dhe qëndrimit të personit” është kaq i rëndësishëm saqë “shkëputja [e bindjeve] mund të krijojë një rrezik më të lartë për recidivizëm.”³³

Një tjetër rrymë është e mendimit se programet R&R duhet t’i përqafojnë të dy objektivat. Rrjeti i Komisionit Evropian për Ndërgjegjësimin mbi Radikalizimin (RAN), për shembull, argumenton se “një qasje për riintegrimin që fokusohet vetëm te deradikalizimi e humbet faktin kyç për largimin nga grupet ekstremiste dhe terroriste dhe bazohet në një mori arsyesh që shkojnë përtej ideologjisë. Këto arsye përfshijnë zhgënjimin me efektshmërinë e dhunës, prishjen e marrëdhënieve me bashkatdhetarët, dhe tërheqjen drejt një jete të rregullt. Nga ana tjetër, faktorë si presioni i rrethit shoqëror dhe frika e hakmarrjes mund të krijojë vështirësi për të hequr dorë nga përfshirja në grupe ekstremiste apo terroriste.”³⁴

Një nga nismat me këtë fokus të dyfishtë është programi danez Aarhus. Ai kërkon të ndryshojë pikëpamjet dhe sjelljet ekstremiste të dhunshme ndërkohë që jep një strukturë mbështetëse gjithëpërfshirëse për të mundësuar riintegrimin në shoqëri, duke pranuar që “rikthimi i suksesshëm në të gjitha fushat e jetës sociale është me rëndësi kyçe për parandalimin e sjelljes ekstremiste të dhunshme dhe sjellje të tjera kriminale; problemet psikologjike apo sociale mund ta shtyjnë një individ të rikthehet përsëri në mes të lëvizjeve ekstremiste, ndonëse ai apo ajo e ka ndryshuar mendimin e vet në lidhje me vlefshmërinë e ideologjisë ekstremiste.”³⁵

31 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin, *Handbook on the Management of Violent Extremist Prisoners and the Prevention of Radicalization to Violence in Prisons* (Vienna: UN Office on Drugs and Crime, 2016), f.78, https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/Handbook_on_VEPs.pdf (në vijim UNODC VEP Handbook). 32 po aty., f. 71.

33 Koehler, *Understanding Deradicalization Methods*, p. 232.

34 Rrjeti i BE-së për Ndërgjegjësimin mbi Radikalizimin (RAN), Qendra e Ekselencës, *Foreign Fighter Returnees and the Reintegration Challenge*, RAN Issue Paper, November 2016, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_foreign_fighter_returnees_reintegration_challenge_112016_en.pdf.

35 Tinka M. Veldhuis, *Reintegrating Violent Extremist Offenders: Policy Questions and Lessons Learned*, George Washington University Program on Extremism Occasional Paper, October 2015, f. 5, <https://extremism.gwu.edu/sites/g/files/zaxdzs2191ff/downloads/Veldhuis.pdf>.

Megjithatë, jo të gjithë bien në një mendje për këtë qasje me dy degë. Për shembull, udhëzimet e OSBE/ODIHR-it për trajtimin e sfidave të “LHT”-ve brenda kuadrit të të drejtave të njeriut shprehin se përpjekjet R&R “duhet të fokusohen shprehimisht në ‘shkëputjen’ nga terrorizmi apo dhuna më shumë se sa në nocionet më amorfe të ‘deradikalizimit’ që synojnë të ndryshojnë ideologjitë apo bindjet.”³⁶ Kjo vjen për shkak se standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut garantojnë që cilido gëzon të drejtën për të pasur një bindje dhe opinione pa ndërhyrje.³⁷ Për këtë arsye, deradikalizimi që synon ndryshimin e opinionëve dhe bindjeve të individit paraqet rreziqe të qenësishme për të drejtat e njeriut; dhe një qasje që kërkon shkëputjen nga dhuna duket të jetë më konsistente me konceptin e OSBE-së për VERLT-in siç përshkruhet në Seksionin 2.1.

Pavarësisht nga qëllimi, programet R&R kërkojnë që të arrihet të kuptohet sesi dhe pse disa persona përfshihen në VERLT, ku arsyet janë nga më të ndryshmet dhe shtrihen përgjithësisht përtej përfaqimit të një ideologjie të caktuar. Për këtë arsye, programe të tilla nevojitet të jenë fleksibël dhe të përshtaten sipas kontekstit specifik dhe motiveve të individit.

3.3 Krahasimi i ndërhyrjeve terciare R&R dhe dytësore P/VERLT në këndvështrimin e shëndetit publik

Ndërkohë që ka një rritje të njohjes së shkallës së dëmit që mund të shkaktojë VERLT-i në shoqëri në tërësinë e saj, qasjet parandaluese ndaj VERLT-it po mbështeten gjithmonë e më shumë te mësimet nga fusha e shëndetit publik, i cili është parë tradicionalisht i lidhur me parandalimin e sëmundjeve dhe promovimin e sjelljeve dhe konteksteve të shëndetshme. 38 Ndër këto mësimet është edhe rëndësia e identifikimit të ndërhyrjeve praktike dhe mbrotjëse për të

36 OSCE/ODHIR, *FTF Guidelines*, f. 61. Shih edhe UNODC *VEP Handbook*; and International Committee of the Red Cross (ICRC), “Radicalization in Detention: The ICRC’s Perspective”, 11 July 2016, <https://www.icrc.org/en/document/responding-radicalization-detention-icrc-perspective>.


37 Shih nenet 18 (1) dhe 19 (1) të Paktit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR). Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mbrojnë shprehjen e pikëpamjeve dhe bindjeve, të cilat disa mund t’i konsiderojnë si radikale apo ekstreme, përveç rasteve kur kjo shprehje lidhet me dhunën apo ndonjë veprë tjetër të paligjshme (si nxitja) në përputhje me përkufizimin në të drejtën ndërkombëtare.

38 Sikurse shtjellohet në një udhëzues të kohëve të fundit të OSBE-së për P/CVERLT që fokusohet te mekanizmat e referimit, disa ekspertë sugjerojnë që dhuna e grupit - kornizat e reduktimit, si dhe modelet e shëndetit publik mund të jenë të dobishme për qëllime të hartimit dhe përpilimit të programit P/CVERLT. Shih OSCE, *Understanding Referral Mechanisms in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism and Violent Extremism: Navigating Challenges and Protecting Human Rights—A Guidebook for South-Eastern Europe*, 2019, pp. 37–39, <https://www.osce.org/secretariat/418274?download=true> (hereinafter, OSCE, *Understanding Referral Mechanisms*); David P. Eisenman and Louise Flavahan, “Canaries in the Coal Mine: Interpersonal Violence, Gang Violence, and Violent Extremism through a Public Health Prevention Lens,” *International Review of Psychiatry* 29, no. 4 (August 2017): 341–49, <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/28805121>; and YouthPower, “Promising Practices in Engaging youth in Peace and Security and P/CVE,” September 2017, <https://static.globalinnovationexchange.org/s3fs-public/asset/document/Peace%20and%20Security%20Brief%209-21-17%20PRINT%20FINAL-OK.pdf?dV0v5HTaHk3ANPea6AL3145G5XbJ2A0>.

administruar kërcënime të mundshme, që mund të kenë një ndikim pozitiv në jetën e përditshme të individëve.³⁹ Një qasje e mbështetur te shëndeti publik ofron gjithashtu mundësi për të hartuar programe që kanë shumë qëllime, shmangin stigmën dhe shfrytëzojnë burimet njerëzore të shëndetit publik (si, profesionistë të shëndetit mendor dhe punonjës socialë) të cilat nuk mundësohen nga asja e mbështetur te zbatimi i ligjit.

Duke pasur parasysh këto përfitime, në Figurën 1 përshkruhet një model i shëndetit publik me tri nivele, i cili po zbatohet gjithmonë e më shumë për P/CVERLT-in. *Parandalimi parësor* konsiston në “strategji në nivel komuniteti që zbusin rrezikun e modifikueshëm (p.sh. disponueshmëria e medias ekstremiste të dhunshme) dhe shfrytëzimi i faktorëve mbrojtës (p.sh. mbrojtje prindërore, rrjeti shoqëror, administrimi i pritshmërive, njohuria fetare dhe edukimi)”. *Parandalimi dytësor* “mund të përfshijë strategji që u drejtohen individëve që janë identifikuar se kanë disa karakteristika që i bëjnë ata të jenë në rrezik të shtuar për ekstremizëm të dhunshëm, si për shembull ekspozimi ndaj ideologjive ekstremiste të dhunshme apo afërsia me një rrjet shoqëror të radikalizuar.” *Parandalimi tretësor* “mund të përfshijë strategji që u drejtohen individëve që tashmë kanë përvetësuar ideologji ekstremiste apo janë në kontakt me ekstremistë të dhunshëm, por nuk janë angazhuar në planifikimin apo zbatimin e akteve të dhunës.”⁴⁰

Figura 1. Modeli i shëndetit publik për CVE



BURIMI: Jonathan Challgren et al., *Countering Violent Extremism: Applying the Public Health Model*, 1st ed. (Georgetown University, Center for Security Studies, National Security Critical Issues Task Force, 2016), <http://georgetownsecuritystudiesreview.org/wp-content/uploads/2016/10/NSCITF-Report-on-Countering-Violent-Extremism.pdf>. Terminologjia e përdorur në këtë Figurë nuk përkon domosdoshmërisht me atë të OSBE-së.

39 Stevan Weine and David Eisenman, *How Public Health Can Improve Initiatives to Counter Violent Extremism*, National Consortium for the Study of Terrorism and Responses to Terrorism (START), University of Maryland, 5 April 2016, <https://www.start.umd.edu/news/how-public-health-can-improve-initiatives-counter-violent-extremism>.

40 Po aty.

Në këtë model, programet R&R jashtë kontekstit të burgut klasifikohen në kategorinë parandalimit terciar, sidomos për shkak të nivelit të radikalizimit të individëve që përfshihen, ndërsa ndërhyrjet P/CVERLT që fokusohen në ata individë që nuk kanë kryer një krim përshtaten më mirë me kategorinë e parandalimit dytësor. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se nuk kanë ngjashmëri midis tyre, sidomos në lidhje me instrumentet dhe përqsjet që përdorin. **Ngjashmëritë** përfshijnë sa më poshtë:

1. Mbështetja në një gamë të gjerë profesionistësh, përfshirë psikologë, psikiatër, apo profesionistë të tjerë të shëndetit mendor; këshillues fetarë, të rinjve dhe të tjerëve; mentorë (përfshirë “ishët”); mësues; punonjës socialë dhe të bashkisë; dhe policia.
2. Ndërtimi i marrëdhënieve të mbështetura në mes praktikuesve dhe profesionistëve si dhe midis tyre dhe klientëve është e rëndësishme.
3. Një ndërhyrje e rekomanduar duhet të ndjekë një vlerësim shumëdimensional të nevojave dhe rreziqeve të individit.
4. Aktorët e shumtë të përfshirë duhet të shkëmbejnë informacion dhe të bashkëpunojnë, po duhet edhe të respektojnë privatësinë dhe të drejtat për mbrojtjen e të dhënave personale të përfituesit dhe ta trajtojnë informacionin e ndjeshëm me fshehtësi;
5. Personel i mirë-trajnuar dhe burime të mjaftueshme janë të nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri;
6. Fleksibiliteti duhet të ndërtohet në projektimin e programit në mënyrë që të mundësojë një program për t’iu përshtatur rrethanave të paparashikuara; dhe
7. Angazhimi jo vetëm me individin, por, kur është e përshtatshme, edhe me familjen, komunitetin lokal dhe/ose rrjetin e shokëve është i rëndësishëm.

Pavarësisht nga këto ngjashmëri dhe ngjashmëri të tjera, ekzistojnë dallime të rëndësishme. Programet R&R, si në kontekstin e burgut edhe jashtë tij, shpesh paraqesin një grup të dallueshëm çështjesh dhe sfidash që aktorët e përfshirë duhet t’i mbajnë parasysh me kujdes ndërkohë që zhvillojnë nisma R&R.

Këto **dallime** përfshijnë sa më poshtë:

1. Krahasuar me përfituesit e ndërhyrjet P/CVERLT, përfituesit e përpjekjeve R&R në kontekst jashtë burgut ka më shumë gjasë të vuajnë nga çrregullimi i stresit post-traumatik (PTSD) apo forma të tjera të traumës si rrjedhojë e ekspozimit të tyre ndaj dhunës dhe janë në mënyrë tipike më të avancuar në rrugën drejt VERLT-it. Si rrjedhojë, programet R&R mund të kërkojnë trajnim dhe angazhim më të specializuar për çështje psikologjike, ideologjike dhe teologjike se sa programet që fokusohen te parandalimi.
2. Për shkak se përfituesve të programeve R&R shpesh do të kërkojnë të fillojnë një jetë të re në komunitetet nga të cilat u larguan - ndërkohë që disa kanë vuajtur dënim në burg - në mënyrë tipike ata **do të kërkojnë mbështetje më intensive dhe të qëndrueshme për një sërë çështjesh praktike me qëllim lehtësimin e rikthimit të tyre në shoqëri**. Kjo mbështetje mund të përfshijë strehimin, edukimin, trajnimin profesional, dhe vendosjen në punë.

3. Në punën me individë që kthehen nga zonat e konfliktit, përfshirë Irakun dhe Sirinë, të cilët në fund të fundit nuk ndiqen penalisht, programet R&R duhet të trajtojnë, , nevojat unike të anëtarëve të familjes që kthehen, përfshirë gratë dhe fëmijët përmes ndërhyrjeve të përshtatura rast pas rasti.⁴¹
4. Individët që kanë nevojë për mbështetje R&R në kontekstin jashtë burgut (përfshirë ata që dalin nga burgu, që kthehen nga zona konflikti, apo që perceptohen se kanë pasur lidhje me terrorizmin apo VERLT-in) ka më shumë gjasë të ndihen të stigmatizuar dhe të mohuar dhe të diskriminuar nga komunitetet në të cilat ata po shpresojnë të kthehen. Këta faktorë mund ta bëjnë më të vështirë zhvillimin e marrëdhënieve të ndërtuara mbi besim midis, nga njëra anë, individit dhe, nga ana tjetër, praktikuesve profesionistë lokalë dhe komunitetit që e pret marrëdhënie që janë me rëndësi kritike për të arritur përpjekje R&R të efektshme dhe të qëndrueshme. Si rrjedhojë, të gjithë këta faktorë, nëse nuk zbuten, mund t'i ndërlikojnë përpjekjet për t'u mundësuar individëve të kenë qasje në mbështetje kritike psikologjike, për edukim, strehim dhe formim profesional.
5. Duke pasur parasysh oreksin e pakët për të ndërmarrë rrezik, agjencitë kombëtare të sigurisë dhe agjencitë vendore ligjzbatuese mund të ngurrojnë të shkëmbejnë informacion dhe të ndajnë përgjegjësi me aktorë në nivel komuniteti, përfshirë qeverisjen vendore dhe shoqërinë civile, të cilat shpesh janë me rëndësi kritike për çdo përpjekje R&R. Ky ngurrim mund të theksohet më shumë në rastin e përpjekjeve R&R që synojnë të arrijnë individë që kthehen nga zonat e konfliktit, duke pasur parasysh rrezikun real apo të perceptuar për sigurinë që ata paraqesin; dhe
6. Suksesi i programeve R&R jashtë kontekstit të burgut që fokusohen te ish terroristët varet, në një masë të madhe, nga përvojat e vetë individit gjatë kohës që vuante dënimin në burg.

3.4 Burgjet dhe R&R jashtë kontekstit të burgut

Përveç sigurimit të kushteve njerëzore dhe të sigurta, në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshirë ato që përvijohen në Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat Mandela),⁴² shërbimet e burgut priten që të punojnë drejt shkëputjes së autorëve të veprave ekstremiste të dhunshme (dhe të veprave të tjera të dhunshme) prej veprave të dhunshme në të ardhmen dhe, duke vepruar në këtë mënyrë, t'i përgatisin ata

41 Shih Seksioni 11 për një diskutim mbi nevojën për të hartuar programe që marrin parasysh ndjeshmërinë mbi bazë gjinore dhe të moshës.

42 United Nations Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (The Nelson Mandela Rules), 2015, <https://cdn.penareform.org/wp-content/uploads/1957/06/ENG.pdf>. Shih edhe OSCE/ODIHR and Penal Reform International, *Guidance Document on the Nelson Mandela Rules: Implementing the Revised Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners*, 2018, <https://www.osce.org/odihr/389912?download=true>.

për riintegrimin social në komunitet.⁴³ Kushtet çnjerëzore të burgimit jo vetëm që pengojnë gjasat e një R&R pas lirim, por rrisin mundësitë për recidivizëm.⁴⁴

Rikthimi nga kushtet e burgut në shoqëri duhet të nisë që në burg, ku autorë të veprave ekstremiste të dhunshme (si të gjithë të burgosurit) mund të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me sundimin e ligjit, dhe të marrin mbështetje për t'i përgatitur ata në aspektin social dhe psikologjik, si dhe në atë praktik, për rikthimin në shoqëri.⁴⁵

Siç theksohet në hyrje të këtij raporti, me rritjen e numrit të autorëve të veprave që lidhen me terrorizmin, është rritur bindja se burgjet mund të shërbejnë si inkubatorë për VERLT-in, dhe rëndësia e R&R të përshtatur për këtë kategori të popullatës së burgjeve, që vazhdon pas lirim, ka garantuar përfshirjen e organeve shumëpalëshe, qeverisë dhe organizata joqeveritare në hartimin e një numër udhëzuesish dhe dokumentash kuadër dhe praktika të mira që fokusohen te këto çështje në kontekstin e parandalimit dhe kundërvënies ndaj terrorizmit dhe VERLT-it.⁴⁶

Gjithashtu, ndonëse në disa vende në rajonin e OSBE-së autorët e veprave ekstremiste të dhunshme kanë qasje vetëm në disa programe rehabilitimi të disponueshme për popullatën e përgjithshme të burgut,⁴⁷ një numër shtetesh të tjera pjesëmarrëse në OSBE kanë përgatitur programe të specializuara të përshtatura për atë që shumë i debatojnë si nevoja unike të një personi që ka qenë klasifikuar si terrorist. Ato kanë përfshirë në mënyrë tipike trajnimin e personelit të burgut në vlerësimin e rreziqeve të autorëve të veprave ekstremiste të dhunshme, duke u dhënë këtyre autorëve këshillim ballë-për-ballë për çështje fetare apo ideologjike, duke angazhuar familjen dhe udhëheqës të komunitetit,

43 Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut u kërkojnë Shteteve të sigurojnë që sistemi penitenciar të orientohet drejt reformimit dhe rehabilitimit social të të burgosurve. Shih ICCPR, neni 10, paragrafi 3. Më tej, këto standarde u kërkojnë Shteteve të sigurojnë që të burgosurit të jenë të mbrojtur ndaj torturës apo trajtimeve dhe dënimeve mizore, çnjerëzore e poshtëruese. Kjo përfshin izolim pa kufizim apo të tejzgjat, një praktikë të cilën disa vende e vazhdojnë, përfshirë edhe për autorët e veprave që lidhen me terrorizmin. Shih UNODC *VEP Handbook*; and *Global Center on Cooperative Security (GCCS), Compendium of Good Practices in the Rehabilitation and Reintegration of Violent Extremist Offenders*, October 2018, p. 7, <https://www.veocompendium.org/download.html>.

44 UNODC *VEP Handbook*.

45 EU RAN, *Approaches to Violent Extremist Offenders and Countering Radicalisation in Prisons and Probation*, RAN Prison and Probation Practitioners' Working Paper, 2016 (hereinafter RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2016), https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ran_pp_approaches_to_violent_extremist_en.pdf.

46 Këtu përfshihen: RAN Prison and Probation Working Group, *Approaches to Countering Radicalisation and Dealing with Violent Extremist and Terrorist Offenders in Prisons and Probation*, 2019 (në vijim RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2019), https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ran_wrk_pp_pract_3rd-2018_20190606_en.pdf; UNODC *VEP Handbook*; Council of Europe, *Prison: A Breeding Ground for Radicalisation and Violent Extremism?*, 2018, <https://book.coe.int/en/human-rights-and-democracy/7602-prison-a-breeding-ground-for-radicalisation-and-violent-extremism.html>; Council of Europe, *Guidelines for Prison and Probation Services Regarding Radicalisation and Violent Extremism*, 2016, <https://rm.coe.int/16806f3d51>; and Global Counterterrorism Forum (GCTF), *Rome Memorandum on Good Practices for Rehabilitation and Reintegration of Violent Extremist Offenders*, 2012, <https://toolkit.thegctf.org/en/Rehabilitation-and-Reintegration/Detail/id/70>. GCCS, *Compendium of Good Practices*.

47 Shih, për shembull, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara

dhe duke vendosur lidhje midis organizatave në komunitet, me qëllim që të sigurohet që autorët e këtyre veprave të vijnë nga programi pas lirisë.⁴⁸

Planifikimi për programe paslirimi duhet të fillojë ndërkohë që autori i veprës është ende i burgosur dhe duhet të përfshijë bashkëpunim me të burgosurin. Kjo qasje garanton vijimësi në programet në kontekste burgu dhe jashtë tij, dhe krijon mundësi për një vlerësim të saktë tërreziqëve dhe nevojave për autorët e veprave; si dhe, identifikon ndërhyrjet e duhura, idealisht nga një ekip multidisiplinor ekspertësh.⁴⁹ Të paktën gjashtë muaj para lirisë, profesionistët duhet të fillojnë “të punojnë me ish-autorët e veprave *brenda* burgut” ndërkohë që “vazhdojnë të përmbushin rolin e tyre këshillues *jashtë* tij, në mënyrë që të sigurohet një marrëdhënie afatgjatë dhe me besim dhe të ruhet stabiliteti.”⁵⁰

Kombet e Bashkuara dhe organizata të tjera kanë identifikuar një sërë **hapash shtesë që duhet të merren në konsideratë në përgatitjen e autorëve të veprave ekstremiste të dhunshme për rikthimin në komunitetet e tyre**. Këta hapa, të cilët mund të ndikojnë në zbatimin e masave R&R pas lirisë, përfshijnë:

1. Zhvillimin e programeve për tranzicionin që nxisin partneritete të ngushta midis familjeve, OSHC-ve, dhe aktorëve të tjerë brenda komunitetit në të cilin do të kthehet autori i veprës ekstremiste të dhunshme (ose vjen për herë të parë, në rastin e atyre që shpërngulen në një vend të ri) dhe që besimi, angazhimi dhe mbështetja e të cilëve do të jetë me rëndësi thelbësore por çdo përpjekje R&R pas lirisë; dhe
2. Realizimin e përpjekjeve ndërgjegjësuese dhe angazhimit me komunitetin pritës me qëllim që të reduktohet stigma dhe paragjykimet për ata që janë etiketuar si “terroristë”; sigurimin që siguria e të burgosurit të liruar (dhe familjes dhe miqve të tij apo të saj) kur ka një kërcënim të besueshëm; dhe vendosja e kushteve pas lirisë, të cilat janë proporcionale dhe që balancojnë nevojën për të siguruar siguri të komunitetit me mundësitë për shkëputje.⁵¹ Në lidhje me pikën e fundit, studimet sugjerojnë që një mbikëqyrje e rreptë masive kontrolluese tepër kufizuese, të tilla si detyrimi për paraqitje dhe urdhrat për rezidencë të përcaktuar mund të krijojnë barriera për autorët e veprave që të gjejnë punë dhe, më gjerësisht, për rikthimin dhe riintegrimin në komunitet.⁵²

48 Shembuj të këtyre programeve përfshijnë ato që po zbatohen në Austri, Belgjikë, Danimarkë, Finlandë, Francë, Gjermani, Itali, Vendet e Ulëta, Norvegji, Spanjë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Për informacion mbi programet përkatëse në këto vende dhe vende të tjera në Bashkimin Evropian, shih EU RAN, “Preventing Radicalisation to Terrorism and Violent Extremism: Prison and Probation Interventions,” 2018, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/prison-and-probation-interventions_en.pdf.

49 GCCS, *Compendium of Good Practices*.

50 EU RAN, *The Challenge of Resocialisation: Dealing with Radicalised Individuals During and After Imprisonment*, RAN Ex Post Paper, November 2018, p. 6, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ran_pp_dealing_with_radicalised_individuals_06_112018_en.pdf.

51 UNODC, *Key Principles and Recommendations for the Management of Violent Extremist Prisoners and the Prevention of Radicalization to Violence in Prisons*, 2016 https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/Summary-of-recommendations-on-VEPs.pdf; Council of Europe, *Handbook for Prison and Probation Services Regarding Radicalization and Violent Extremism* (hereinafter “Council of Europe Handbook”), 2016, <https://www.researchgate.net/publication/322100931>; and GCCS, *Compendium of Good Practices*.

52 Brian A. Jackson, Ashley L. Rhoades, Jordan R. Reimer, Natasha Lander, Katherine Costello, and Sina Beagley, *Practical Terrorism Prevention Reexamining U.S. National Approaches to Addressing the Threat of Ideologically Motivated Violence*, RAND, 2019, p. 191, n. 25, https://www.rand.org/pubs/research_reports/RR2647.html.



4. Kuadri ligjor dhe i politikave

Masat dhe programet R&R që respektojnë të drejtat e njeriut, përfshirë ato që synojnë të arrijnë individë jashtë kontekstit të burgut, janë me rëndësi thelbësore jo vetëm për parandalimin e veprave të dhunshme në afatin e afërt, por edhe për ndërtimin e rezistencës së përgjithshme në nivel komuniteti ndaj VERLT-it. Në këtë mënyrë, ashtu si edhe kanë rekomanduar Forumi Global Kundër Terrorizmit (GCTF) dhe organizma të tjera ndërkombëtare, koncepti i R&R, si në kontekstin e përgjigjes së drejtësisë penale ndaj VERLT-it edhe si pjesë e një qasjeje më të gjerë, duhet të ndërtohet në mënyrë solide mbi kuadrin përkatës ligjor dhe të politikave, përfshirë planet kombëtar të veprimit për P/CVERLT.⁵³ Për ata individë që janë akuzuar për veprimtari kriminale, kuadri përkatës ligjor dhe ai i politikave duhet të përqafojë nocionin se procesi R&R i kthimit të tij në shoqëri nuk është aspak më pak i rëndësishëm se sa masat ndëshkuese.

Këta korniza nuk duhet të kufizohen vetëm te konteksti i drejtësisë penale. Për më tepër, ata duhet të kenë një numër elementesh që do të mundësonin hartimin dhe zbatimin e programeve dhe masave R&R në kohë, në mënyrën e duhur, dhe të përshtatur sipas rastit jashtë atij konteksti që marrin në konsideratë edhe moshën dhe përkatësinë gjinore. Këta elementë përfshijnë:

1. Theksimin e rëndësisë së realizimit të një vlerësimi profesional dhe objektiv të rrezikut që mund të paraqesë secili individ ndaj shoqërisë si dhe nevojat dhe vulnerabilitetet e tij apo të saj;
2. Njohja e nevojës për një qasje të “shoqërisë në tërësinë e saj” ndaj sfidës që lejon një shumëllojshmëri aktorësh qeveritarë (si në nivel kombëtar edhe në atë lokal) dhe aktorësh joqeveritarë (përfshirë OSHC-të dhe sektorin privat) për të kontribuar dhe për të nxitur bashkëpunimin midis tyre;
3. Garantimi që të ndërmerren hapat e duhur për trajtimin e nevojave unike të fëmijëve dhe grave;
4. Rëndësia e monitorimit dhe vlerësimit të efektshmërisë së këtyre programeve - dhe vendosja e këtyre vlerësimeve gjerësisht në dispozicion të publikut; dhe

53 GCTF, *Addendum to The Hague-Marrakech Memorandum on Good Practices for a More Effective Response to the FTF Phenomenon*, September 2016, Rec. 6, https://toolkit.thegctf.org/Portals/1/Documents/En/16Aug01_ENGLISH_Addendum_to_The_Hague-Marrakech_Memorandum.pdf.

5. Rëndësia për garantimin që këto programe t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së duhur dhe të zbatohen në përputhje me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe të drejtës humanitare.⁵⁴

Më tej, në vend që fokusi të vendoset ngushtësisht në një formë të vetme të VERLT-it, të tillë si ajo që lidhet me ISIL-Da'esh apo e frymëzuar prej tij ose me grupe të tjera xhihadiste terroriste, **çdo kuadër i tillë duhet të trajtojë të gjitha format e VERLT-it, përfshirë ato që lidhen me motivimet e krahut të djathtë dhe etno-nacionaliste.**⁵⁵ Kjo qasje jo vetëm që ka gjasë të garantohet nga këndvështrimi i sigurisë, në veçanti po të kemi parasysh shqetësimet në rritje për dhunën ekstremiste joislamiste në një numër vendesh në rajonin e OSBE-së, por ka më pak gjasë, nga ana tjetër, të stigmatizojë ata që janë përfshirë në programe R&R, qofshin këta përfituesit objekt i programit, familjet e tyre, pjesëtarë të komunitetit, apo praktikuesit dhe profesionistët. Sa më i ulët rreziku i stigmatizimit, aq më e lartë është mundësia që programi R&R të marrë mbështetje nga ata bashkëpunimi i të cilëve është me rëndësi kritike për suksesin e tij.

Përveç garantimit të përfshirjes së konceptit të R&R jashtë kontekstit të burgut në kuadrin ligjor dhe strategjitë kombëtare përkatëse - në procesin e vlerësimit për të përfituar nga programet R&R jashtë kontekstit të burgut - **qeveritë duhet të marrin në konsideratë përgatitjen e politikave apo udhëzuesve specifikë me qëllim forcimin e efektshmërisë të këtyre përpjekjeve R&R.** Këto politika apo këta udhëzues duhet të përfshijnë dispozita, të cilat:

1. Qartësojnë objektivat e programit ose të ndërhyrjes, duke përkrahur synimet dhe procedurat që duhet të ndiqen, në interes të transparencës;
2. Përvijojnë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të shumtë të interesuar (nga shoqëria civile si dhe nga qeveria) të përfshirë në punën R&R;
3. Theksojnë nevojën për ndërhyrje dhe shërbime të larmishme me qëllim përmbushjen e nevojave të ndryshme psikologjike, praktike dhe të tjera si dhe vulnerabilitetet që cenojnë burrat, gratë dhe fëmijët që mund të përfitojnë nga këto programe;
4. Theksojnë, për programet pas burgut, rëndësinë e sigurimit të kushteve të burgut që respektojnë të drejtat e njeriut, duke njohur mënyrat e ndryshme në të cilat mjedisi i burgut me kushte humane ka gjasë të kontribuojë për fillimin e një ndërhyrjeje të suksesshme për shkëputjen, e cila mund të vijojë edhe pas lirimit,⁵⁶ dhe

54 Shih, për shembull, UNSC, Counter-Terrorism Committee (CTC), 2018 Addendum to the 2015 Madrid Guiding Principles, Guiding Principle 5 (hereinafter UNSC Madrid Addendum), https://www.un.org/sc/ctc/wp-content/uploads/2018/12/2018-Addendum-to-the-2015-Madrid-GuidingPrinciples_as_adopted.pdf; and GCCS and International Centre on Counter-Terrorism—The Hague (ICCT), *It Takes a Village: An Action Agenda on the Role of Civil Society in the Rehabilitation and Reintegration of Those Associated With and Affected by Violent Extremism*, 2018 https://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2018/08/GC_It-Takes-a-Village_WEB.pdf; and Global Security Exchange (GSX), "10 Steps to Strengthening Rehabilitation and Reintegration for Terrorism Offenders, Foreign Terrorist Fighters, and Victims of Violent Extremism", <http://www.icanpeacework.org/wp-content/uploads/2018/05/GSX-Ten-Steps-to-Strengthening-Rehabilitation-and-Reintegration-2017.pdf>.

55 Kjo është veçanërisht e rëndësishme për një rajon si ai i Evropës Juglindore, ku dhuna ekstremiste vjen në forma të ndryshme, dhe ku radikalizimi në dhunë shpesh është rrjedhojë e tensioneve historike etnike që mbeten ende të pranishme, por ku qeveritë shpesh e kanë lidhur VERLT-in ngushtësisht me prejardhjen islamiste dhe dukurinë e "LHT"-ve që kanë udhëtuar në zona konflikti në Irak dhe Siri.

56 EU RAN, P&P Practitioners' Working Paper, 2019, f. 17–18.

5. Mundëson shkëmbim informacioni midis aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë të përfshirë në këto programe, ndërkohë që mbron privatësinë dhe të drejta të tjera të njeriut për përfituesit, duke qartësuar se në ç'rrethana, çfarë lloj informacioni do të ndahet me policinë, shërbimet e inteligjencës apo të sigurisë, me qëllim që të mos dëmtohet besimi midis përfituesit dhe aktorëve R&R.

Në lidhje me këtë dispozitë të fundit, mbledhja dhe shkëmbimi i informacionit personal, në mënyrë të pashmangshme, përbën një ndërhyrje në të drejtën e privatësisë dhe, për këtë arsye, nevojitet të jetë bazuar në ligj, në mënyrë që të jetë e domosdoshme e proporcionale me rrezikun.⁵⁷ Qeveritë kanë detyrimin që të sigurojnë se ka një bazë të qartë ligjore (me politikat zbatuese dhe protokollet e nevojshme) në lidhje me informacionin që shpërndahet te të tjerët, midis kujt dhe kujt, kush ka qasje në informacion, kur kanë qasje në të, dhe çfarë masash mbrojtëse zbatohen në këtë rast. Informacion me ndjeshmëri të lartë, si për shembull, të dhëna për shëndetin apo komunikime të mbrojtura klient-përfaqësues ligjor kërkojnë mbrojtje të shtuar.

57 ICCPR, Neni 17.



5. Procesi

Ashtu si në rastin e masave P/CVERLT, edhe për sfidën R&R nuk ka një zgjidhje që mund të jetë e përshtatshme për zbatim në të gjitha rastet. Megjithatë, ekzistojnë një numër elementesh dhe çështjesh të përbashkëta që duhen marrë në konsideratë në lidhje me procesin e hartimit dhe zbatimit të këtyre programeve. Ky seksion paraqet një seri prej gjashtë hapash kyç në këtë proces.

5.1 Hartëzimi i ekosistemit

Si një hap i parë, duhet të bëhet **një hartëzim i kujdesshëm** i burimeve dhe kapaciteteve ekzistuese për të kuptuar ekosistemin e aktorëve që mund të shfrytëzohen për përpjekjet R&R. Ky hartëzim duhet të identifikojë:

1. Audiencën e synuar (p.sh. ish autorë të veprave ekstremiste të dhunshme dhe/ose “LHT” të kthyer dhe anëtarë të familjes që nuk i janë nënshtruar sistemit të drejtësisë penale) dhe objektivat për programin apo programet R&R;
2. Cilët profesionistë dhe pjesëtarë të komunitetit (p.sh. punonjës socialë, ofrues të kujdesit për shëndetin mendor, mësues, këshillues, mentorë, udhëheqës fetarë, dhe familjarë) janë më të përshtatshëm - për shembull, për shkak të ekspertizës dhe/ose një marrëdhënie mbështetur në besim me individët përkatës, familjet dhe/ose komunitetet - dhe të gatshëm për të marrë pjesë në nismat R&R;
3. Nëse ndonjë program ekzistues është fokusuar, për shembull, te P/CVERLT-i apo trajton dhunën e bandave, mund të përshtatet për qëllime të R&R;
4. Çfarë burimesh, ekspertizë, dhe trajnim shtesë nevojitet;
5. Nivelet e besimit midis profesionistëve të ligjzbatimit dhe jo të ligjzbatimit si dhe midis policisë dhe komuniteteve përkatëse, duke vënë në dukje se aty ku besimi është i ulët ai nevojitet të forcohet;⁵⁸
6. Praktika dhe protokolle ekzistuese për shkëmbimin e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave, si dhe hendeqe në rregullatore të mbrojtjes së të dhënave, që duhet të eliminohen; dhe
7. Qëndrimet e komunitetit ndaj individëve në rehabilitim dhe ri-integrim, të cilët janë dënuar për vepra terrorizmi apo kanë pasur ndonjë lidhje me terrorizmin.

58 Garantimi i besimit të domosdoshëm mund të përbëjë një sfidë të veçantë në një kontekst pas-konflikti dhe në bashkësi shumënike.

Në disa raste, mund të ekzistojnë përpjekje të shumë aktorëve apo të tjera të parandalimit parësor apo dytësor, që përfshijnë praktikuesit nga disa disiplina që, në parim, mund të shfrytëzohen për qëllime të R&R (parandalimi tretësor). Në të vërtetë, ka përfitime në shmangien e krijimit të strukturave paralele të ndërhyrjes. Megjithatë, duke pasur parasysh ndjeshmëritë politike dhe të sigurisë kombëtare që mund të ekzistojnë në disa prej rasteve të R&R jashtë kontekstit të burgut (p.sh. ish autorë të veprave që lidhen me terrorizmin dhe “LHT” dhe familjarë të kthyer), mund të duhet të garantohet një farë kujdesi para mbështetjes të njëjtë programi dhe ofrues.

Në disa vende, si Danimarkë, Francë dhe Gjermani, përdoren shumë prej të njëjtave struktura dhe profesionistë për trajtimin e një spektri të plotë ndërhyrjesh të individualizuara P/CVERLT.⁵⁹ Ndërkohë, në vende të tjera, si në Kanada dhe Mbretërinë e Bashkuar, nuk ndodh kështu. Rreziku në përdorimin e të njëjtit program për ndërhyrje dytësore dhe tretësore u theksua nga një rast i kohëve të fundit në Kanada. Atje, një qendër lokale që përfshinte shumë agjenci me fokus te individët në hapësirën jokriminale kaloi pothuajse në kolaps kur iu kërkua të trajtonte një rast me ndjeshmëri të lartë. Rasti përfshinte një të kthyer nga zona e konfliktit në Irak dhe Siri: besimi midis, nga njëra anë, policisë lokale dhe, nga ana tjetër, ofruesve të ndërhyrjes mbi bazë komuniteti dhe joligjzbatuese dhe anëtarëve të komunitetit që ishin zhvilluar për të mundësuar lançimin e qendrës u thye, ku disa prej ofruesve kërcënuan se do të largohen nga qendra përballë mundësisë se mund t’u kërkohet të merreshin me rastet më të ndjeshme, çka ata kishin frikë se mund të dëmtonte pjesën tjetër të punës së tyre dhe marrëdhëniet që kishin me anëtarët e komunitetit.⁶⁰

5.2 Realizimi i një vlerësimi nevojash dhe rreziku në mënyrë të individualizuar dhe gjithëpërfshirëse

Hapi i dytë përfshin garantimin se çdo program i tillë **të realizojë ose të mbështetet te vlerësimi gjithëpërfshirëse dhe të individualizuara të rreziqeve dhe nevojave** të përfituesve. Rëndësia e këtyre vlerësimeve është theksuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, GCTF-ja, Këshilli i Evropës dhe RAN-i. Këto vlerësime mundësojnë hartimin e përgjigjeve të përshtatura sipas rastit që “marrin parasysh historinë e jetës së pjesëmarrësit, personalitetin, [dhe] aftësitë

59 Shih, për shembull, Anne-Sophie Hemmingsen, *An Introduction to the Danish Approach to Countering and Preventing Extremism and Radicalization*, Danish Institute for International Studies, 2015, <https://www.ft.dk/samling/2015/almde/reu/bilag/248/1617692.pdf>; and EU RAN, *Prevention of Radicalisation in Germany*, Ex Post Paper, 6-7 June 2016, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/ran_study_visit_prevention_radicalisation_germany_6-7_062016_en.pdf.

60 Intervistë telefonike me një praktikues lokal kanadez, qershor 2019.

kognitive”⁶¹ trajtojnë nevojat e përfituesve, “janë në përputhje me rrezikun dhe shmagin radikalizimin (e mëtejshëm) të individëve që synohen të arrihen, anëtarëve të familjes, apo komuniteteve lokale”.⁶² GCTF-ja, duke njohur nevojën për përgatitjen e instrumenteve për vlerësim të kontekstualizuar, ka vënë në dukje se çdo instrument i tillë duhet të marrë parasysh moshën, gjininë, shëndetin mendor dhe aspekte të tjera përkatëse të pjesëmarrësit.⁶⁴

Sipas RAN-it, ne mund të arrijmë të **kuptojmë “nevojat, mesazhet, e rrjetet e individit duke përdorur metoda specifike për vlerësimin e rrezikut për ekstremizmin e dhunshëm.”**⁶⁴ Më konkretisht, çështje për t’u eksploruar për individin përfshijnë të kuptuarit e (1) angazhimit dhe motiveve për dhunë; (2) nivelit të aderimit në një ideologji që mbështet dhunën; (3) kapacitetit për të kryer dhunë; (4) konteksti social dhe synimi; dhe (5) nevojave psikologjike dhe praktike. Në rastin e atyre që janë kthyer nga zonat e konfliktit në Irak dhe Siri, duhen kuptuar motivet që i shtynë të largohen nga zonat e konfliktit.

Nevojat dhe sfidat që duhen trajtuar do të ndryshojnë në varësi të individit, po ka gjasë të përfshijnë stres dhe traumë post-traumatike, ankth, humbje e kuptimit të jetës, zhgënjim, agresion, ndjenja të mundshme faji apo turpi, mungesë e mundësive për punë, stigma nga komuniteti dhe/ose shoqëria, vështirësi për zgjidhjen e konfliktit paqësisht, dhe mësim kontekstual për fenë dhe/ose politikën. Ka mjaft instrumente ekzistuese që janë hartuar për të vlerësuar autorët e veprave që lidhen me terrorizmin edhe ekstremiste në një mjedis burgu, si dhe për të dhunur rreziqet dhe nevojat e individëve tashmë të radikalizuar me prirje të dhunës.⁶⁵ Megjithatë, pak instrumente fokusohen në mënyrë specifike të ekstremizmi i dhunshëm, madje edhe më pak të tilla janë

61 EU RAN, *Foreign Fighter Returnees and the Reintegration Challenge*, Ran Issue Paper, p. 9, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_foreign_fighter_returnees_reintegration_challenge_112016_en.pdf.

62 GCTF, *Good Practices on Addressing the Challenge of Returning Families of Foreign Terrorist Fighters (FTFs)*, Good Practice 5, September 2018, https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/C/GCTF-Good-Practices-on-Returning-Families-of-FTFs_ENG.pdf?ver=2018-09-25-101427-323..

63 Po aty.

64 EU RAN, *Foreign Fighter Returnees and Reintegration Challenge*, f. 9.

65 Për një analizë më të hollësishe të instrumenteve përkatëse për vlerësimin e rrezikut, shih RTI, *Countering Violent Extremism: The Application of Risk Assessment Tools in the Criminal Justice and Rehabilitation Process*, literature review prepared for the First Responders Group at the U.S. Department of Homeland Security, Science and Technology Directorate, February 2018, https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/OPSR_TP_CVE-Application-Risk-Assessment-Tools-Criminal-Rehab-Process_2018Feb-508.pdf. Këto instrumente dhe të ngjashme me to për vlerësimin e rrezikut kanë pasur një testim të kufizuar dhe janë kritikuar nga disa se përipiqen të parashikojnë të paparashikueshmen. Shih, për shembull, Rita Augestad Knudsen, “Measuring Radicalization: Risk Assessment Conceptualisations and Practice in England and Wales”, *Behavioral Sciences of Terrorism and Political Aggression* (August 2018), <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/19434472.2018.1509105>. Për një krahasim të instrumenteve përkatëse të vlerësimit shih, për shembull, Liesbeth van der Heide, Marieke van der Zwan, and Maarten van Leyenhorst, *The Practitioner’s Guide to the Galaxy - A Comparison of Risk Assessment Tools for Violent Extremism*, ICCT, September 2019, https://icct.nl/wp-content/uploads/2019/09/29Aug19_Formatted_ThePractitionersGuidetotheGalaxy-1.pdf. (The objective of this paper “is to enable policymakers and practitioners to better navigate the often muddy, copyrighted, and expensive waters of the world of risk assessment of violent extremism—as well as to facilitate their decision-making process when it comes to determining what approach is best suited to their needs”.); and Monica Lloyd, *Extremism Risk Assessment: A Directory*, CREST (Centre for Research and Evidence on Security Threats), March 2019, <https://crestresearch.ac.uk/resources/extremism-risk-assessment-directory/>.

testuar dhe verifikuar⁶⁶. Për shembull, VERA-2 u përpilua për t'u përdorur në tipologji të ndryshme të ekstremistëve të dhunshëm, terroristëve, dhe autorëve të veprave të dhunshme të paligjshme të motivuara nga ideologji fetare, politike apo sociale; ky instrument po përdoret në disa vende, me individë të dënuar për dhunë ekstremiste përgjithësisht në kontekst pas ekzekutimit të dënimit në burgje të sigurisë së lartë. Modeli i njohur si të Kthyerit 45 i Qendrës së Ekselencës të RAN-it u përgatit në mënyrë specifike për vlerësimin e luftëtarëve të huaj terroristë si një kuadër për të orientuar hetimet e përgjithshme për motivimin, angazhimin, dhe faktorë të tjerë të rrezikut që ekzistojnë në një individ. Mbretëria e Bashkuar përgatiti ERG+22 (Udhëzues për Rrezikun e Ekstremizmit) për t'u përdorur në Programin e saj për Parandalimin dhe Kanalizimin dhe IR46 është një instrument holandez që përdoret për vlerësimin nga shumë agjenci në "shtëpitë e sigurisë". TRAP 18 (Protokolli për Vlerësimin e Radikalizimit Terrorist) është përpiluar për të gjurmuar prognozën afatgjatë të aktorëve individualë; dhe HCR 20 është një model që përdoret gjerësisht për të vlerësuar rrezikun e dhunës pa një fokus specifik të dhuna ekstremiste.

Ndonëse ata që hartojnë programe R&R jashtë kontekstit të burgut për P/CVERLT dëshirojnë të mbështeten dhe të përfitojnë nga instrumentet përkatëse ekzistuese, të cilët në mënyrë tipike kanë disa tregues të përbashkët me të cilët vlerësojnë nivelin e ekstremizmit të një individ, ku qasja bazë varion nga "gjykim profesional i strukturuar" në "pyetorë të vetadministruar" për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave, të informuar **dhe të përshtatur sipas kontekstit lokal, e për pasojë më të pranuar nga komunitetet përkatëse**⁶⁷.

Për këtë qëllim, dhe duke ditur se instrumente për vlerësimin e rrezikut që projektohen dhe zbatohen pa kujdes mund të veçojnë në mënyrë të gabuar individë, të stigmatizojnë dhe të largojë përfituesit dhe komunitetet/grupet në shoqëri, duke dëmtuar në këtë mënyrë përpjekjet R&R jashtë kontekstit të burgut, **hapat që duhen marrë në konsideratë gjatë përgatitjes (dhe zbatimit) të çdo instrumenti vlerësimit përfshijnë**⁶⁸:

1. Përshtatja e instrumentit të vlerësimit ndaj kategorive të ndryshme të përfituesve të mundshëm, ku përdoren korniza të diferencuara, sipas rastit, për gratë dhe fëmijët;
2. Sigurimi i një fokusi të balancuar të rreziqet që duhet të zbuten, faktorët e rezistencës që duhen forcuar, dhe nevojat që duhen përmbushur⁶⁹;
3. Theksimi i faktorëve që janë të lidhur me popullatën e synuar, të tillë si kompleksiteti dhe përmasa e popullatës dhe niveli i burimeve dhe kapaciteteve të një vendi, bashkie apo komuniteti të caktuar;

66 Vlerësimi i rrezikut i lidhur me ekstremizmin e dhunshëm është një fushë relativisht e re që kërkon që të bëhet vlerësim dhe të mësohet më shumë rreth tij; Shih, për shembull, Global Center on Cooperative Security, *Recommendations for the Consideration of the Counter-Terrorism Committee in the Adoption of the 2018 Addendum to the Madrid Guiding Principles*, November 2018, p. 3, https://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2018/11/18Nov28_Recommendations-Addendum-Madrid-Principles.pdf.

67 Për një diskutim të instrumenteve të vlerësimit të rrezikut dhe P/CVERLT, shih, për shembull *Understanding Referral Mechanisms*, të OSBE-së, f. 80–83.

68 Për ilustrime të disa "praktikave të mira dhe premtuese për vlerësimin e efektshëm dhe të duhur të AVE-ve dhe radikalizimit në ekstremizëm të dhunshëm," shih, për shembull, Christopher Dean, Sebastien Feve, and Eelco Kessels, *Countering Violent Extremism in Prisons: Good Practices Guide*, Global Center on Cooperative Security, August 2018, f. 11–13, <https://www.veocompendium.org/download.html>.

69 Shih, për shembull, Marsden, *Reintegrating Extremists*, f. 16–17.

4. Reflektimi i konteksteve më të gjera politike, kulturore dhe sociale;
5. Konsultimi me praktikuesit lokalë si për përgatitjen e ndonjë instrumenti edhe për zbatimin e tij në raste individuale me qëllim që të sigurohet që vlerësimi të mbështetet nga burime të shumëfishta informacioni;
6. Shmangia e përdorimit të etiketave të tilla si “ekstremist i dhunshëm”, “terrorist”, apo “luftëtar i huaj i kthyer” dhe të sigurohet që ata që bëjnë vlerësime të trajnohen që të kenë parasysh dallimet dhe të shmangin përgjithësimet e tepruara;
7. Sigurimi që instrumenti apo kuadri i vlerësimit të jetë i zbatueshëm gjerësisht dhe jo specifik për një ideologji ose fe të veçuar;
8. Shmangia e anësive ndaj përkatësisë gjinore, përgjithësimeve dhe stereotipeve;
9. Përfshirja e ofruesve të trajnuar të kujdesit psikologjik dhe/ose profesionistëve të tjerë të duhru, përfshirë policinë apo shërbimet e sigurisë, kur është e nevojshme; dhe
10. Garantimi se vlerësimi është bërë në mënyrë të informuar dhe i lidhur me ndërhyrjet dhe shërbimet mbështetëse të disponueshme me qëllim që të sigurohet që këshillimi, ndihma praktike, dhe burime të tjera të jenë të disponueshme për trajtimin e rreziqeve, dobësive, dhe nevojave të identifikuar.

Nevoja për vlerësime të përshtatura sipas rastit në hapësirën R&R jashtë kontekstit të burgut nënvizohet më tej nga larmishmëria e rasteve që paraqiten në vetëm një kategori: të kthyerit nga zonat e konfliktit në Irak dhe Siri. Të kthyerit burra, gra dhe fëmijë vijnë nga kontekste të ndryshme, motivime të ndryshme dhe përvoja të ndryshme. Për shembull, familjarët e “LHT”-ve “mund të jenë viktima, autorë krimesh, dëshmitarë, apo një ndërthurje e tyre.”⁷⁰ Shumë vëmendje po përqendrohet së fundmi te çështja e përfshirjes saktësisht në veprimtari terroriste nga ana e grave që kanë udhëtuar në zona konflikti dhe janë martuar atje; roli i fëmijëve ka marrë gjithashtu një vëmendje të spikatur. Pra, individët në këtë kategori të gjerë paraqesin një kompleksitet nevojash dhe rreziqesh potenciale që mund të kërkojnë përgjigje si humanitare edhe për sigurinë⁷¹. (Shih Seksionin 11 për në diskutim më të plotë mbi nevojat unike të grave dhe fëmijëve.)

70 GCTF, *Returning Families Good Practices*; dhe OSCE/ODIHR *FTF Guidelines*, Seksionet 3.7 dhe 3.8.

71 European Parliament Parliamentary Research Service, *The Return of Foreign Fighters to EU Soil: Ex-Post Evaluation*, 2018, f. 5, [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2018/621811/EPRS_STU\(2018\)621811_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2018/621811/EPRS_STU(2018)621811_EN.pdf).

5.3 Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të shumtë

Një element me rëndësi kritike për krijimin e vlerësimeve gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura sipas rastit - dhe për të siguruar që përpjekjet R&R jashtë kontekstit të burgut të jenë të efektshme - është **shkëmbimi i informacionit midis aktorëve të shumtë** që mund të kenë informacion përkatës për një rast individual. Ky informacion duhet të shqyrtohet si pjesë e në vlerësimi dhe të përfshihet gjatë përgatitjes së një ndërhyrjeje apo plani për mbështetje.

Megjithatë, shkëmbimi i informacionit përballet me disa pengesa. Korniza dhe qëllime të ndryshme profesionale dhe etike, përfshirë për ofruesit e kujdesit psikosocial dhe kështilltarët fetarë dhe për çështje të tjera, mund ta bëjnë që shkëmbimi i informacionit të jetë i vështirë. Gjithashtu, e drejta për privatësinë është e parashikuar në legjislacionin për të drejtat e njeriut dhe parimet për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave duhet të respektohet.⁷² Më tej, policia dhe shërbimet e sigurisë dhe të inteligjencës mund të jenë ngurrues apo në pamundësi për të ndarë informacion me aktorë të tjerë, të cilët, tradicionalisht, nuk kanë qasje në informacion sensitiv, e aq më pak në informacion të klasifikuar.

Ekzistenca e marrëdhënieve mbi bazë besimi dhe marrëdhënieve personale apo rrjetet informale mundet që, në disa raste, të kapërcejnë këtë barrierë apo të mundësojnë shkëmbimin e informacionit mbi baza ad hoc. Megjithatë, për shkak të ndryshimeve në personel përgjatë kohëzgjatjes së një programi, dhe nevojës për të mbrojtur informacionin personal dhe respektimin e ligjit për privatësinë, **duhet të hartohen dhe miratohen udhëzues apo korniza të tjera transparente (përfshirë, kur është e mundur, ato legjislative), si dhe mbikëqyrje dhe kontroll të pavarur.** Këto mund të ndihmojnë në shkëmbimin e informacionit, njohurisë dhe ekspertizës dhe të mbrojnë si duhet informacionin për të lejuar aktorë të shumtë nga agjenci të ndryshme, organizata

72 E drejta për privatësi kërkon që të dhënat personale të mbliken dhe të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, të ruhen vetëm për qëllimet e specifikuar dhe legjitime, të mos përdoren në një mënyrë që nuk është në respekt të atyre qëllimeve, dhe të mbrojtura për të mos u bërë publike ndaj personave të paautorizuar. Të dhëna shumë të ndjeshme (të tilla si të dhëna për shëndetin dhe informacion për bindje fetare dhe politike) kërkojnë mbrojtje të veçantë. Shih OSBE, *OSCE Guidebook on Intelligence Led Policing*, TNTD/SPMU Publication Series, vol. 13, July 2017, <https://www.osce.org/chairmanship/327476>.

dhe profesione të vlerësojnë një rast individual së bashku me sistematikisht⁷³. Kuadri, i cili mundet të përcaktohet në ligj, por kjo nuk është e domosdoshme, duhet ta bëjë të qartë, si për profesionistët edhe për përfituesit e programit se “çfarë lloj informacioni shkëmbehet, kur, me cilët, për cilën arsye, dhe në cilat raste duhet të përfshihen agjencitë e sigurisë.”⁷⁴ Një ndër përfundimet e seminarit të Berlinit të marsit 2019 për parandalimin tretësor të organizuar nga Këshilli Gjerman për Marrëdhëniet me Jashtë ishte se “transparenca në lidhje me detyrimet dhe kufijtë e shkëmbimit të informacionit është një bazë e nevojshme për të ndërtuar besimin midis të gjithë aktorëve të përfshirë,” në veçanti “kur klienti është i shqetësuar për mbrojtjen e informacionit personal që ai apo ajo i ka bërë të njohur një këshilltari. Duke e informuar klientin në mënyrë proaktive në lidhje me detyrimet dhe kufijtë e përmendur, shqetësimet dhe keqkonceptimet rreth shkëmbimit të të dhënave mund të trajtohen dhe të sheshohen⁷⁵.”

Shkëmbimi i informacionit midis aktorëve të shumtë që mund të përfshihet në ndërhyrje të personalizuara P/CVERLT paraqet një sërë sfidash, tri prej të cilave janë të lidhura në mënyrë të veçantë me kontekstin e R&R jashtë kontekstit të burgut:

1. Nevoja për të përfshirë kategori shtesë profesionistësh (p.sh., shërbimi i provës dhe/ose shërbimet e inteligjencës); RAN i BE-së i nxit shtetet të marrin në konsideratë ngritjen e strukturave për të mundësuar shkëmbim informacioni me këta aktorë shtesë si dhe ndërmjet këtyre aktorëve⁷⁶;
2. Ngurrimi i zyrtarëve të zbatimit të ligjit për të shkëmbyer informacion dhe përgjegjësinë për rastet me rrjedhoja të mundshme për sigurinë kombëtare me profesionistë jashtë sferës së zbatimit të ligjit; dhe
3. Rezervimi i shtuar i profesionistëve joligjzbatues për t'u përfshirë në këto raste duke pasur parasysh rreziqet e shtuara për sigurinë dhe të tjera.

73 Në Danimarkë, për shembull, policia, shkollat dhe agjencia e shërbimeve sociale - tre shtyllat e përpjekjeve P/CVERLT të udhëhequra në nivel lokal - lejohen të “shkëmbejnë informacion rreth një individi nëse është e nevojshme për bashkëpunim në parandalimin e krimit apo për bashkëpunim midis policisë, shërbimeve sociale dhe psikiatrisë sociale dhe autoriteteve të shëndetit mendor në përpjekjet e tyre për të ndihmuar individitët që janë vulnerabël nga këndëvshtrimi social. Megjithatë, informacioni nuk mund të ndahet me të tjerët për qëllime të hetimeve penale.” Shih Hemmingsen, *Danish Approach to Countering and Preventing Extremism*, f. 15. Në Belgjikë, kuadri ligjor mundëson shkëmbim horizontal dhe vertikal të informacionit të ndjeshëm rreth individëve. Megjithatë, një Raportues Special i OKB-së për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore gjatë kundërvënies ndaj terrorizmit ka vënë në pyetje “kuadrin ligjor për mbledhjen e të dhënave, qasjen e individëve përfshirë fëmijët dhe kujdestarët e tyre ligjorë në informacionin që mbahet për ta, aftësinë për të sfiduar saktësinë e këtyre të dhënave, bazën ligjore mbi të cilën shkëmbehen këto të dhëna brenda përbrenda agjencive dhe midis agjencive në të gjitha nivelet e qeverisë (p.sh. njësitë lokale të integruara të sigurisë, task forca lokale dhe Task Forca Kombëtare), dhe përfshirjen e këtyre të dhënave në bazat e të dhënave që mbahen nga shërbimet e inteligjencës pa u zbatuar masa të mjaftueshme për rreptësinë e kujdesit, mbrojtjen, konsistencën dhe mbikëqyrjen.” Shih, Zira e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, “Human Rights and Counter-Terrorism: UN Special Rapporteur on the Promotion and Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms While Countering Terrorism Concludes Visit to Belgium”, 31 May 2018, <https://www.ohchr.org/en/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=23164&LangID=E>.

74 Sofia Koller, *International Tour d'Horizon of Tertiary Prevention of Islamist Extremism, InFoEx Workshop, Berlin, March 26–27, 2019, German Council on Foreign Relations*, p. 6, <https://dgap.org/en/think-tank/publications/dgapreport/international-tour-dhorizon-tertiary-prevention-islamist>.

75 Po aty.

76 EU RAN, *Responses to Returnees: Foreign Terrorist Fighters and Their Families*, RAN Manual (hereinafter RAN Returnee Manual), July 2017, p. 4, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/ran_br_a4_m10_en.pdf.

5.4 Përgatitja e një plani mbështetur në vlerësimin e rastit

Hapi tjetër në proces përfshin **përgatitjen e një plani, mbështetur në vlerësimin e rastit** - idealisht, plani që përgatitet nga të gjithë aktorët përkatës në bashkëpunim të ngushtë me personin përfitues synon të arrijë pronësinë/mbikqyrje mbi procesin. Aty ku është e mundur, ato me marrëdhënie mbështetur në besim me individin (p.sh. mësues, mentorë, pjesëtarë të familjes, këshilltarë, dhe anëtarë të tjerë të komunitetit) duhet të përfshihen.

Siç u theksua më lart, përfituesit potencialë të programeve R&R jashtë kontekstit të burgut me gjasë paraqesin shumëllojshmëri dobësish, rreziqesh dhe nevojash - ideologjike, psikologjike, të formimit profesional, financiare, fetare, arsimore, dhe familjare. Disa mund të kenë pasur një përfshirje apo ekspozim të kufizuar ndaj terrorizmit apo VERLT-it; të tjerë mund të mbeten të radikalizuar dhe kanë bërë trajnim ushtarak dhe paraqesin një rrezik mjaftueshëm të lartë për sigurinë publike sa për të garantuar mbikëqyrje të vazhdueshëm ligjzbatuese apo forma të tjera monitorimi. Disa mund të kenë familje dhe komunitete që janë të interesuara për të luajtur një rol konstruktiv në procesin e rifutjes në to; të tjerë mund të jenë mohuar apo të jenë përjashtuar nga komunitetet e tyre; të tjerë akoma mund të kenë familje që mund të nxisin ekstremizmin e dhunshëm apo për arsye të tjera nuk luajnë rol konstruktiv në procesin R&R. Disa mund të kërkojnë këshillim të specializuar apo ndërhyrje të tjera P/CVERLT; disa të tjerë mund të kenë nevojë vetëm për mbështetje psikologjike apo ndonjë formë tjetër mbështetjeje e disponueshme edhe për popullatën e gjerë⁷⁷.

Nisur nga kjo shumëllojshmëri, masat R&R në kontekst jashtë burgu mund të përfshijnë një ose më shumë prej llojeve të ndryshme të ndërhyrjeve, përfshirë “mbështetje për shëndetin mendor, ndërtimin e aftësive, arsimit bazë, kujdesi shëndetësor, asistencë për punësim, asistencë ligjore, mbështetje ekonomike, mbështetje sociale, dialog dhe kontakte me komunitetin lokal⁷⁸.” (Shih Seksioni 6 për një diskutim më të plotë të llojeve të ndërhyrjeve.) Mbështetja e dhënë, gjithsesi, duhet të jetë proporcionale me nevojat dhe dobësitë e individit. **“Ndërhyrja e tepruar” (d.m.th. dhënia me tepri e shumë llojeve të ndryshme mbështetjesh) duhet të shmanget, sepse kjo paraqet sfidat e veta**, si stigmatizimi i individit, ndërlikimi i detyrës për të ndërtuar besimin midis praktikuesve qeveritarë dhe individit dhe familjes së tij apo saj, mbyllja e hapësirës kognitive që është e nevojshme për rehabilitimin dhe shkëputjen, dhe krijimi i panevojshëm i një ndjesie alarmi në komunitetin përkatës, bashkëpunimi dhe mbështetja e të cilit mund të jetë me rëndësi kritike për një rifutje të suksesshme në të. Ata që mbikëqyrin programet R&R duhet të vlerësojnë rregullisht faktin nëse ndërhyrjet janë proporcionale apo nëse programi mund të shkaktojë më shumë dëm se përfitim, dhe më pas të rregullojnë nivelin e ndërhyrjes sipas rastit.

77 <https://thedefensepost.com/2019/02/12/us-minnesota-deradicalization-program-inside-look/>

78 GCTF, *Returning Families Good Practices*, Good Practice 6.

5.5 Identifikimi i një aktori udhëheqës

Në rastet kur në një rast të veçantë përfshihen shumë aktorë, është e rëndësishme që **të identifikohet një aktor udhëheqës** - ose një “zotërues i rastit” - për të bashkërenduar aktorët dhe veprimtaritë e ndryshme të përfshira në rastin individual dhe për të shërbyer si një pikë e dedikuar kontakti me individin në fjalë, familjen dhe komunitetin e gjerë. Ndonëse policia dhe aktorë të tjerë të sigurisë me gjasë do të përfshihen në rastet e parandalimit tretësor (karahasuar me atë parësor dhe dytësor), në veçanti në rastet që përfshijnë kthimin e “LHT”-ve dhe anëtarëve të familjes nga zonat e konfliktit, ata mund të mos jenë më të përshtatshmit për të marrë këtë rol udhëheqës. Marrja e rolit udhëheqës nga policia mund të rrezikojë përpjekjet për ndërtimin e besimit me anëtarët e komunitetit, bashkëpunimi dhe angazhimi i qëndrueshëm i tyre do të jetë me rëndësi kritike për të siguruar suksesin e përpjekjes R&R dhe që mund të jenë ngurrues për t’u angazhuar me policinë, të cilën e lidhin me një mision sigurie dhe që, nga ana e vet, mund të mos kenë trajnim dhe instrumente për angazhim në komunitet.

Ndoshta më e rëndësishmja, dhe shpesh ka qenë kështu, individi që synohet të arrihet mund të ketë pasur përvoja negative me policinë apo shtetin në kuptimin më të gjerë dhe do të ketë, për rrjedhojë, besim të kufizuar në institucionet ligjzbatuese dhe institucione të tjera të shtetit. Në këto situata, nëse përpjekja R&R nuk trajtohet me ndjeshmëri - për shembull, duke identifikuar një punonjës social apo OJF për të nisur dhe udhëhequr angazhimin, që, në varësi të llojit të rastit, mund të fillojë me një trokitje në derë - riparimi i domosdoshëm i besimit mund të mbetet i paarritshëm.⁷⁹ Në varësi të nivelit të rrezikut dhe masës në të cilën OO-të apo punonjësit socialë ndihen komod për të qenë proaktivë (krahasuar me preferencën e zakonshme të këtyre të fundit për t’iu përgjigjur një kërkesë për mbështetje), ky angazhim mund të iniciohet së bashku me policinë, siç është praktikuar në disa bashki⁸⁰.

79 Megjithatë, një çështje kyçe këtu përqendrohet rreth aksesit: OSHC-të, në mënyrë që të ndërhyjnë, kanë nevojë për një “rrugë për të hyrë”, sepse, ndryshe nga policia, mandati i tyre për të punuar me një individ apo familjen e tyre është më së shumti në baza vullnetare. Kontakti me prindërit, për shembull, mund të jetë një pikë e mirë e parë për akses.

80 Kjo praktikë është ndjekur në disa qytete në vende të tilla si Kanadaja, Danimarka, dhe Suedia.

5.6 Komunikimi i qëllimeve dhe përfitimeve të programit

Një hap tjetër kyç në proces përfshin **komunikimin efektiv të qëllimeve dhe përfitimeve të masave R&R** nga njëra anë, për publikun që mund t'i shohë ato si tepër “të buta” për trajtimin e terrorizmit dhe, nga ana tjetër, për individët që synohen të arrihen dhe komunitetet që mund t'i shohin se potencialisht mund të stigmatizojnë.⁸¹ Më tej, në varësi të llojit të ndërhyrjes dhe mbështetjeve të tjera të ofruara për R&R në kontekst jashtë burgut - dhe masën në të cilën këto shërbime të njëjta janë të disponueshme për popullatën e gjerë - programet R&R mund të gjenerojnë ndjenja zemërate drejt objektivave të këtyre programeve bazuar në perceptimin (dhe ndoshta realitetin) se ata që kanë pasur një farë lidhjeje me terrorizmin apo ekstremizmin e dhunshëm po marrin trajtim më të mirë se ata që nuk e kanë bërë këtë gjë.

Hartimi dhe zbatimi i një strategjie për zbutjen e këtyre shqetësimeve është me rëndësi kritike. Në këtë strategji, të gjithë aktorët që përfshihen në këtë program duhet të “komunikojnë në mënyrë proaktive metodat dhe qëllimet e tyre, të japin komente mbi efektshmërinë dhe pranimin e programeve të tyre në grupin e synuar, dhe të ndajnë me të tjerët shembuj të suksesshëm të përpjekjeve të tyre, si dhe të përvijojnë limitet e punës së tyre” ndërkohë që shkëmbejnë hollësi të instrumenteve që përdorin “për të arritur pjesë të sferës së publikut që kanë rezerva të forta apo një qasje mospranuese ndaj kësaj pune”.⁸²

Publiku që është skeptik duhet të bindet që investimi në masa R&R është një element i rëndësishëm i një strategjie gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe kundërvënien ndaj terrorizmit. Më tepër se ndihmë për “terroristët”, kjo ndërhyrje paraqet “një mënyrë të zgjuar për reduktimin e rrezikut të recidivizmit, dhe për punën me ish autorët e veprave që lidhen me terrorizmin me qëllim parandalimin e dhunës nga të tjerë në të ardhmen”⁸³ dhe për shmangien e radikalizimit në dhunë të të tjerëve në komunitetin në fjalë. Nisur nga numri në rritje e veprave që lidhen me terrorizmin për të cilat ka dënime relativisht të shkurtra (pjesërisht për shkak të faktit se shumë janë për krime jo të dhunshme, si dhënia e mbështetjeve materiale) dhe mosha relativisht e re e pjesës më të madhe të autorëve të veprave që lidhen me terrorizmin të liruar, mosinvestimi në ndërhyrje për të lehtësuar shkëputjen e këtij personi nga dhuna dhe rifutja paqësore në shoqëri do të ishte, në rastin më të mirë, dritëshkurtër.

81 Tina Wilchen Christensen and Tore Bjørgo, *How to Manage Returned Foreign Fighters and Other Syria Travelers*, Research Report, No. 1, Center for Research on Extremism (C-REX), University of Oslo, 2018, <https://www.sv.uio.no/c-rex/english/publications/c-rex-reports/how-to-manage-foreign-fighters-c-rex-research-report.pdf>.

82 Koller, *Tertiary Prevention of Islamist Extremism*, f. 8.

83 Jesse Morton and Mitch Silber, *When Terrorists Come Home: The Need for Rehabilitating and Reintegrating America's Convicted Jihadists*, Counter Extremism Project, 2018, f. 34, https://www.counterextremism.com/sites/default/files/CEP%20Report_When%20Terrorists%20Come%20Home_120618.pdf.

Krijimi i një plani për të reduktuar stigmën që rrethon në mënyrë tipike një (ish) ekstremist të liruar dhe atyre që u kërkohet të mbështesin rifutjen e tij apo të saj është po aq i rëndësishëm. Për shembull, ka shumë rëndësi se si prezantohet programi (p.sh. si një nismë kundër terrorizmit, një masë e drejtësisë penale, apo një program i shoqërisë civile apo për ndërtimin e rezistencës) ndaj individit apo komunitetit më gjerë, ku “terminologji të ndryshme kanë implikime të ndryshme për mënyrën se si individit perceptohet nga komuniteti” dhe, rrjedhimisht, edhe për mënyrën se sa i gatshëm është komuniteti ta mbështesë individin⁸⁴.

Anëtarët e komunitetit mund të ngurrojnë të punojnë me autoritetet qeveritare për R&R të “LHT”-ve dhe familjet e tyre që nuk ndiqen penalisht pas kthimit, me frikën se angazhimin me qeverinë mund të rrisë gjasat e veprimit ligjor kundër një antëari të kthyer të familjes mund të rrisë rrezikun e stigmatizimit.

Stigma mund të nevojitet të trajtohet edhe në vendin e punës, në mënyrë që të parandalohet diskriminimi që mund të ketë një ndikim për marrjen në punë dhe sigurinë në punë. Kjo, nga ana e vet, mund të përbëjë pengesë për rehabilitimin.⁸⁵ Sikurse ka rekomanduar edhe GCTF-ja, strategjia e komunikimit duhet të përfshijë “programe për të rritur kapacitetin dhe njohurinë e familjeve që presin anëtarë të familjes që kthehen, të cilët mund të ndihmojnë në zbutjen e këtyre shqetësimeve dhe për rehabilitimin, socializimin dhe trajtimin e traumës⁸⁶.”

Së fundi, praktikuesit e përfshirë në realizimin e ndërhyrjeve R&R në komunitet mund të ndihen të stigmatizuar apo të ndjejnë trysni nga kolegë apo anëtarë të komunitetit sepse mbahen përgjegjës për veprimet e klientit. Për ta zbutur këtë rrezik ndihmon arritja e një marrëveshjeje të qartë për rolet dhe përgjegjësitë e atyre që janë të përfshirë në këto ndërhyrje dhe krijimi i hapësirës për vetë-reflektim dhe profesionalizim nga ana e praktikuesit⁸⁷.

Përtej stigmës, ka edhe barriera praktike dhe të lidhura me sigurinë që mund të duhet të kapërcehen. Në lidhje me të parën, siç e ka theksuar edhe Sarah Marsden “madje edhe kur një individ është i motivuar të shkëputet, përballat me sfida domethënëse: gjetja e një pune, zhvillimi i një rrjeti të ri social, madje edhe hapja e një llogarie bankare mund të jetë problematike. Njohja e rolit të shoqërisë në mbështetjen e riintegrit merr një rol qendror për të mbështetur një shkëputje dhe largim të suksesshëm dhe afatgjatë⁸⁸.”

84 Veldhuis, *Reintegrating Violent Extremist Offenders*, p. 9.

85 *Invisible Women: Gendered Dimensions of Return, Rehabilitation and Reintegration from Violent Extremism* (hereinafter *Invisible Women*), International Civil Society Action Network (ICAN) and UNDP, January 2019, <http://www.icanpeacework.org/wp-content/uploads/2019/02/ICAN-UNDP-Rehabilitation-Reintegration-Invisible-Women-Report-2019.pdf>.

86 GCTF, *Returning Families Good Practices*, Good Practice 19.

87 Violence Prevention Network and the RecoRa Institute, *The Art of Seeing Promise over Risk: Perspectives from the European Practice Exchange (EPEX)*, 2019, <https://www.issuelab.org/resources/35086/35086.pdf>.

88 Marsden, *Reintegrating Extremists*.

Në lidhje me këtë të fundit, frika e ndëshkimit apo përjashtimit nga komuniteti mund të jenë pengesa domethënëse për riintegrimin social. Sipas rastit, mund të jetë e nevojshme që të merren masa për të mbrojtur sigurinë e përfituesve të programeve R&R si dhe të familjarëve. Kjo mund të përfshijë zhvendosjen e përkohshme apo masa për mbrojtjen e dëshmitarit. Ndër të tjera, anonimiteti që shoqëron zhvendosjen mund t'i ndihmojë të burgosurit që të shmangin ballafaqimin e vazhdueshëm me të shkuarën e tyre, përfshirë lidhjet e tyre me grupe ekstremiste, dhe t'i ndihmojë ata për të zhvilluar një identitet të qëndrueshëm. Gjithashtu, përfituesit duhet të mbrohen nga çdo vëmendje e panevojshme dhe e papërshtatshme e medias, në mënyrë që të sigurohet që procesi aktual R&R për ta të mos vihet në rrezik.⁸⁹ Megjithatë, nëse realizohet në përputhje me parimin “mos-shkaktimit të dëmit”, vëmendja e medias te kjo çështje mund të nxjerrë në pah sfidat unike me të cilat përballen “LHT”-të që kthehen dhe familjarët e tyre (si dhe ata që mund të kenë ndonjë lidhje me ekstremizmin e dhunshëm), duke nxitur në këtë mënyrë empatinë dhe reduktimin e stigmës në komunitete.

5.7 Monitorimi dhe vlerësimi

Një hap kritik përfshin edhe **sigurimin e monitorimit dhe vlerësimin të duhur të ndërhyrjes R&R jashtë kontekstit të burgut**, ndërkohë që identifikohen dhe pranohen sfidat për matjen e ndikimit të këtyre programeve. Ashtu si ndodh edhe në pjesën më të madhe të aspektit P/CVERLT, ka njohuri të kufizuara të bazuar në evidencë në lidhje me faktin se çfarë funksionon dhe çfarë jo në lidhje me R&R. Mungesa e një themeli të qëndrueshëm evidencash, këto programe shpesh “zbatohen mbi bazën e parimit mëso nga prova dhe gabimet⁹⁰”; “nevojitet ende më shumë evidencë... për të kuptuar se çfarë mbështet rezultate pozitive dhe çfarë përcakton se si mund të vlerësohet progresi⁹¹.”Arsyet për mungesën e evidencës përfshijnë numrin e kufizuara të vlerësimeve për përpjekjet R&R që mund të qasen publikisht; kompleksiteti i çështjeve në fjalë, përfshirë mungesën e qartësisë në lidhje me çfarë e mbështet shkëputjen nga dhuna apo ndryshime të tjera pozitive; mungesa e të kuptuarit se çfarë ndodh aktualisht në ndërhyrjet R&R; dhe vështirësitë për të matur suksesin, që disa herë janë rrjedhojë e mungesës së qartësisë së ndërhyrjes⁹².

Për të ndërtuar këtë bazë evidence, ndërkohë që lehtëson rishikimin periodik të zbatimit dhe eficiencës së një programi, mekanizmat e vlerësimin duhet të

89 GCCS, *Compendium of Good Practices*, p. 50.

90 Veldhuis, *Reintegrating Violent Extremist Offenders*, f.9.

91 CREST, *Deradicalisation Programmes: An Introductory Guide* 29 Jan. 2019, <https://crestresearch.ac.uk/resources/deradicalisation-programmes-introductory-guide/>.

92 Shih, për shembull, Liesbeth van der Heide and Bart Schuurman, “Reintegrating Terrorists in The Netherlands: Evaluating the Dutch Approach,” *Journal for Deradicalization*, no. 17, (2018/19), <http://journals.sfu.ca/jd/index.php/jd/article/view/179/134>; and Wilchen Christensen and Bjørge, *How to Manage Returned Foreign Fighters*.

të përfshihen në hartimin e ndërhyrjes, dhe vlerësimet përkatëse duhet të bëhen të disponueshme publikisht, kur është e mundur.

Si fillim, ata që janë përgjegjës për hartimin e programeve R&R jashtë kontekstit të burgut duhet të sigurojnë që projektimi i secilës ndërhyrje (apo i një programit në tërësi) të nxitet nga teoria e ndryshimit që shpjegon se si qasja e propozuar lidhet me synimet dhe rezultatet e ndërhyrjes. Teoritë e ndryshimit, të cilat mund të formësojnë synimet e programmit (p.sh. në lidhje me sjelljen, motivimin, dhe/ose aftësitë), ndihmojnë në përcaktimin e dizajnit të programit dhe nëse është i efektshëm për arrijten e rezultateve të synuara, si dhe për lehtësimin e masave të progresit në vazhdimësi⁹³.

Artikulli i qartë se çfarë synojnë të arrijnë programet R&R jashtë kontekstit të burgut kanë një rëndësi të madhe për vlerësimin efektiv, i cili merr rëndësi kritike për mobilizimin e financimit dhe mbështetjes publike të qëndrueshme për këtë punë. Më tej, është e rëndësishme të mundësohet që progresi të vlerësohet në vijimësi për të siguruar që ndërhyrja të vazhdojë të trajtojë ato që me gjasë mund të jenë nevoja në ndryshim të individit. Gjithashtu, është e rëndësishme të njihen barrierat potencialisht domethënëse shoqërore, kulturore dhe barrierat tjera që konfrontojnë ata që shpresojnë të shkëputen nga VERLT-i, kur vlerësohet ndikimi i ndërhyrjeve⁹⁴.

93 Shih, për shembull, CREST, *Deradicalisation Guide*.

94 Shih, për shembull, Adrian Cherney, "Evaluating Interventions to Disengage Extremist Offenders: A Study of the Proactive Integrated Support Model (PRISM)," *Behavioral Sciences of Terrorism and Political Aggression* (2018), <https://www.tandfonline.com/doi/pdf/10.1080/19434472.2018.1495661?needAccess=true>; A.J. Gielen, "Exit Programmes for Female Jihadists: A Proposal for Conducting Realistic Evaluation of the Dutch Approach," *International Sociology*, (2018), <https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/0268580918775586>; Koehler, "Understanding Deradicalization Methods"; and Marsden, *Reintegrating Extremists*.



6. Ndërrhyrjet

Sikurse theksohet në këtë raport, “ndërrhyrjet që janë në gjendje të ofrojnë një gamë veprimtarish mund të trajtojnë më mirë nevojat e larmishme të atyre që përfshihen në ekstremizëm të dhunshëm⁹⁵.” Natyra precize dhe objekti i ndërrhyrjeve do të variojë në mënyrë të konsiderueshme në varësi të kategorisë apo kategorive të cilave u përkasin përfituesit. Kategoritë përfshijnë (1) autorë të dënuar të veprave ekstremiste të dhunshme që lirohen nga burgu, për të cilët procesi R&R duhet të fillojë sa më herët gjatë vuajtjes së dënimit dhe të paktën gjashtë muaj para lirimit; (2) individë të radikalizuar në VERLT të cilën nuk kanë kaluar në sistemin penal; dhe (3) individë (dhe familjarët) që kthehen nga zona konflikti që nuk janë ndjekur penalisht. Edhe brenda vetë këtyre kategorive natyra dhe objekti i ndërrhyrjeve do të jetë e ndryshme, dhe idealisht çdo ndërrhyrje do të përshtatet sipas nevojave të vlerësuara, dobësive dhe rreziqeve të secilit individ.

Pavarësisht nga nevoja për përshtatjen e ndërrhyrjeve, ndodh pothuajse gjithmonë që “ndërrhyrjet që janë në gjendje të ofrojnë një gamë përfshirëse të veprimtarive mund të trajtojnë më mirë nevojat e ndryshme të atyre që përfshihen në ekstremizëm të dhunshëm.”⁹⁶ Gjithashtu, është e mundur të identifikohen, në përgjithësi, pesë lloje, apo shporta, për të mbështetur ndërrhyrjen. Këto janë mbështetja social-ekonomike; mbështetja psikologjike; mbështetja teologjike apo ideologjike; këshillimi familjar; dhe mbështetja për veprimtari zbatimëse dhe kulturore. Disa shporta mund të jenë të nevojshme për çdo kategori individësh, të tilla si ato që ofrojnë trajnim për punë, punë, strehim dhe mbështetje për mirëqënie sociale. Ndërkohë, disa shporta të tjera me gjasë mund të jenë më të përshtatshme për disa kategori. Për shembull, ata që kthehen nga zona konflikti mund të kenë më shumë gjasë të kërkojnë mbështetje psikologjike për të trajtuar traumën dhe çështje të tjera të shëndetit mendor lidhur me ekspozimin e tyre ndaj dhunës. Ashtu si edhe në rastin e ish autorëve të veprave ekstremiste të dhunshme që kthehen në komunitetet e tyre, programet R&R për të kthyerit duhet të kërkojnë të përfshijnë edhe anëtarë me peshë në familje apo në komunitet, përfshirë edhe për qëllime të ndërtimit të një strukture mbështetëse për individin e cila mund të shërbejë si një rrejtë sigurie në rast të krizës në të ardhmen.

95 CREST, *Deradicalisation Guide*, f.3.

96 Po aty.

6.1 Mbështetja social-ekonomike

Mbështetja materiale për të përmirësuar gjendjen social ekonomike të një individi do të ndihmojë për forcimin e riintegritit dhe reduktimin e gjasave për recidivizëm. Kjo lloj mbështetjeje mund të përfshijë ndihmë për edukimin, strehimin, trajnimin profesional, zhvillimin e aftësive, punësimin dhe kujdesin mjekësor. Sipas rastit, bashkia përkatëse apo ndonjë autoritet tjetër i përshtatshëm, në bashkëpunim me autoritetet e burgut, agjencitë e shërbimit të provës apo aktorë të tjerë mund të përgatisin këtë paketë mbështetjeje për autorët e veprave ekstremiste të dhunshme pas lirimit të tyre nga burgu, për ata që kërkojnë që të shkëputen nga grupet ekstremiste të dhunshme, dhe për ata që kthehen në juridiksionin e tyre e që mund të kenë pasur ndonjë lidhje me ekstremizmin e dhunshëm⁹⁷.

Trajnimi profesional dhe zhvillimi i aftësive mund të jetë me rëndësi tejet të madhe, por nëse ato nuk orientojnë drejt punësimit, atëherë përfituesi i synuar mund të përjetojë nivele domethënëse zhgënjimi, çka mund ta ndërpresë apo ta çënojë procesin e tij të R&R-së. Po ashtu, arsimimi duhet të lidhet me mundësi të shtuara për angazhim civil nëse nuk duam që frustrimi të çojë punën dem⁹⁸.

Praktikuesit dhe ekspertë të tjerë me përvojë në fushën e R&R theksojnë nevojën për ta **përshtatur trajnimin profesional dhe ndihmën për punësim sipas kontekstit lokal dhe interesave të individit.** Punët apo çdo mbështetje tjetër duhet të jetë e krahasueshme me atë që kanë qasje të tjerët në komunitetin pritës, me qëllimin që të parandalohet rritja e zemëratës te individi. Gjithashtu, “presupozimet e lidhura me gjininë apo kulturën për sa i takon llojit të punës që mund ose duhet të bëjnë gratë (dhe burrat)” duhet të shmangen; dhe çdo trajnim për punë dhe përpjekje për zhvillimin e aftësive nuk duhet të nisë në një vakuum, por të mbështetet në informacion të marrë nga vlerësime për tregun e punës.⁹⁹ Më gjerësisht, duhet të merren në konsideratë partneritetet me sektorin privat për të ndihmuar në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe të punësimit në komunitete në të cilat kthehen (apo shpërngulen) përfituesit e programeve R&R. Bizneset lokale mund të angazhohen për të ndihmuar në përcaktimin e nevojave më urgjente të ekonomisë lokale dhe potencialin për zhvillim të ri sektorial dhe trajnim profesional për burrat dhe gratë¹⁰⁰.

97 Shih, për shembull, GCTF, *Addendum to the Hague-Marrakech Memorandum*, GP 4.

98 Shih, për shembull, Georgia Holmer and Adrian Shtuni, *Returning Foreign Fighters and the Reintegration Imperative*, Special Report, United States Institute of Peace, p.7, <https://www.usip.org/sites/default/files/2017-03/sr402-returning-foreign-fighters-and-the-reintegration-imperative.pdf>; Sophie Edwards, “In Somalia, Better Education Alone Is Not Enough to Challenge Extremism,” *DEVEX*, 2 December 2016, <https://www.devex.com/news/in-somalia-better-education-alone-is-not-enough-to-challenge-extremism-89246>; and Liz Hummer, “Youth and Consequences: Unemployment, Injustice and Violence”, Mercy Corps, February 2015, <https://www.mercycorps.org/research-resources/youth-consequences-unemployment-injustice-and-violence>.

99 *Invisible Women*, f. 111.

100 GSX, “10 Steps”.

Rreziqet e nxitjes së zemëratës ekzistojnë jo vetëm mes përfituesve por edhe më gjerë brenda komunitetit. Në veçanti, në një ekonomi që përballet me vështirësi, me nivel të lartë papunësie dhe mundësi të pakta punësimi, duhet të bëhet kujdes për të shmangur krijimin pa dashje të perceptimit se përfituesve të programeve R&R po u jepen më shumë mundësi se anëtarëve të komunitetit që respektojnë ligjin. Dhënia (ose edhe perceptimi se po u jepet) ish autorëve të veprave ekstremiste të dhunshme apo të kthyerve nga zona konflikti një trajtim preferencial, përfshirë në lidhje me të tjerë që mund të kenë pasur ndonjë përfshirje në veprimtari kriminale, mund të krijojë pakënaqësi ndër ata pjesëtarë të komunitetit, të cilët mund të ndihen se po disavantazhohen në mënyrë të padrejtë.¹⁰¹

6.2 Mbështetje psikologjike

Forma të ndryshme të mbështetjes psikologjike mund të lehtësojnë riintegrimin dhe shkëputjen nga VERLT-i. Ata që kanë nevojë për një mbështetje të tillë përfshijnë jo vetëm individët e traumatizuar nga dhuna (p.sh., si rrjedhojë e të jetuarit në një zonë konflikti) por edhe ata që vuajnë nga ankthi apo depresioni apo që kanë nevojë për mbështetje të shëndetit mendor. Ndonëse nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore midis sëmundjes mendore dhe ekstremizmit të dhunshëm, ka të dhëna në rritje se trajtimi i dobët psikologjik është një faktor në radikalizimin drejt dhunës te të rinjtë.¹⁰²

UNODC, Qendra Globale për Siguri Bashkëpunuese, dhe organizata të tjera që kanë studiuar këtë çështje kanë identifikuar lloje të shumta të mbështetjes psikologjike që mund ndihmojë në këtë rast, në varësi të nevojave të përfituesit. Këto përfshijnë (1) lehtësimin e ndryshimit në sjellje; (2) forcimin e aftësive për përballimin dhe administrimin emocional; (3) nxitja e të menduarit kritik dhe kompleks, aftësi për zgjidhjen e problemeve dhe vendimmarrjen; (4) përmirësimi i marrëdhënieve; (5) ndërtimi i vetëvlerësimit; (6) lehtësimi i potencialit personal, zhvillimit; dhe rritjes; (7) adresimi i bindjeve dhe mënyrave të të menduarit që mbështesin dhunën; (8) përmirësimi i vetë-njohurisë dhe të kuptuarit; (9) shërimi i dhimbjes emocionale dhe zgjidhja e pështjellimit; dhe (10) trajtimi i çështjeve që lidhen me identitetin.¹⁰³

101 GCCT and ICCT, *It Takes a Village*, f. 24.

102 Kjo mbështetje nga studime të kohëve të fundit. Për shembull, një shqyrtim policor në 2016 i 500 rasteve me të cilat u mor programi i Kanalit të Mbretërisë së Bashkuar gjeti se 44 për qind e individëve të përfshirë ishin vlerësuar se me gjasë kishin vulnerabilitete që lidheshin me shëndetin mendor apo me vështirësi psikologjike. Shih Vikram Dodd, "Police Study Links Radicalisation to Mental Health Problems", *Guardian*, 20 May 2016, <https://www.theguardian.com/uk-news/2016/may/20/police-study-radicalisation-mental-health-problems>. Sipas ish-drejtnesit të një skuadre lokale PREVENT në Mbretërinë e Bashkuar, një pjesë domethënëse e këtyre rasteve lidhen me raste të tipit-autizëm, disa me skizofreninë, gjendje bipolare, dhe gjendje të shëndetit mendor për shkak të abuzimit me substanca, ku të gjithë këta individë ishin tashtëm të njohur për agjencitë përkatëse të shëndetit mendor apo të mbështetjeve të llojeve të tjera për arsye që nuk lidhen me shqetësimet për radikalizim, ekstremizëm të dhunshëm apo terrorizëm.

103 GCCS, *Compendium of Good Practices*, p. 29; and UNODC, *VEP Handbook*, Section 5.8.

Si ndodh në mënyrë tipike edhe me lloje të tjera të ndërhyrjeve në kontekstin jashtë burgut, individi duhet të jetë i hapur ndaj idesë së futjes në një proces këshillimi. Në disa raste, klienti mundet që, për arsye kulturore apo arsye të tjera, të mos jetë i hapur për mbështetje psikologjike; ndjeshmëria kulturore “është pra e rëndësishme për ndërtimin e besimit para ofrimit të ndonjë shërbimi mbështetjeje. Për këtë qëllim, mund të jetë me vend që të përfshihen lehtësues kulturorë përpara dhe gjatë terapisë apo sesioneve të këshillimit.”¹⁰⁴

6.3 Mbështetje teologjike ose ideologjike

Përpyekjet R&R nuk duhet të kërkojnë ndryshimin e sistemit të bindjeve të një individi, dhe roli preciz i fesë dhe ideologjisë në P/CVERLT mund të ngrejë një numër çështjesh kontroverse, në varësi të kontekstit kombëtar dhe lokal.¹⁰⁵ Megjithatë, janë përdorur një numër ndërhyrjesh të ndryshme **me fokus te teologjia ose politika**, gjithmonë e më shumë si pjesë një qasjeje të shumanshme ndaj R&R-së. Kështu, ndërhyrjet mund të marrin shumë forma (p.sh. këshillim vetëm për vetëm ose në grup), por duhet të përdoren vetëm nëse vlerësimi in individualizuar tregon se mendësia e individit ka nevojë të adresohet; nuk duhet bërë asnjë përpjekje për të shtrënguar dikë të ndryshojë bindjet apo ideologjinë e tyre.

Këto ndërhyrje janë përshkruar në shumë materiale, udhëzues, e korniza të tjera që janë fokusuar së pari në kontekstin e burgut e të shërbimit të provës, por janë të përdorshme edhe R&R jashtë kontekstit të burgut.¹⁰⁶ Megjithëse në vetvete këto ndërhyrje nuk kanë gjasë ta nxisin një individ të shkëputet nga ekstremizmi i dhunshëm apo terrorizmi, ato mundet gjithsesi të shërbejnë për një numër qëllimesh, shpesh të ndërlidhura me njëri tjetrin. Për shembull, ato mundet (1) të zgjerojnë botëkuptimin e përfituesit për të përfshirë këndvështrime dhe interpretime të ndryshme; (2) të krijojnë një hapje kognitive për të lejuar shkëputjen nga ekstremistët e dhunshëm, grupe, apo kauza; (3) të ndihmojnë ruajtjen e një sensi pozitiv të vetes dhe sensi të qëllimit, që do të thotë, vlera e vetes dhe ndjenja e përkatësisë nëpërmjet një identiteti të forcuar fetar; dhe (4) të ndihmojnë në një të kuptuar më të gjerë dhe më të kontekstualizuar të fesë dhe të sfidojnë pikëpamjet dhe përligjen e dhunës, përfshirë mendësinë “ne kundër atyre” dhe forma të tjera të të menduarit bardh-e-zi.¹⁰⁷

104 Koller, *Tertiary Prevention of Islamist Extremism*, f. 6.

105 Ato çështje përfshinin shkallën në të cilën ndarja midis kishës dhe shtetit lejon qeverinë të financojë projekte me një komponent fetar; ndërhyrje në bindjet fetare apo të tjera të individit të mbrojtura me ligj; dhe rolin që luan feja apo ideologjia, nëse ka ndonjë të tillë, në radikalizimin drejt VERLT-it. Shih RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2019, f. 11.

106 Këto korniza përfshijnë RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2019; GCCS, *Compendium of Good Practices*; UNODC *VEP Handbook*; RAN Centre of Excellence, *Approaches to Violent Extremist Offenders and Countering Radicalisation in Prison and Probation*, 2016, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about_-_ran/ran-p-and-p/docs/ran_pp_approaches_to_violent_extremist_en.pdf (hereinafter RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2016"); and Council of Europe *Handbook*, p. 8.

107 Po aty.

Sikurse theksohet në doracakun e UNODC-së për menaxhimin e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm, ndërhyrjet fetare duhet të shmangin fokusin në një doktrinë specifike teologjike dhe të bazohen në edukimin e parimeve të gjera të diversitetit, paqes dhe tolerancës. Ndonëse ka pak të dhëna për të sugjeruar se cilat lloje të ndërhyrjeve fetare kanë kontribuar në R&R, Këshilli i Evropës dhe Grupi i Punës i RAN i Praktikuesve në Burgje dhe Shërbimin e Provës, ndër të tjera, kanë identifikuar një numër elementesh premtues. Këto përfshijnë:

1. Ndërhyrjet që trajtojnë nevojat praktike dhe psikologjike R&R;
2. Ndërhyrjet në nivelin një-me-një që kërkojnë të zgjerojnë botëkuptimin e përfituesit për të përfshirë këndvështrime dhe interpretime të ndryshme, dhe që fokusohen, jo te feja, po te angazhimi kritik me ideologjitë ekstremiste të dhunshme dhe te abuzimi i fesë;
3. Sesione dialogu në grup që pasqyrojnë situata të jetës reale me njerëz me pikëpamje të ndryshme, përfshirë për fenë, politikën, dhe/ose politikën e jashtme, që bashkekzistojnë dhe eksplorojnë në mënyrë konstruktive dallimet në pikëpamje dhe mendime; dhe
4. Ndërhyrje që përfshijnë studimin e vazhdueshëm të retorikave dhe ideologjive që evoluojnë si dhe pakënaqësitë dhe aspiratat e perceptuara.¹⁰⁸

6.4 Këshillimi familjar

Një kategori e katërt ndërhyrjeje që shpesh është komponent thelbësor në një program R&R pas burgut është edhe këshillimi familjar.¹⁰⁹ Dhënia e kësaj mbështetjeje njihet (1) nevojën për të siguruar që përpjekjet R&R të përqendrohen përtej individit që mund të jetë radikalizuar në VERLT apo që ka pasur ndonjë kontakt me terrorizmin; (2) rolin unik që mund të luajë familja dhe rrjetet e miqve, shokëve, etj. për shkëputjen nga dhuna dhe riintegrimin në komunitet; dhe (3) mënyra se si vendosja apo rivendosja e marrëdhënieve të kuptimita me anëtarët e familjes apo persona që i kanë pasur miq apo shokë mund të kontribuojë në R&R efektive.¹¹⁰

Këshillimi familjar mund të ofrohet nga një gamë e gjerë aktorësh, OJQ, punonjës socialë për mbrojtjen e fëmijëve apo të tjerë, oficerë të policisë në komunitet, apo punonjës të shëndetit mendor. Në mënyrë tipike përfshin angazhimin - individual apo të familjes në tërësi - me prindërit, të afërm të tjerë, apo shokë e miq të

108 Shih, për shembull, Council of Europe *Handbook*, f. 43; and RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2019, f. 24. 109 Family counselling typically includes peers as well.

110 Për rolin e familjes në P/CVERLT shih, për shembull, RAN, *Collection of Approaches and Practices, Preventing Radicalisation to Terrorism and Violent Extremism, Family Support*, 2019, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/family_support_en.pdf; The Commonwealth, *Supporting Families in Preventing and Countering Violent Extremism*, 2017, <http://thecommonwealth.org/sites/default/files/inline/ComSec%20CVE%20and%20Families%20Presentation.pdf>; Daniel Koehler, *Using Family Counseling to Prevent and Intervene Against Foreign Fighters: Operational Perspectives, Methodology and Best Practices for Implementing Codes of Conduct*, Middle East Institute, 2014, <https://www.mei.edu/sites/default/files/Koehler.pdf>.

individit në fjalë dhe është zakonisht pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për ta parë familjen dhe rrjetin e miqve, shokëve, etj. të individit dhe të vlerësojë se ku duhen forcuar lidhjet, ku janë konfliktet brenda familjes, dhe cilat marrëdhënie mund të shfrytëzohen. Aty ku ndërveprimet me familjen dhe miqtë, shokët, etj. luajnë një rol të rëndësishëm në radikalizimin në VERLT, siç ndodh në Evropën Juglindore, përfshirja e familjes dhe miqve, shokëve, etj. në R&R merr rëndësi të veçantë.¹¹¹ Megjithatë, para se të ndodhë kjo, është e rëndësishme të vlerësohet nëse dhe cilët anëtarë të familjes dhe miq, shokë, etj. ka gjasë të kenë ndikim pozitiv apo negativ në risocializimin e individit.

Objektivat e këshillimit familjar përfshijnë ndihmën për anëtarët e familjes që (1) të ruajnë ose të zhvillojnë marrëdhënie pozitive me individin; (2) të menaxhojnë stigmën, turpin, dhe/ose rreziqe të sigurisë që mund të përfshihen me shoqërimin e vazhdueshëm ose të përtërirë me individin, në veçanti kur ai apo ajo ka dalë nga burgu apo është kthyer nga një zonë konflikti; dhe (3) të merren me sfidat psikologjike ose sëmundjet mendore me të cilat mund të përballet individi.¹¹²

6.5 Mbështetja për veprimtari argëtuese dhe kulturore

Kategoria e pestë e ndërhyrjes përfshin **sportet, teatrin, artet apo muzikën**. Ashtu si edhe në rastin e përpjekjeve R&R në kontekstin brenda burgut dhe në angazhime P/CVERLT të fokusuara te komuniteti, mundësitë për veprimtari zbativëse dhe kulturore mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përpjekjet R&R në kontekstin jashtë burgut. Ato ofrojnë mundësi që individët të shprehin veten, të rrisin besimin, dhe të krijojnë marrëdhënie pozitive me të tjerë dhe të lehtësojnë shërimin.¹¹³ Gjithashtu, mund të ofrojnë një formë alternative mbështetjeje në rastet kur shërbimet tradicionale të mbështetjes psikologjike nuk janë të disponueshme.

Megjithëse kjo mbështetje nuk ka gjasë që në vetvete të çojë në shkëputjen nga dhuna terroriste apo forma të tjera të saj, ajo mund të japë një kontribut domethënës në shkëputje, përfshirë duke ofruar mesazhe e këndvështrime të tjera.¹¹⁴ Siç e thekson UNODC, sportet dhe artet “ofrojnë një mjet të vlefshëm për të folur për dallimet dhe diversitetin, dhe për të theksuar histori të përbashkëta, përvoja dhe shpresa për shumë njerëz. Dramat dhe artet mund të provokojnë mendim dhe diskutim kritik për historitë e përbashkëta dhe përvojat, të cilat

111 Azinovic, *Regional Report*, pp. 13–14; and RCC, *Waiting Game*, f. 10.

112 EU RAN, Centre of Excellence, *Collection of Approaches and Practices*.

113 GCTF, Detention and Reintegration Working Group Workshop on Education, “Life Skill Courses and Vocational Training for Incarcerated Violent Extremist Offenders, Co-Chairs’ Summary”, 7–8 October 2015, <https://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2015/10/15Nov18-GCTF-DRWG-Co-Chairs-Summary-Workshop-7-8-October-Nairobi.pdf>.

114 Hedayah and the Global Center on Cooperative Security, *Thinking Outside the Box: Exploring the Critical Roles of Sports, Arts, and Culture in Preventing Violent Extremism*, policy brief, February 2015, <http://www.hedayahcenter.org/Admin/Content/File-23201692017.pdf>.

mund të kapërcejnë kufijtë politikë. Sportet mund të jenë gjithashtu një forcë e fuqishme bashkuese. Sportet, artet dhe kultura mund të ndihmojnë edhe për të zhvilluar ... mjete pozitive për të kuptuar dhe trajtuar pakënaqësitë dhe tensionet që mund të kontribuojnë në mbështetjen e ekstremizmit të dhunshëm.”¹¹⁵

Gjatë dekadës së fundit, studiuesit kanë theksuar rolin domethënës që kanë luajtur ndërhyrjet me veprimtari sportive për rehabilitimin e individëve të radikalizuar në terrorizëm,¹¹⁶ veçanërisht kur “synojnë të arrijnë ata që kërkojnë përkatësi në një grup, dhe një sens identiteti.”¹¹⁷ Më tej, ndërhyrjet që bazohen te sportet mund të ofrojnë një mënyrë lidhjeje midis atyre që realizojnë ndërhyrjet me të rinjtë që janë të shkëputur nga komunitetet dhe shkollat; pasi vendosen këto lidhje, ato mund të ofrojnë mundësi për t’u angazhuar me individët e radikalizuar në dhunë dhe përfundimisht për t’i edukuar.

Seminare për terapi arti, përfshirë ato të udhëhequra nga këshilltarët dhe udhëheqësit fetare, po fitojnë gjithmonë e më shumë popullaritet në përpjekjet R&R. Ato “përdorin një larmi formash arti’, përfshirë ‘artin pamor, muzikën, dramën, lëvizjen dhe vallëzimin’, që të ‘veprojnë si një parantezë e butë për të nisur diskutimet’ mbi rrethanat që i çuan njerëzit drejt dhunës ekstremiste. Për të folur për këto rrethana është shpesh e vështirë, dhe arti jep një mundësi për t’i sjellë më lehtë në sipërfaqe. Terapia e artit u lejon ekstremistëve që të ‘dalin nga korniza e rrethanës mbizotëruese’, duke i ndihmuar të njohin dhe të rikornizojnë përvojat e jetës, dhe t’u lejojë praktikuesve CVE mundësinë për të ndikuar pozitivisht në atë rikuadrim.”¹¹⁸

115 UNODC VEP Handbook, p. 89.

116 Cara Richardson, Paul A. Cameron, Katherine M. Berlouis, “The Role of Sport in Deradicalisation and Crime Diversion”, *Journal for Deradicalization*, no. 13 (Winter 2017/18): p. 31, <http://journals.sfu.ca/jd/index.php/jd/article/view/123>.

117 Sarah Marsden, Kim Knott, and James Lewis, *Countering Violent Extremism: An Introduction: Centre for Research and Evidence on Security Threats*, 2017, <https://crestresearch.ac.uk/resources/countering-violent-extremism/>.

118 Jake Shapiro, *Faith and Art: Innovation in CVE* (blog), International Center for Religion and Diplomacy Blog, 15 August 2018, <https://icrd.org/faith-and-art-innovation-in-cve-opinion/>.



7. Ofruesit e ndërhyrjes

Ashtu siç qartësohet në seksionin e mëparshëm, janë përdorur një seri ndërhyrjesh në kontekste të ndryshme për të mbështetur R&R, duke pasqyruar nevojat në ndryshim të individëve që synohen të arrihen dhe natyrën specifike të kontekstit të ndërhyrjeve. Disa programe R&R jashtë kontekstit të burgut fokusohet te një lloj i vetëm ndërhyrjeje, ndërsa të tjerë janë më gjithëpërfshirës dhe mund të integrojnë forma të shumfishta mbështetjeje në një program të vetëm. Pavarësisht nga struktura e një programi të veçantë, dhe siç është theksuar gjatë gjithë këtij udhëzuesi, përpjekjet R&R nevojitet, në mënyrë tipike, të mbështetet te kontributet nga një sferë e gjerë profesionistësh, praktikuesish, dhe aktorësh të tjerë nga një sërë fushash si brenda dhe jashtë qeverisë, duke ndërtuar mbi bazën e një ekspertize të gjerë dhe duke shfrytëzuar besimin dhe besueshmërinë e aktorëve brenda komunitetit në të cilin do të integrohet individi.¹¹⁹ E gjitha kjo është për të ndihmuar që të trajtohen si duhet çështjet komplekse që mund ta kenë shtyrë individin në rrugën e VERLT-it.

Në varësi të natyrës së programit dhe të rreziqeve dhe nevojave të individit, ofruesit e ndërhyrjes mund të përfshijnë një ose më shumë nga sa më poshtë: psikologë, psikiatër, ose profesionistë të tjerë të shëndetit mendor; “ishët”; punonjë socialë; ekspertët për shërbime të kujdesit për të rinjtë; pjesëtarë të familjes; punonjës të shërbimit të provës; dhe oficerë policie. Në varësi të kontekstit, këta aktorë do të kenë detyra të ndryshme, mandate dhe objektiva dhe këto ndryshime mund të paraqesin një sfidë për shkëmbimin e informacionit dhe forma të tjera të bashkëpunimit dhe mund ta bëjë sa më të rëndësishëm aq edhe më të vështirë qartësimin e roleve dhe përgjegjësi të ndryshme. Ky seksion paraqet një seri këndvështrimesh shkurt mbi kontributet që mund të japin disa prej këtyre aktorëve në sferën e R&R jashtë kontekstit të burgut. Përcaktimi se cili/ët ofrues të ndërhyrjes duhet të përfshihen në cilat raste do të varet nga një numër faktorësh, përfshirë kapacitetin e tyre (përfshirë kapacitetin që duhet të angazhohet për një periudhë të qëndrueshme kohore në një rast të caktuar) dhe qasjen e tyre te individi dhe besueshmëria e tij dhe, sipas rastit, te familja e tij apo e saj.

119 Marsden, *Reintegrating Extremists*, f. 15.

7.1 “Ishët”

Ata individë që kanë qenë të përfshirë në VERLT, në veçanti ata që kanë kaluar nëpërmjet një procesi R&R, mund të kenë “një kapacitet unik për të vepruar si mentorë empatikë”¹²⁰ dhe mund të ofrojnë “evidencë dramatike të përfitimeve të ndryshimit”.¹²¹ Besueshmëria e tyre te individët që dëshirojnë ta lënë VERLT-in pas, së bashku me aftësinë e tyre për të “folur të njëjtën gjuhë”, mund t’i bëjë të efektshëm për të ndihmuar në ndërtimin e besimit me individin (si dhe më gjerë me komunitetin) dhe për lehtësimin e përfshirjes së tij apo të saj në grupe ose organizata prosociale dhe demokratike.¹²² “Ishët” mund ta kuptojnë procesin që lidhet me progresionin drejt organizatave ekstremiste të dhunshme dhe daljes prej tyre dhe janë në një pozitë të përshtatshme për të identifikuar dhe për të vlerësuar me saktësi treguesit e rrezikut si dhe nevojat e individit.¹²³

Ndonëse një numër programesh R&R përfshijnë, madje drejtohen nga “ishët”, duhet të garantohet një masë kujdesi para përfshirjes së tyre.¹²⁴ Për shembull, duhet të ketë kaluar mjaftueshëm kohë midis procesit të shkëputjes së tyre dhe përfshirjes së tyre në shkëputjen e të tjerëve. Gjithashtu, të jesh në “ish” nuk do të thotë të jesh dikush që është domosdoshmërisht në gjendje për të mësuar të tjerët për zgjidhje alternative të konfliktit. Për më tepër, aftësia e një “ishi” për të kontribuar në R&R-në e të tjerëve ka gjasë të varet nga aftësitë dhe kualifikimet e tij apo të saj përveç identifikimit të tij apo të saj si një ish në ekstremizmin e dhunshëm. Më tej, ndërsa “ishët” shpesh shihen si zëra të besueshëm, puna e “daljes” shpesh kërkon më shumë e kundër-retorika, në veçanti kur klientët janë të motivuar ideologjikisht.¹²⁵ Si edhe në të gjitha rastet e përfshira në realizimin e ndërhyrjeve R&R, “ishët” duhet të vlerësohen me kujdes dhe më pas të intervistohen dhe më pas të përgatiten para angazhimit të tyre, dhe idealisht përpjekjet e tyre duhet të udhëhiqen nga një skuadër shumëdisiplinëshe.¹²⁶

120 Morton and Silber, *When Terrorists Come Home*, f. 34.

121 GCTF, *Rome Memorandum*, 9–10.

122 Për një diskutim të rolit të ishëve në P/CVERLT shih, për shembull, Marina Tapley and Gordon Clubb, *The Role of Formers in Countering Violent Extremism*, ICCT, 2019, <https://icct.nl/wp-content/uploads/2019/04/ICCT-Tapley-Clubb-The-Role-of-Formers-in-CVE-April2019.pdf>.

123 Morton and Silber, *When Terrorists Come Home*, f. 34.

124 Shih, për shembull, Kathy Gilsinan, “Should We Listen to Former Extremists?,” *Atlantic*, 9 September 2019, <https://www.theatlantic.com/politics/archive/2019/09/risks-former-extremists-fighting-extremism/597583/>.

125 E-mail interview with official from the Violence Prevention Network, September 2019.

126 Për disa konsiderata që duhen marrë parasysh në punën me “ishët”, shih Manualin e Këshillit të Evropës (Council of Europe *Handbook*,) Paragrafi 163.

7.2 Mentorët fetarë dhe këshilluesit

Përtej vlerës së tyre në ndihmën për angazhimin e atyre individëve që mund të kenë përdorur justifikime fetare për veprimet e tyre ose që “dëshirojnë të ndryshojnë drejtimin e jetës së tyre në kuptimin fetar”,¹²⁷ mentorët fetarë dhe këshilluesit mund të shërbejnë për funksione të tjera të R&R në kontekstin jashtë burgut. Në varësi të situatës së veçantë dhe nivelit të tyre të trajnimit, ata mund të ofrojnë mbështetje të përgjithshme psikologjike dhe shpirtërore; të ndërtojnë marrëdhënie me familjen e individit; dhe të identifikojnë kontakte me rrjetet e tyre që mund të ndihmojnë për punësimin, strehimin dhe me mundësi edukimi.¹²⁸ Aty ku është e mundur, mentorët fetarë dhe këshilluesit duhet të punojnë me psikologë të trajnuar ose profesionistë të tjerë të shëndetit mendor për të kuptuar më mirë gjendjen psikologjike, që mund të përfshijë pikëpamjet që evoluojnë drejt VERLT-it. Programet R&R duhet të jenë në gjendje të punojnë me të gjitha fetë brenda një komuniteti, jo vetëm me njërën.

Si edhe në rastin e shumë ofruesve të tjerë të R&R, çelësi për suksesin e mentorëve fetarë dhe këshilluesve është ndërtimi i marrëdhënies bazuar mbi besim me individin dhe, sipas rastit, anëtarë të familjes apo pjesëtarë të tjerë të komunitetit. Një marrëdhënie besimi është thelbësore për ndërveprime të vlefshme dhe për krijimin e një hapjeje kognitive të individit për të lejuar ndryshim.¹²⁹

Kur përfshihen mentorë fetarë dhe këshillues, balancimi i rolit të tyre pastoral me rolin e tyre si kritik apo sfidues i bindjeve ekstremiste të dhunshme mund të jetë një çështje veçanërisht sfiduese. Disa nuk janë në gjendje t'i administrojnë apo t'i balancojnë të dy rolet dhe parapëlqejnë të përqendrohen te njëri ose te tjetri. Disa mund të jenë të efektshëm në të dy rolet (dhe arrijnë të vendosin një balancë të efektshme midis tyre) por ka një rrezik që roli pastoral i një mendori të mund të dëmtohet nëse mentori është apo perceptohet se është tepër kritik dhe tepër sfidues, çka mund të rrisë mosbesimin dhe dyshimin.¹³⁰

Kohët e fundit është shkruar shumë mbi rolin e aktorëve fetarë në R&R në kontekst burgu dhe rëndësinë e fillimit të ndërhyrjeve të fokusuar te feja në kontekstin e burgut. Megjithatë, ashtu siç është e vërtetë për shumë aspekte të ndryshme të punës R&R në kontekst burgu, edhe si nënvizohet nga Grupet e Punës EXIT të Burgut dhe të Shërbimit të Provës (EXIT and Prison and Probation)

127 RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2019, f. 12,

128 GCCS, *Compendium of Good Practices*, p. 49; RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2016, p. 22; UNODC *VEP Handbook*, Sec. 8.8.

129 UN Inter-Regional Crime Institute (UNICRI), and Government of Spain, *Building on the GCTF's Rome Memorandum: Additional Guidance on the Role of Religious Scholars and Other Ideological Experts in Rehabilitation and Reintegration Programmes* (undated), https://toolkit.thegctf.org/Portals/1/Documents/En/UNICRI_SPAIN_Religious_Scholars_in_Rehab.pdf

130 Intervistë me e-mail me një psikolog i mjekësisë ligjore që është ish-anëtar i një ekipi të specializuar P/CVERLT në shërbimin për burgjet dhe shërbimin e provës në Mbretërinë e Bashkuar, shtator 2019.

të RAN-it, “puna është ende larg përfundimit kur personi lirohet nga burgju; ndërhyrja është edhe më e rëndësishme kur personi përjeton vetë sfidën e kthimit në shoqëri”.¹³¹

Aktorët fetarë ose institucionet mund të japin shumë mbështetje dhe stabilitet si për familjet edhe për vetë autorët, jo vetëm duke ofruar drejtim shpirtëror, por edhe duke filluar procesin e përfshirjes dhe të ripërfshirjes së ish-autorit të veprave në bashkësitë e besimit dhe forcimin e faljes dhe shpresës si për komunitetet pritëse edhe për ish autorin e veprave.¹³²

7.3 Psikologët, punonjësit socialë dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve psikologjike

Meqenëse “riintegrimi pasqyron procesin e themelimit mbi një rrjet të marrëdhënieve sociale, më drejtpërdrejt nëpërmjet një angazhimi thellues ndaj një komuniteti më të gjerë, rrjetesh sociale dhe familjes,” ofruesit e mbështetjes psikologjike shpesh luajnë një rol kritik në programet R&R, përfshirë në kontekste jashtë burgut.¹³³ Ashtu si edhe në rastin e profesionistëve të tjerë të përfshirë në punën R&R, në disa raste, ata veprojnë si pjesë e një skuadre me shumë aktorë dhe, në rate të tjera, marrin referime nga agjencitë ligjzbatuese, bashkitë, apo nga burime të tjera.

Psikologët, psikiatërët, ose këshilluesit e traumës mund të ndihmojnë, përfshirë duke dhënë receta për anti-depresantë dhe/ose mjekime kundër ankthit, në situata kur individët mund të jenë kthyer nga zona konflikti e vuajnë nga PTSD-ja apo forma të tjera të traumave, ose mund të kenë kaluar reagime të tilla si depresion dhe ankth. Kur individët e distancojnë veten nga një ideologji e dhunshme dhe i presin lidhjet me një organizatë ekstremiste të dhunshme, ata mund të bien në depresion dhe mund të abuzojnë me alkoolin ose drogat. Individët dhe pjesëtarët e familjes mund të kenë nevojë për vëmendje psikologjike ose mjekësore apo për asistencë specifike për risocializimin, i cili do të kërkojë ndërhyrje bazuar në evidencë, mbikëqyrje dhe monitorim. Në shumë raste, individit mund të ketë qenë viktimë e abuzimit, traumës ose i ekspozimit ndaj dhunës para angazhimit apo shoqërimit me VERLT; kjo përvojë e mëparshme mund të tregojë fare mirë që individit kërkon trajtim të shëndetit mendor ose mbështetje tjetër, pavarësisht nga përfshirja e tyre me VERLT-in.¹³⁴

131 EU RAN, *The Role of Religion in Exit Programmes and Religious Counselling in Prison and Probation Settings*, Ex Post Paper, October 2017, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ran_pp_role_of_religion_in_exit_programmes_10-11_10_2017_en.pdf.

132 EU RAN, *Challenge of Resocialization*.

133 Marsden, *Reintegrating Extremists*, f. 11.

134 Intervistë me një profesor të psikiatrisë me përvojë në punën me çështjet P/CVERLT në disa kontekste Shtator 2019.

Për pjesën e tyre, punonjësit socialë, përveç ndihmesës për individët që të zhvillojnë aftësi të të menduarit kritik dhe të largohen nga një botëkuptim bardhë-e-zi, mund t'i ndihmojnë individët (dhe, sipas rastit, anëtarët e tjerë të familjes) që të adresojnë nevojat e tyre praktike, çka, nëse lihet pa trajtuar, mund të pengojë përpjekjet R&R.¹³⁵ Këto nevoja përfshijnë gjetjen e një shtëpie, sigurimi i punësimit, dhe zhvillimin e një rrjeti social “të shëndetshëm”. Në disa raste, pronarët e shtëpive dhe punëdhënësit mund të jenë ngurrues për t'u angazhuar me këta individë duke pasur parasysh stigmën, frikën, dhe zemërimin që mund të shoqërohet me veprën e kryer prej tyre apo me sjelljen si dhe rrezikun e perceptuar për sigurinë që ata mund të paraqesin.

Përtej mbështetjes së vetë individit, punonjësit socialë mund të mbështesin nevojat e familjes së individit, përfshirë duke i ndihmuar anëtarët e familjes të përballeshin me situatën dhe stigëmn dhe rreziqet e perceptuara për sigurinë, dhe orientimin se si të ndërveprojnë më mirë me individin dhe ta mbështesin atë.¹³⁶

7.4 Organizata të Shoqërisë Civile

Duke qenë se R&R është një proces individual e psikologjik që kërkon angazhimin e vazhdueshëm dhe përfshirjen e komuniteteve lokale, familjeve dhe rrjeteve të tjera mbështetëse, OJF-të japin një kontribut unik. Pjesërisht, kjo vjen sepse ato nuk janë pjesë e qeverisë dhe OJF-të shpesh gëzojnë besimin dhe kanë qasje te individë dhe komunitete të prekur nga VERLT-i në ato mënyra që zyrtarët e qeverisë nuk e kanë të mundur; kjo mund të lehtësojë llojin e angazhimit të qëndrueshëm me individin dhe më gjerë me komunitetin që duket të jetë një element kyç për një punë të efektshme R&R në kontekst jashtë burgut.¹³⁷

OJF-të, nëse janë tashmë duke ofruar shërbime për komunitetet e tyre, mund të jenë aktorët e parë në komunitet që mund të hyjnë në kontakt me individë të liruar nga burgu apo që kthehen nga zona konflikti, në veçanti gra dhe fëmijë. Kombet e Bashkuara kanë njohur avantazhet krahasuese të OJF-ve, përfshirë në sektorët e shëndetit, mirëqenies sociale dhe të edukimit, si dhe në lidhje me njohurinë për komunitetet lokale dhe qasjet në to, si dhe i ka nxitur qeveritë të angazhohen me to në hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve R&R.¹³⁸

135 GCCS, *Compendium of Good Practices*, f. 7

136 Shih, për shembull, njësia për mbështetjen e familjes, Vendet e Ulëta <https://www.landelijksteunpuntextremisme.nl/english>.

137 Shih, për shembull, OSBE, *The Role of Civil Society in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: A Focus on South-Eastern Europe*, 2018, <https://www.osce.org/secretariat/400241?download=true>; and GCCT and ICCT, *It Takes a Village*;

138 UNSC, Madrid Addendum, Principle 11.

Kur bëhet fjalë për R&R në kontekst jashtë burgut, OJF-të mund të ofrojnë këshillim fetar, ndihmë ligjore, mbështetje psikologjike, trajnim profesional, mundësi arsimimi, dhe sensibilizim për ndihmuar komunitetet e rrsakapitura të kuptojnë se si R&R-ja për terroristët e dënuar apo të kthyerit sjell përfitim për komunitetin e gjerë në afat të gjatë. Në disa raste, OJF-të janë ndër të paktët ofrues të shërbimeve që marrin pjesë si në fazat në kontekst burgu edhe jashtë burgut për P/CVERLT R&R. Si të tilla, ato mund të zënë një vend unik për të siguruar një tranzicion të butë midis këtyre fazave.¹³⁹ Në të vërtetë, UNODC-ja e ka njohur rolin e rëndësishëm që luajnë OJF-të (dhe komunitetet më gjerë) në këtë gjë, duke vënë në dukje se si një “proces solid dhe i efektshëm riintegrimi, duke punuar në partneritet të ngushtë me organizata të shoqërisë civile dhe komunitetet, do të lehtësojë tranzicionin e një ish të burgosuri ekstremist të dhunshëm në shoqëri, duke treguar vullnet të mirë në vazhdimësi dhe duke siguruar një strukturë të rëndësishme mbështetjeje për ish të burgosurin ekstremist të dhunshëm në një kohë potencialisht sfiduese.”¹⁴⁰ OJF-të që udhëhiqen nga gratë, në veçanti, janë me rëndësi kritike për njohjen dhe trajtimin e dimensioneve gjinore të R&R-së, përfshirë ndikimet e dhunës seksuale dhe në bazë gjinore si dhe nevojat specifike të “LHT”-ve femra si dhe gra dhe fëmijë të tjerë që kanë lidhje me këtë.

OJF-të janë aktive në punën R&R në një numër vendesh në rajonin e OSBE-së, disa herë duke punuar në partneritet të ngushtë me qeverinë dhe me fonde prej saj. Megjithatë, kjo marrëdhënie e ngushtë ka treguar se është më shumë një përjashtim sesa një rregull. Për këtë, ka një numër arsyesh, që varen nga konteksti. Në disa raste, OJF-të kanë ngurruar të angazhohen në këtë hapësirë për shkak të rreziqeve potenciale ligjore dhe të sigurisë që shoqërojnë angazhimin me një terrorist të dënuar, një individ që është radikalizuar në VERLT, apo një individ që është kthyer nga një zonë konflikti. Në raste të tjera, OJF-ve mund t’u mungojë ekspertiza e nevojshme P/CVERLT apo njohuria për t’u angazhuar. Në disa raste, qeveritë kombëtare (dhe në veçanti, aktorët e sigurisë dhe të zbatimit të ligjit) kanë ngurruar të përfshirjnë aktorë joqeveritarë në atë që ato që ata i perceptojnë se janë raste sensitive e me rrezik të lartë e që përfshijnë potencialisht njerëz të rrezikshëm. Në disa raste të tjera, qeveritë kombëtare nuk u kanë siguruar OJF-ve qartësinë e duhur ligjore ose mbështetjen politike apo financiare për të lehtësuar përfshirjen e tyre.¹⁴¹ Ndaj, sipas gjetjeve të një hartëzimi të kohëve të fundit të përfshirjes së OJF-ve në P/CVERLT në Evropën Juglindore, OJF-të, pavarësisht nga avantazhet e tyre konkurruese të njohura tashmë, nuk janë të përfshira në punën R&R. Ata “nuk punojnë me luftëtarë të huaj terroristë që kthehen... dhe/ose familjet dhe nuk marrin pjesë në ndërhyrje të individualizuara me anëtarët e komunitetit të identifikuar se janë ‘në rrezik’ radikalizimi në ekstremizëm të dhunshëm.”¹⁴²

139 GCCT and ICCT, *It Takes a Village*, p. 3. 140 UNODC VEP Handbook, f. 128.

141 GCTF, *Returning Families Good Practices*, Good Practice 18.

142 Eric Rosand, *Civil Society Organisations in Preventing and Countering Violent Extremism in the Western Balkans: Mapping Report*, Forum MNE, February 2019, https://organizingagainstve.org/wp-content/uploads/2019/02/regional_report.pdf.

Pavarësisht nga avantazhet krahasuese që mund të sjellin OJF-të në punën R&R, mund të kërkohet një kujdes i caktuar në lidhje me përfshirjen e tyre në procesin e R&R-së. “Jo çdo OSHC ka besueshmërinë, legjitimitetin, dhe marrëdhënien afatgjatë me komunitetet dhe qeveritë për të bërë një punë të tillë” dhe, ashtu si trajtohet edhe më poshtë, “shumë prej tyre nuk i kanë burimet bazë dhe kapacitetet për të ndërmarrë punë të specializuara për [parandalimin dhe kundërvënien ndaj] ekstremizmit të dhunshëm.”¹⁴³ Në disa raste, me gjithë kufizimet e tilla, OJF-të kanë kërkuar gjithsesi të përfshihen në projekte R&R të financuara nga qeveria, duke pasur rezultate mikse.¹⁴⁴

7.5 Anëtarët e familjes dhe miqtë e ngushtë

Ndonëse nuk ka një model të vetëm për realizimin e R&R në kontekst jashtë burgut, të gjitha përpjekjet duhet të marrin parasysh marrëdhëniet në komunitet dhe të kuptuarit lokal të normave sociale. Në këtë aspekt, anëtarët e familjes dhe miqtë e ngushtë të individit, duke presupozuar se ata janë përcaktuar se janë në gjendje të kenë një ndikim pozitiv mbi individin, mund të shërbejnë si “bashkëbisedues të privilegjuar midis autoriteteve, komuniteteve dhe përfituesve”,¹⁴⁵ mund të marrin përgjegjësi për ta kthyer përfituesin në rrjedhën e përgjithshme, dhe mund “të sigurojnë një portë hyrëse për rikthimin në shoqëri”.¹⁴⁶ Si të tillë, ata mund të luajnë një rol të rëndësishëm për hartimin e planeve R&R dhe realizimin e ndërhyrjeve R&R. Kjo është theksuar nga Kombet e Bashkuara, GCTF-ja, RAN-i dhe organizata të tjera që kanë prodhuar korniza dhe udhëzime në lidhje me R&R në kontekst jashtë burgut.¹⁴⁷

Për shembull, GCTF-ja ka njohur se si “familja mund të funksionojë si një ‘faktor tërheqës’ për ekstremistët e dhunshëm që të heqin dorë nga dhuna, dhe [se si] një qasje me bazë familjen ka qenë një tipar kyç në përpjekjet për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre. ... Ndonëse shkëputja është një proces dhe jo një ngjarje statike, lidhjet familjare duket të jenë një faktor i rëndësishëm për

143 Eva Entenmann, “What to Do with Terrorists Released from Prison: A Task Beyond Government Control?”, *Security and Human Rights Monitor*, 23 August 2018, <https://www.shrmonitor.org/countering-violent-extremism/>.

144 Shih, për shembull, “Déradicalisation des jihadistes en France: Un «fiasco» selon un rapport du sénat,” *Midi Libre*, 22 shkurt 2017, <https://www.midilibre.fr/2017/02/22/deradicalisation-des-jihadistes-en-france-un-fiasco-selon-un-rapport-du-senat,1469798.php>.

145 UN Centre on Counter-Terrorism (UNCCT) and UN Inter-Regional Crime Institute (UNICRI), *Additional Guidance on Aftercare and Reintegration Programmes for Violent Extremist Offenders*, 2014, <https://toolkit.thegctf.org/Portals/1/Documents/En/Additional-Guidance-on-Aftercare-and-Reintegration-Programmes-for-VEO.pdf>.

146 RAN Returnee Manual, f. 57.

147 Shih, për shembull, *UNSC Madrid Addendum; GCTF, Initiative to Address the Life Cycle of Radicalization to Violence*, and *EU RAN The Role of Family and Social Networks in the Rehabilitation of (Violent) Extremist and Terrorist Offenders*, RAN Ex Post Paper, March 2018, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ran_pp_role_family_social_networks_rehabilitation_extremist_terrorist_offenders_06-07_03_2018_en.pdf.

formësimin e rezultateve dhe krijimin e ‘hapjeve kognitive’ nëpërmjet të cilave ish ekstremistëve të dhunshem mund të rivlerësojnë përkushtimin e tyre.”¹⁴⁸

More konkretisht, **pjesëtarët e familjes mund ta lehtësojnë procesin R&R në një numër mënyrash praktike duke:**

1. Ndhimuar individët të trajtojnë sfida që ata kanë identifikuar për shkëputje nga VERLT;
2. Ndhimuar individët të identifikojnë dhe të ndërtojnë pikat e forta, kapacitetet, dhe aftësitë dhe të gjejnë mundësi dhe veprimtari në nivel komuniteti për të mbështetur R&R e tyre;
3. Sfiduar arsyetimin e individëve për mbështetjen e VERLT;
4. Ofruar një sens të vazhdueshëm shprese dhe përkatësie; dhe
5. adresuar faktorët dhe pakënaqësitë që mund të jenë një pengesë për pajtimin afatgjatë që kërkon një proces R&R që zgjat.¹⁴⁹

Për ish të burgosurit terroristë drejt kthimit në shoqëri, anëtarët e familjes mund të kenë pasur qasje te këta gjatë qëndrimit në burg dhe mund të kenë pozitë të volitshme për të siguruar vazhdimësinë në procesin e rehabilitimit pas lirisë.¹⁵⁰

Megjithatë, para se të kërkohet përfshirja e anëtarëve të familjes në përpjekjet R&R, duhet kushtuar vëmendje e veçantë për të siguruar që ata nuk kanë qenë pjesë e arsyes së radikalizimit të individit në dhunë që në krye të herës dhe që ata janë në të vërtetë në gjendje të mbështesin, dhe jo të dëmtojnë (me apo pa qëllim) procesin R&R.¹⁵¹

7.6 Punonjësit e policisë

Megjithëse përgjegjësia parësore për punën R&R në kontekstin jashtë burgut, në mënyrë tipike, është e profesionistëve joligjzbatues, punonjësit e policisë, duke pasur parasysh pozitën e tyre unike në komunitet, mund të kontribuojnë si për menaxhimin e rreziqeve që kanë të bëjnë me individin edhe për lehtësimin e risocializimit të tij apo të saj. Përfshirja e policisë fillon me kontributin për vlerësimin e rreziqeve dhe nevojave të individit. Mënyra se si do të zhvillohet më tej përfshirja e policisë do të varet nga disa faktorë të ndryshëm, përfshirë rrezikun e vlerësuar që mund të paraqesë individi për komunitetin dhe nivelin

148 GCTF, *Initiative to Address the Life Cycle of Radicalization to Violence, The Role of Families in Preventing and Countering Violent Extremism: Strategic Recommendations and Programming Options*, 2016, Recommendation 5, <https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Lifecycle%20Toolkit-documents/English-The-Role-of-Families-in-PCVE.pdf?ver=2016-09-13-141058-860>.

149 GCCS, *Compendium of Good Practices*, f. 47; Council of Europe *Handbook*, Paragraph 144; and RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2016, f. 20–21.

150 GCCT and ICCT, *It Takes a Village*, f. 3.

151 Shih, për shembull, Chris Bosley, *Injecting Humanity: Community-Focused Responses for People Existing Violent Extremist Conflict*, Special Report No. 452, United States Institute of Peace, August 2019, p. 17, https://www.usip.org/sites/default/files/2019-08/20190822-sr_452-sr.pdf; and Adrian Cherney, "The Release and Community Supervision of Radicalised Offenders: Issues and Challenges That Can Influence Reintegration," *Terrorism and Political Violence* (November 2018), <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/09546553.2018.1530661>.

e besimit që policia lokale apo një punonjësit i veçantë mund të ketë me individin dhe familjen e tij apo të saj si dhe më gjerë me komunitetin. Gjetja e balancës së duhur midis zbutjes së rrezikut dhe ndërtimit të besimit është e rëndësishme, sepse një përfshirje e tepruar e zbatimit të ligjit, në varësi të situatës, mund të dëmtojë ndonjë prej objektivave të çdo programi R&R: krijimi i një hapeje kognitive te individi për t'i mundësuar të fillojë nj proces që lejon shkëputjen nga dhuna.

Në disa raste, punonjësit e policisë punojnë ngushtësisht me familjen e individit gjatë gjithë periudhës së vuajtjes së dënimit në burg ose pasi ai apo ajo ka udhëtuar në zonë konflikti; në disa raste, oficerët janë në gjendje ta vizitojnë një autor të veprave që lidhen me terrorizmin në burg, i cili do të lirohet në komunitetin e oficerit. Në rastin e një individi të liruar apo që ka pasur kontakt me VERLT por nuk është akuzuar a dënuar për një krim dhe nuk ka shkuar në burg, dhe në varësi të rrethanave të veçanta - përfshirë nivelin e besimit midis policisë dhe komunitetit përkatës dhe kapaciteteve të subjekteve përkatëse që nuk janë ligjzbatuese - policia lokale mund të bashkërendojë përpjekjet R&R me shumë aktorë ose të kontribuojë në ato që bashkërendohen nga aktorë që nuk janë ligjzbatues, të tilla si bashkitë.

Në rastet kur një autor i veprave që lidhen me terrorizmin lirohet në shërbim prove, përfshirja formale pas lirimit e policisë mund të kufizohet në periudhën e shërbimit të provës, pavarësisht nëse kjo përkon apo jo me procesin e rehabilitimit dhe riintegrimit të individit në fjalë. Kur është marrë një vendim për të mos e ndjekur penalisht një individ që është kthyer nga një zonë konflikti ose kur nuk ka bazë ligjore për përfshirje të policisë, roli i policisë duhet të kufizohet në mënyrë të ngjashme.¹⁵²

Duke pasur parasysh natyrën fluide të këtyre rasteve dhe ndjeshmëritë që mund të lindin kur policia merr rolin ballor e të dukshëm të përpjekjeve R&R jashtë kontekstit të burgut, si dhe rëndësinë e zbutjes së çdo rreziku të sigurisë që paraqitet nga individi - rreziqe që mund të ndryshojnë gjatë procesit R&R - është thelbësore që të sigurohet që të ketë mënyra të efektshme për shkëmbimin e informacionit dhe mundësimin e bashkëpunimit midis policisë dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në rastin R&R.

152 EU RAN, *What Role Do Police Play in the Resocialisation and Risk Management of Released Former Terrorist Offenders?*, RAN, Ex Post Paper, May 2019, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-pol/docs/ran_pol_role_do_police_play_in_resocialisation_marseille_20190520_en.pdf.

7.7 Punonjësit e shërbimit të provës

Shpesh, duke pasur parasysh përgjegjësinë për autorët në kontekstin fillestar pas lirimimit (përfshirë kur është vendosur nga gjykata një program R&R) dhe më tej (p.sh. deri në përfundim të dënimit), punonjësit e shërbimit të provës mund të shërbejnë si një urë midis përpjekjeve R&R në kontekstin e burgut dhe në kontekstin jashtë tij.

Puna e tyre po tërheq gjithmonë e më shumë vëmendjen në kontekstin e P/CVERLT për arsye që janë të ndërlidhura. Këto përfshijnë një rritje të qëndrueshme në numrin dhe diversitetin e autorëve të veprave që lidhen me terrorizmin, shumë prej të cilëve kanë qenë të dënuar sipas një kuadri ligjor në zgjerim për kundërterrorizmin që tani përfshin vepra (p.sh. dhënie e mbështetjes materiale apo apologji për organizatat ekstremiste terroriste) që mund të rezultojnë në dënime më të shkurtra se ato që u jepen individëve që shpallen fajtorë për një përfshirje më të drejtpërdrejtë në dhunë terroriste. Një arsye e dytë për rritjen e vëmendjes është sasia shpesh e kufizuar e kohës që është në dispozicion për të filluar një program R&R në burg dhe për të përgatitur një tranzicion pas burgut, çka do të thotë se punonjësit e shërbimit të provës mbajnë mbi supë një barrë më të madhe për të hartuar dhe për të zbatuar programe të tilla.¹⁵³ Gjithsesi, punonjësit e shërbimit të provës nevojitet të menaxhojnë rreziqet e VERLT-it ndërkohë që sigurojnë që autorët mbështeten dhe ri-integrohen pas lirimimit të tyre, duke u njohur faktin se, ashtu si theksohet nga UNODC, rehabilitimi dhe riintegrimi i tyre në komunitet duhet të jetë ndër objektivat e sistemeve kombëtare të drejtësisë penale.¹⁵⁴ Më tej, ndërsa vijojnë punën, punonjësit e shërbimit të provës ka gjasa të gjenden në qendër të kontrollit të medias, duke pasur parasysh interesin publik për individë të etiketuar si “terroristë”.

Në disa juridiksione, shërbimet e provës janë të ndara nga shërbimet korrigjuese; në disa të tjera, ato janë pjesë e së njëjtës agjenci apo nuk ekzistojnë fare. Në disa vende, shërbimet e provës janë të organizuara në nivel lokal ose rajonal, çka mund të ketë ndikim mbi mënyrën e shkëmbimit të informacionit midis agjencive dhe aktorëve të ndryshëm dhe mënyrën e bashkëpunimit midis tyre. Në vende të tjera, si në Austri, shërbimet e provës ofrohen nga një OJQ e financuar nga qeveria dhe jo nga një agjenci qeveritare.¹⁵⁵

Kontributet R&R të shërbimeve të provës janë të larmishme dhe mund të përfshijnë (1) hartimin dhe mbështetjen e planeve për shpërnguljen ose rifutjen në komunitet; (2) monitorimi i respektimit të kufizimeve të lirimimit;

153 RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2019, f. 28.

154 UNODC, *Introductory Handbook on the Prevention of Recidivism and the Social Reintegration of Offenders*, 2012, p. 13, https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/Introductory_Handbook_on_the_Prevention_of_Recidivism_and_the_Social_Reintegration_of_Offenders.pdf. Në të vërtetë, e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut parashikon që “sistemi penitenciar përmban një trajtim të të dënuarëve që ka për qëllim thelbësor riedukimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.” ICCPR, neni 10, paragrafi 3.

155 Neustart, “Probation Service: Together We Come Ahead,” <https://www.neustart.at/at/de/>.

(3) drejtimi i veprimtarive për ri-integrim; (4) sigurimi i burimeve për të ndihmuar që të sigurohet se nevojat bazë të autorit të veprës/ave, përfshirë kushtet për jetesë, pas lirit; dhe (5) sigurimi i instrumenteve për autorët e veprës/ave me qëllim që ata të jenë në gjendje të përshtaten në mjedisin pas lirit dhe që përfundimisht të ri-integrohen në komunitet.¹⁵⁶ Më tej, punonjësit e shërbimit të provës në juridiksionet që kanë shërbime prove qeveritare shpesh shërbejnë si lojtarë kyç për bashkërendimin e përpjekjeve dhe shkëmbimin e informacionit për R&R, përfshirë mbledhjen e kontributeve nga policia, aktorë të shoqërisë civile, dhe familjeve.

7.8 Autoritetet vendore

Autoritete bashkiake dhe autoritete të tjera vendore mund të kontribuojnë në shumë mënyra për programet R&R në kontekstin jashtë burgut dhe duet të jenë lojtarë kyç në hartimin dhe zbatimin e këtyre nismave në përpjekjet P/CVERLT dhe më gjerë. Roli i tyre duhet të pasqyrohet në kornizat dhe strategjitë përkatëse kombëtare.

Në shumë raste, autoritetet vendore do të kenë përgjegjësinë për shërbime që kërkojnë ata individë që marrin pjesë në programet R&R në kontekst jashtë burgut, si për shembull për strehimin, arsimimin, trajnimin profesional, shërbime sociale, apo veprimtari zbativëse dhe kulturore. Për shembull, një autoritet vendor mund të jetë në gjendje ta ndihmojë individin të gjejë punë apo një vend për të jetuar edhe pse puna dhe strehimi mund të jetë e vështirë të gjenden përndryshe.¹⁵⁷ Si të tilla, autoritetet vendore mund të jenë në pozitën më të favorshme për të siguruar që të jetë gati një paketë me masa për mbështetje praktike kur individit të dalë nga burgju apo kur të kthehet nga një zonë konflikti në komunitet.

Në disa raste, autoritetet vendore janë në një pozitë të favorshme për të bashkërenduar këto programe me shumë aktorë në fusha nën juridiksionin e tyre, duke shërbyer si një urë midis komunitetit vendor lokal dhe policisë dhe aktorëve të tjerë të sigurisë si dhe midis praktikuesve lokalë dhe qeverisë kombëtare. Siç u vu në dukje edhe nga GCTF-ja, ata mund të ndihmojnë në përgatitjen e komunitetit lokal për të pranuar rikthimin apo rifutjen në këtë komunitet të atyre individëve që janë përfshirë në programet R&R.¹⁵⁸ Në këtë drejtim, “roli që ata luajnë për forcimin e kohezionit social për të zbutur rrezikun e recidivizmit dhe për të nxitur tolerancën brenda një komuniteti ndihmon për të krijuar një mjedis për ri-integrim të suksesshëm.”¹⁵⁹

156 GCCS, *Compendium of Good Practices*, f. 46; Council of Europe Handbook, Paragrafi 91; GCTF Rome Memorandum, Good Practice 22; RAN P&P Practitioners' Working Paper, 2016, f. 5; dhe *UNODC VEP Handbook*, Section 8.9.

157 Marta Lopes and Simon Dukic, “Repatriation of Foreign Terrorism Fighters: Cases for the West”, *European Eye on Radicalization*, 19 July 2019, <https://eeradicalization.com/repatriation-of-foreign-terrorist-fighters-cases-for-the-west/>.

158 GCTF Addendum to the Hague-Marrakech Memorandum.

Në të vërtetë, shumë vende në rajonin e OSBE-së, autoritete vendore, me mbështetje thelbësore dhe burime nga qeveria kombëtare dhe si pjesë e një kuadri gjithëpërfshirës kombëtar për P/CVERLT-in që përcakton rolin e rëndësishëm të bashkive, po udhëheqin nismat R&R në nivel lokal dhe janë kontribues domethënës në përpjekjet P/CVERLT. Megjithatë, në disa vende të tjera, autoriteteve lokale u mungojnë burimet dhe ekspertiza bazë, për të mos përmendur strukturat dhe kulturën institucionale, për të mundësuar atë lloj shkëmbimi të informacionit dhe bashkëpunimi midis shumë aktorëve që gjetkë është vërtetuar se qëndron në themel të përpjekjeve R&R.

Disa qeveri kombëtare mbeten ngurruese për t'i konsideruar autoritetet vendore si partnerë për trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm, sidomos për trajtimin e rasteve potencialisht të ndjeshme të individëve që janë radikalizuar në terrorizëm apo ekstremizëm të dhunshëm. Ato ngurrojnë të dorëzojnë kontrollin e burimeve mbi ato që i perceptojnë si shqetësime të sigurisë kombëtare, dhe qeverisja vendore shpesh përjashtohet nga politikat dhe diskutimet e programimit për P/CVERLT, përfshirë R&R.¹⁶⁰

Me rritjen e vëmendjes që po i kushtohet - nga GCTF-ja dhe Strong Cities Network,¹⁶¹ ndër të tjera - rolit të qyteteve për P/CVERLT, një numër më i madh autoritetet vendore ka gjasë të fillojnë të kontribuojnë për nismat R&R në kontekst jashtë burgut dhe një numër më i madh i qeverive kombëtare ka gjasë të njohi avantazhet krahasuese që sjellin autoritetet vendore në këtë sfidë. Megjithatë, duke pasur parasysh burimet e kufizuara dhe faktin se këto nisma fokusohen në një numër të vogël individësh që kërkojnë të rikthehen apo të rivendosen në një numër të vogël komunitetesh në një vend të caktuar, pyetja se cilët qytete duhet të zhvillojnë programe R&R duhet shqyrtuar me kujdes. Mund të jetë e këshillueshme të krijohet një program kombëtar për të dhënë mbështetje ad hoc për ato qytete që shpesh përballen me një rast R&R por që u mungon ekspertiza dhe burimet për të administruar një program R&R. Një program i tillë në nivel kombëtar mund të ndihmojë për zbutjen e një prej rreziqeve lidhur me mbështetjen tepër të madhe të qytetet: konkretisht, rrezikun që një pjesëmarrës në një program lokal R&R të lëvizë në një bashki tjetër, “efektivisht duke e transferuar problemin, dhe në këtë mënyrë edhe përgjegjësinë për ... programin në një tjetër qeveri vendore”¹⁶² që është e papajisur për ta trajtuar.

160 Eric Rosand and Rebecca Skellett, "Connecting the Dots: Strengthening National-Local Collaboration in Addressing Violent Extremism", *Lawfare*, 27 Oct. 2018, <https://www.lawfareblog.com/connecting-dots-strengthening-national-local-collaboration-addressing-violent-extremism>.

161 Strong Cities Network [Rrjeti për Qytete të Forta] është një rrjet global i autoriteteve nënkombëtare që lehtëson shkëmbimin e praktikave të mira, sfidave, ekspertizës dhe përvojës për P/CVERLT midis praktikuesve lokalë. Shih www.strongcitiesnetwork.org.

162 Veldhuis, *Reintegrating Violent Extremist Offenders*, f.7



8. Mundësimi i një veprimtarie të efektshme nga shumë aktorë, shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi

Në varësi të rastit dhe kontekstit specifik, përpjekjet R&R në kontekst jashtë burgut mund të përfshijnë aktorë nga fusha të ndryshme - qeveritarë dhe joqeveritarë; kombëtarë dhe vendorë; ligjzbatues dhe jashtë zbatimit të ligjit - që realizojnë një gamë të gjerë veprimtarish, ndërsa balancohet nevoja për mbështetjen e risocializimit të individit me nevojën për të siguruar siguri të komunitetit. Individët dhe familjet e tyre do të kenë disa vulnerabilitete dhe nevoja, të cilat asnjë institucion apo profesionist nuk do të ishte në gjendje t'i trajtonte i vetëm. Prandaj, është e rëndësishme që të ketë një qasje që lejon përfshirjen e shumë aktorëve apo agjencive dhe shkëmbimin në mënyrë konsistente të informacionit në respekt të të drejtave të njeriut ndërmjet të gjithë profesionistëve të përfshirë. Megjithatë, arritja e kësaj mund të paraqesë sfida, duke pasur parasysh që këta aktorë dhe agjenci mund të mos kenë një historik bashkëpunimi me njëri tjetrin dhe mund të kenë “interesa që bien ndesh dhe ide që konkurrojnë midis tyre në lidhje me çfarë duhet bërë dhe si duhet bërë, dhe kjo mund të jetë një sfidë për t'i angazhuar të gjitha palët përkatëse dhe për t'i bërë që të jenë të gatshme të bashkëpunojnë.”¹⁶³

Aktorë të ndryshëm mund të kenë informacion të rëndësishëm për një individ të vetëm, dhe i gjithë ky informacion duhet të shqyrtohet si pjesë e rrezikut dhe vlerësimit të vulnerabiliteteve dhe duhet të vendoset në dispozicion të atyre që hartojnë planin për ndërhyrje apo mbështetje. Megjithatë, korniza profesionale dhe etike si dhe qëllime që janë të ndryshme mund ta vështirësojnë shkëmbimin e informacionit. Disa prej këtyre vështirësive dhe sfidave të tjera trajtohen në Seksionin 5.3.

Si të tilla, dhe sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara, GCTF-së, RAN-it dhe institucione të tjera, **miratimi i udhëzuesve të qartë, protokolleve, marrëveshjeve, si dhe mbikëqyrjes dhe proceseve të shqyrtimit të pavarur dhe e kornizave të tjera për të lehtësuar shkëmbimin e njohurisë dhe ekspertizës dhe për të mbrojtur me kujdes informacionin do t'u mundësonte aktorëve të shumtë nga profesione të ndryshme të vlerësonin së bashku një rast individual në mënyrë të efektshme dhe të sigurtë.**¹⁶⁴ Këto korniza mund të ndihmojnë për mbrojtjen e privatësisë individuale dhe të të dhënave, për shembull, duke qartësuar se në cilat rrethana, nëse ka, policia, nëse është e përfshirë, mund të përdorë informacionin e shkëmbyer me një skuadër për mbledhjen e informacioneve për qëllime të inteligjencës dhe zbatimit të ligjit dhe në çfarë informacionesh mund të kenë qasje dhe kur aktorë që nuk janë ligjzbatues.¹⁶⁵

Bashkëpunimi midis aktorëve të shumëfishtë, i cili mund të jetë sfidues për ta vënë në zbatim dhe për të qenë i qëndrueshëm, në veçanti duke pasur parasysh kompleksitetin potencial dhe ndryshueshmërinë e disa prej situatave R&R jashtë kontekstit të burgut, do të nevojitet të përfshijë praktikues që punojnë së bashku në raste individuale, si dhe familjet, OSHC-të, dhe grupe fetare dhe të tjera të komunitetit.¹⁶⁶ Në konsideratë duhet marrë edhe përfshirja e të liruarit. Sipas praktikuesve të RAN-it, “një qasje e tillë gjithëpërfshirëse është parakusht për riintegrimin e plotë të grupit të posaçëm të synuar të ish [ekstremistëve të dhunshëm apo individëve të tjerë të synuar të ndërhyrjeve R&R jashtë kontekstit të burgut] në shoqëri. Mbështetja dhe bashkëpunimi i profesionistëve dhe i mjedisit rrethues shoqëror mundësojnë qasje thelbësore të [individit të synuar], çka nuk jepet domosdoshmërisht nëse individin e ndihmojnë vetëm disa palë të caktuara.”¹⁶⁷

164 Shih, për shembull, UNSC Madrid Addendum, Guiding Principle 5; GCTF, *Initiative to Address Homegrown Terrorism: Rabat-Washington Good Practices on the Prevention, Detection, Intervention and Response to Homegrown Terrorism*, September 2018, p. 10, https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/C/GCTF-Rabat-Washington-Good-Practices_ENG.pdf?ver=2018-09-21-122245-707; and RAN Returnee Manual, Chapter 4.

165 Shih Hemmingsen, *Danish Approach to Countering and Preventing Extremism*, f.15.

166 Për një diskutim të disa prej sfidave për vënien në zbatim të bashkëpunimit midis shumë aktorëve, shih, për shembull, EU RAN, *Multi-Agency Working and Preventing Violent Extremism: Paper 2*, RAN Health & Social Care Position Paper, 2019, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran-h-and-sc/docs/ran_hsc_policy_mawr_report_sarma_26032019_en.pdf.

167 EU RAN, *The Role of Family and Social Networks in the Rehabilitation of (Violent) Extremist and Terrorist Offenders*, RAN Ex Post Paper, March 2018, f. 8–9, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran-p-and-p/docs/ran_pp_role_family_social_networks_rehabilitation_extremist_terrorist_offenders_06-07_03_2018_en.pdf.

Më tej, bashkëpunimi i qëndrueshëm midis shumë aktorëve mund të jetë i dobishëm për ruajtjen e përfshirjes së mësuesve, punonjësve të kujdesit shëndetësor, udhëheqësve të të rinjve, dhe të të tjerëve në komunitet që mund të jenë në gjendje të raportojnë për ecurinë e procesit R&R dhe, më e rëndësishmja, të ndihmojnë për zbulimin e recidivizmit potencial në VERLT.

Ashtu si edhe në rastin e përpjekjeve R&R dhe P/CVERLT më gjerë, nuk ka një mënyrë të vetme për të vënë në zbatim bashkëpunimin midis shumë aktorëve. Në rajonin e OSBE-së janë zhvilluar shumë qasje, ku secila prej tyre pasqyron kontekstin lokal ligjor, politik, dhe kulturor. Disa shembuj përfshijnë sa më poshtë:

- **The Info House në Aarhus, Danimarkë:** Në këtë nismë përfaqësues nga agjenci të ndryshme, përfshirë policinë dhe shërbimet sociale, si dhe bashkinë, mbledhen çdo dy javë dhe shqyrtojnë dhe vlerësojnë raste të lidhura me radikalizimin dhe diskriminimin. Skuadra përcakton nëse personi mund të ketë kryer një veprë penale dhe nëse të vazhdohet monitorimi apo të ndërhyhet dhe çfarë lloj ndërhyrjeje, nëse vendoset, do të ndiqet. Ndërhyrje të mundshme përfshijnë këshillimin social, mbështetje të shërbimeve sociale, mentorim dhe këshillim psikologjik. Platforma financohet me fonde publike dhe, meqenëse të gjithë përfaqësuesit e agjencive të ndryshme kanë autoritet vendimmarrës, vendimet merren dhe zbatohen në kohë.¹⁶⁸
- **Konferenca të rasteve, Rotterdam dhe qytete të tjera të mëdha në Vendet e Ulëta:** Këto konferenca përfshijnë përfaqësues nga qeveria lokale, shërbimi i provës, organizata për kujdesin e të rinjve, policia dhe prokuroria, si dhe profesionistë të kujdesit shëndetësor. Ky grup mbledhet çdo javë për të vlerësuar rreziqet dhe nevojat R&R të individëve.¹⁶⁹
- **Njësi vendore për parandalimin e krimit dhe radikalizimit, Francë:** Franca ka ngritur qeliza administrative me shumë aktorë në secilën prefekturë (ose lokalitet) në vend për të bërë lidhjen me qeverinë qendrore mbi çështjet e radikalizimit. Qeveria qendrore në Paris, që është përgjegjëse për çështjet e sigurisë kombëtare, ua cakton rastet prefekturave të ndryshme. Njësia përfshin profesionistë të caktuar nga ministrinë përgjegjëse për familjen, shëndetësinë, drejtësinë dhe arsimin. Në rastin kur janë të përfshirë të mitur - për shembull, fëmijë që kthehen nga zona konflikti - kjo punë bashkërendohet me njësitë lokale për Parandalimin e Radikalizimit dhe Mbështetjen e Familjes (CPrAF), të cilat përfshijnë skuadra me përfaqësues nga disiplina të ndryshme për të ndihmuar për "të siguruar kujdesin e nevojshëm afatgjatë social, mjekësor dhe psikologjik për fëmijët që kthehen nga zonat e luftimeve terroriste duke hartëzuar burimet e disjponueshme psikiatrike për fëmijët, të cilat mund të përdoren nën mbikëqyrjen e gjytarëve të gjykatave të të miturve."¹⁷⁰

168 Hemmingsen, *Danish Approach to Countering and Preventing Extremism*, f. 27–28. 169 EU RAN, *Challenge of Resocialisation*, f. 10–11.

169 EU RAN, *Challenge of Resocialisation*, f. 10–11.

170 Government of France, *Prevent to Protect: National Plan to Prevent Radicalisation*, February 2018, https://www.cipdr.gouv.fr/wp-content/uploads/2018/08/PNPR_English_final_sansmediakit.pdf.

- **Konferenca të rrjetit shoqëror, Austri:** Shërbimi i provës në Austri, Neustart, udhëheq përpjekjet për të ndihuar autorë të veprave që lidhen me terrorizmin nën moshën 21 vjeç të zhvillojnë një plan të detyrueshëm për të ardhmen e tyre pas lirit. Konferenca e rrjetit social përbëhet nga (1) një rrjet i profesionistëve përkatës; (2) rrjeti shoqëror/familjar i autorit; dhe (3) vetë autori. Autori i veprës/ave vendos se kush do të jetë pjesë e rrjetit shoqëror/familjar. Më pas, autorët e veprës/ave punojnë së bashku me rrjetin e tyre shoqëror dhe profesionistët përkatës për të krijuar një plan riintegrimi, i cili fokusohet në jetën e përditshme, punën, dhe strehimin. Plani i nisët pastaj gjyqtarit, që nxjerr urdhëra sipas planit. Oficeri i shërbimit të provës, nëpërmjet OJQ-së Neustart, mbikëqyr respektimin e urdhërave - për një periudhë dyjavore - dhe në këtë mënyrë zbatimin e planit.¹⁷¹
- **Qelizat lokale të sigurisë të integruara, Belgjikë:** Qelizat lokale të sigurisë të integruara (LISC) ekzistojnë në nivel province në të gjithë Belgjikën. Në mënyrë tipike ato përfshijnë oficerë të parandalimit dhe ofrues të tjerë përkatës të shërbimeve sociale në nivel lokal si dhe policinë lokale dhe prokurorin dhe përgjithësisht koordinohen nga zyra e kryetarit të bashkisë. Përveç punës me individë të identifikuar si “në rrezik” apo në rrugën drejt VERLT-it, disa herë LISC-të punojnë me raste të individëve që tashmë kanë qenë të radikalizuar. LISC-ja mund të diskutojë raste që i janë referuar nga një prej njësisë të posaçme lokale të fokusuar te siguria (LTF), të cilat janë ngritur në çdo bashki të vendit sipas strategjisë kundër terrorizmit 2005 në Belgjikë. LTF-të përfshijnë përfaqësues të nivelit vendor nga agjencitë ligjzbatuese, shërbimet e inteligjencës, dhe qendra e analizës së kërcënimit për terrorizëm, si dhe nga policia federale dhe lokale; objektivi është të mundësohet shkëmbimi i informacionit midis agjencive ligjzbatuese, të identifikohen individët e asociuar me terrorizmin ose ekstremizmin e dhunshëm (p.sh. “LHT” që kthehen) të cilët kërkojnë vëmendje me përparësi të lartë, dhe të përcaktohen ndërhyrjet e duhura. Ndërkohë që LTF-të janë të fokusuar te siguria, LISC-të kërkojnë të trajtojnë nevojat psikologjike dhe nevoja të tjera dhe vulnerabilitete të individit, përfshirë punën me anëtarët e familjes dhe një grupe të ndryshme të shoqërisë civile në nivel lokal. Për të lehtësuar bashkëveprimin, përfaqësuesi i LTF-së është i pranishëm në secilën LISC dhe të gjitha platformat lidhen me një njësi të posaçme kombëtare që siguron mbikëqyrje kombëtare, në përputhje me një qasje të integruar për sigurinë që përfshin të gjitha nivelet e qeverisjes në Belgjikë.¹⁷²
- **Qendra e Ekselencës për Deradikalizimin, Policia Kriminale Bavarisë, Gjermani:** Qendra e Ekselencës për Deradikalizimin përbëhet nga një skuadër prej 10 ekspertësh, përfshirë nga fusha si teologjia, politika, psikologjia, dhe sociologjia si dhe punonjës policie. Qendra bën vlerësime të rrezikut, nevojave

171 Shih “Social Net Conferencing”, https://ec.europa.eu/home-affairs/node/11694_en, në faqen e internetit të Komisionit Evropian për Migracionin dhe Çështjet e Brendshme .

172 Thomas Renard and Rik Coolsaet, eds., *Returnees: Who Are They, Why Are They (Not) Coming Back and How Should We Deal with Them? Assessing Policies of Returning Foreign Terrorist Fighters in Belgium, Germany, and The Netherlands*, Egmont Paper 101, Egmont Institute, Brussels, February 2018, pp. 35–37, http://www.egmontinstitute.be/content/uploads/2018/02/egmont.papers.101_online_v1-3.pdf?type=pdf.

dhe kërcënimeve të klientëve potencialë dhe ndihmon për identifikimin e ofruesve të shërbimeve për trajtimin e nevojave të identifikuar, duke mbikëqyrur realizimin e mbështetjes nga grupe të jashtme. Qendra punon me individë në proces radikalizimi si dhe me ata që duan të shkëputen nga VERLT-i, përfshirë ata që kthehen nga zonat e konfliktit.

Pas vlerësimit, Qendra harton një plan për administrimin e rrezikut për secilin individ, i cili më pas i jepet edhe oficerit përkatës të policisë lokale i caktuar për të punuar me Qendrën, që më pas mbikëqyr zbatimin e planit. Përgjithësisht, zyra u drejtohet OJF-ve dhe ofruesve të shërbimeve të duhur për t'u angazhuar drejtpërdrejt me individin. Punonjësit e vijës së parë raportojnë për ecurinë pranë Qendrës, e cila shqyrton rastet në takime të programuara, duke bërë rregullimet e përshtatjen në plan sipas nevojës.¹⁷³

- **Planveprimi për Administrimin e Rrezikut, Kanada:** Trupa mbi Kuaj e Policisë Mbretërore e Kanadasë (RCMP) ka përgatitur një qasje me shumë aktorë për të administruar rrezikun që vjen nga subjekte të hetimeve të sigurisë kombëtare, përfshirë “udhëtarët me rrezik të lartë” që kthehen nga zona e konfliktit në Siri dhe Irak, përfshirë gra dhe fëmijë. RCMP-ja kërkon të mbledhë sa më shumë informacion nga agjencitë ligjzbatuese dhe ato që nuk janë ligjzbatuese në mënyrë që të kryhet një vlerësim i rrezikut dhe i nevojave i përshtatur sipas rastit për çdo individ, të informohen apo të mbështeten strategjitë hetimore apo të zbatimit të ligjit, plani për masat alternative përkundrejt ndjekjes penale, dhe, sipas rastit, përdorimi i përpjekjeve R&R që përfshijnë ofrues joqeveritarë të shërbimeve. Vlerësimi i strukturuar shqyrton objektivin, treguesit e vëzhgueshëm dhe përpjekjet ri-integruese kërkojnë të trajtojnë faktorë individualë të rrezikut dhe vulnerabilitete që janë të përcaktuar si forca shtytëse të radikalizimit drejt VERLT-it.

Në lidhje me R&R-në, RCMP-ja ka hartuar një qasje standarde në nivel kombëtar, ndërkohë që mundëson edhe zbatimin e përshtatur me kontekstin dhe specifikat lokale. Personeli i policisë në nivel lokal, divizioni dhe kombëtar, së bashku me burime të tjera me bazë komuniteti, ofrojnë vlerë dhe mbështetje për hetimet duke dhënë ekspertizë për sa i përket rrugëtimi të individëve në radikalizimin drejt dhunës, ekstremizmit të dhunshëm, dhe vulnerabilitete që lidhen me to. Për shembull, RCMP-ja mund të vendosë të referojë një rast individual te një “tryezë për situatën” me përfaqësues nga shumë agjenci në bashkinë në të cilën individit do të (ri)integrohet, duke u mbështetur, në këtë mënyrë, në burimet, marrëdhëniet dhe ekspertizën që ekzistojnë në nivel lokal. Si alternativë, RCMP-ja mund të vendosë të ndjekë një qasje që përfshin sjelljen nga jashtë të një ekipi specialistësh që janë trajnuar për të punuar me këto lloj rastesh për t'u angazhuar me individin.¹⁷⁴

173 EU RAN, *Multi-Agency Working and Preventing Violent Extremism: Paper 2*, f. 12–13; dhe Milena Uhlmann, *Evaluation of the Advice Centre on Radicalisation, Final Report*, Research Report 31, German Federal Office for Migration and Refugees, Research Centre – Migration, Integration and Asylum, 2017, <https://www.bamf.de/SharedDocs/Anlagen/EN/Publikationen/Forschungsberichte/fb31-evaluation-beratungsstelle-radikalisierung.pdf?blob=publicationFile>.

174 Kontribut nga një zyrtar i lartë i RCMP-së në tryezën e rumbullakët të ekspertëve të OSBE-së maj 2019.



9. Ofruesit qeveritarë përballë ofruesve joqeveritarë

Sikurse është theksuar në të gjithë këtë udhëzues, po njihet gjithmonë e më shumë nevoja që si aktorët qeveritarë edhe ata joqeveritarë të kontribuojnë për përgatitjen dhe zbatimin e programeve R&R jashtë kontekstit të burgut. Sigurimi që OJF-të dhe aktorë të tjerë joqeveritarë të kenë hapësirën e nevojshme ligjore dhe të politikave si dhe kapacitetin për t'u angazhuar (Shih Seksioni 7.4), njohja e avantazheve krahasuese përkatëse të aktorëve qeveritarë dhe joqeveritarë, dhe identifikimi i qartë i ndarjes së duhur të punës midis tyre në çdo program, janë me rëndësi kritike për vënien në zbatim të kësaj qasjeje.

Përcaktimi se cili lloj aktori (dmth, qeveritar apo joqeveritar) është më i përshtatshëm për të realizuar një ndërhyrje të caktuar - një përcaktim që nevojitet të merret parasysh në kontekstin në rang vendi, qyteti dhe/ose komuniteti - mund të jetë i rëndësishëm sa për efektshmërinë edhe për përmbajtjen.¹⁷⁵

Për sa u takon avantazheve krahasuese, nëpunësit qeveritarë mund të jenë në pozita më komode se aktorët joqeveritarë që punojnë me një numër të madh individësh potencialisht të rrezikshëm, të cilët mund të përfshihen në e në programe R&R në kontekst jashtë burgut, pasi nëpunësit qeveritarë mund të kenë shumë më shumë informacion (përfshirë nëpërmjet përfshirjes së tyre në platforma me shumë agjenci për shkëmbimin e informacionit për raste specifike) në lidhje me rreziqet për sigurinë që paraqet individi dhe kanë qasje më të mirë në mbështetjen ligjzbatuese. Gjithashtu, mund të jenë më pak të shqetësuar se sa OJF-të në komunitet, për shembull, për rrezikun e mundshëm reputacional që mund të lindë si rrjedhojë e angazhimit të tyre me individë që kanë pasur një përfshirje të caktuar me terrorizmin apo VERLT-in. Për më tepër, ata mund të jenë në një pozitë më të volitshme për të harmonizuar ndërhyrjet e tyre me politika qeveritare (në veçanti aty ku aktorët joqeveritarë nuk janë përfshirë në

175 Këshilli i Evropës *Doracak*, paragrafët 151–54.

hartimin e këtyre politikave apo kur nuk kanë dijeni për to për publikun) dhe të jenë transparentë për punën e tyre nga sa janë aktorët joqeveritarë.¹⁷⁶

Megjithatë, si përfaqësues të shtetit, disa punonjës, në veçanti si pjesë e zbatimit të ligjit apo të lidhur me të apo aktorë të tjerë të sigurisë, mund të shihen si “armiku” nga individit dhe familja e tij apo saj si dhe komuniteti i gjerë, bashkëpunimi, mbështetja dhe angazhimi i të cilit do të jetë i rëndësishëm për suksesin e çdo nisme për shkëputje dhe ri-integrim.

Nga ana e tyre, OJF të tjera, në veçanti kur nuk janë të financuara nga qeveritë apo nuk kanë lidhje të tjera të ngushta me qeverinë, janë shpesh në një pozitë më të favorshme për të ndërtuar besimin më shpejt dhe më thellë me individin e synuar dhe më gjerë me komunitetin dhe kanë më shumë njohuri mbi pakënaqësitë dhe motivime të tjera që mund të jenë të përfshira. Po ashtu, OJF-të janë shpesh në pozita më të favorshme se sa homologët e tyre qeveritarë për t'u angazhuar me individët aty ku politikën apo veprimet e shtetit mund të jenë ndër faktorët kryesorë shtytës të VERLT-it. Po ashtu, OJF-të mund të kenë përvojë pune me banda, grupe urryesish, apo të rinj me probleme në komunitet të cilën ata mund ta shfrytëzojnë.

Në shumë kontekste, qeveritë janë fokusuar te detyrat më praktike, si dhënia e mbështetjes për strehim dhe trajnim për punë apo mbledhja së bashku e aktorëve të ndryshëm - përfshirë udhëheqës fetarë lokalë, ish ekstremistë, anëtarë të familjes, dhe autoritetet vendore - për të diskutuar mbi rastin specifik. Nga ana e tyre, OJF-të dhe partnerë të tjerë joqeveritarë të komunitetit kanë përdorur besueshmërinë e tyre dhe qasjen që kanë për t'u angazhuar me individët personalisht, një-me-një, për çështje që lidhen me ideologjinë, fenë apo ekstremizmin - tema ku mund të lindin ndjeshmëri ligjore apo kulturore ky angazhim do të udhëhiqej nga aktorë qeveritarë - ose nëpërmjet programeve sportive, kulturore apo artistike.¹⁷⁷ Këto të fundit shpesh janë udhëhequr nga organizata, misioni bazë i të cilave është të ndihmojnë individët të shkëputen nga VERLT ose forma të tjera të dhunës. Në një numër vendesh në rajonin e OSBE-së, programet EXIT dhe programe të tjera të ngjashme për mbështetjen e atyre që kërkojnë të largohen nga grupet ekstremiste të dhunshme fokusohen ngushtësisht te kjo punë.¹⁷⁸

176 Po aty. Shih edhe GCCT dhe ICCT, *It Takes a Village*.

177 Elena Souris and Spandan Singh, "Want to Deradicalize Terrorists? Treat Them Like Everyone Else," *Foreign Policy*, November 23, 2018, <https://foreignpolicy.com/2018/11/23/want-to-deradicalize-terrorists-treat-them-like-everyone-else-counterterrorism-deradicalization-france-sri-lanka-pontourny-cve/>.

178 Shih, për shembull, EXIT Suedi, EXIT Gjermani, dhe RADINET (Finland).



10. Ndërtim i i kapaciteteve

Pavarësisht nëse punohet me anë të një qasjeje të formalizuar me shumë aktorë apo jo, përpjekjet R&R jashtë kontekstit të burgut - ashtu si shumë aspekte të tjera të P/CVERLT-it - tipikisht kërkojnë përfshirjen e institucioneve, agjencive dhe organizatave të ndryshme, si dhe një sërë profesionistësh dhe praktikuesish. Vendet në rajonin e OSBE-së që kanë hartuar programe R&R janë mbështetur, tipikisht, në një masë të madhe të strukturat institucionale dhe kapacitetet profesionale ekzistuese, të cilat nuk janë të fokusuara në mënyrë specifike të çështjet VERLT. Kjo mund të jetë një qasje e efektshme kur burimet e dedikuara për programet R&R jashtë kontekstit të burgut janë të kufizuara. Institutet përkatëse përfshijnë policinë, burgjet, shërbimin e provës, shëndetin mendor, mirëqenien sociale, arsimin dhe agjenci të tjera qeveritare përkatëse, si dhe OJQ me bazë komunitare dhe OJQ të tjera të përfshira në këtë çështje apo të tjera që lidhen me të.

Në disa raste, një segment i gjerë i personelit të një apo më shumë prej këtyre institucioneve ka marrë trajnim të përgjithshëm ndërgjegjësues mbi radikalizimin në dhunë dhe VERLT para angazhimit në punën R&R; gjithashtu, një grup i vogël individësh që punojnë në raste specifike mund të kenë marrë njohuri, udhëzime dhe trajnim specifik për VERLT-in. Ky lloj i fundit i mbështetjes mund të përfshijë trajnimin për mënyrën e vlerësimit të rrezikut apo të nevojave të atyre që mund të kenë pasur kontakt me terrorizmin ose VERLT-in, mënyrën e angazhimit në bashkëpunim midis shumë agjencive apo aktorëve për raste specifike, dhe mënyrën për të nisur dhe për t'u angazhuar në biseda të vështira që mund të lehtësojnë shkëputjen nga VERLT-i.¹⁷⁹

Gjithsesi, shumë vende në rajonin e OSBE-së, janë përballur me sfida për kapacitetet institucionale dhe kufizime të burimeve, në veçanti në sektorët e burgjeve, shërbimit të provës, dhe të shëndetit mendor; ata kanë gjithashtu

179 Shih, për shembull, Këshilli i Evropës *Doracak*, paragrafi 175. Një numër grupesh pune të RAN-it të BE-së ofrojnë udhëzime dhe trajnim të punonjësve të linjës së parë në sektorë të ndryshëm - si dhe në konceptin e bashkëpunimit të shumë aktorëve - përfshirja aktive dhe mbi bazë informacioni e të cilëve në përpjekjet R&R në kontekst jashtë burgut ka rëndësi kritike në aftësinë e tyre për të vlerësuar rrezikun dhe nevojat e individëve në fjalë (dhe shpesh edhe për familjet) dhe hartojnë dhe realizojnë ndërhyrje të përshtatura sipas rastit për të lehtësuar risocializimin e tyre në komunitet. Grupet e punës të RAN-it përfshijnë ato që fokusohen te të rinjtë, familjet dhe komunitetet; autoritetet lokale; burgjet dhe shërbimi i provës; programet EXIT; dhe kujdesi shëndetësor dhe ai social. Shih, Komisioni Evropian, Migracioni dhe Çështjet e Brendshme, "RAN Working Groups", https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran_en.

ekspertizë të kufizuar specifike për VERLT të llojit që nevojitet për të trajtuar çështjet komplekse dhe të ndjeshme që VEO-t e liruar dhe “LHT”-të që kthehen dhe anëtarët e familjeve të tyre mund të paraqesin.¹⁸⁰ Për këtë arsye, **hartimi dhe zbatimi i nismave R&R jashtë kontekstit të burgut në disa vende do të kërkojë investim si në trajnim të specializuar edhe në instrumente dhe më gjërë në forcimin e kapaciteteve themelore institucionale.**

10.1 Shërbimet dhe punonjësit në burgje dhe shërbimin e provës

Duke pasur parasysh lidhjet midis punës R&R në kontekstin e burgut dhe jashtë tij, qeveritë duhet të sigurojnë jo vetëm që kushtet e burgut të jenë njerëzore dhe në to të ketë personel të trajnuar mirë, por edhe që shërbimet e korrektimit të kenë kapacitete për të realizuar ndërhyrje të ndryshme të specializuara në mënyrë që një autor i veprave që lidhen me terrorizmin të fillojë procesin R&R ndërkohë që është në burg. Megjithatë, burgjet në një numër vendesh në rajonin e OSBE-së, përfshirë Evropën Juglindore, vuajnë nga mbipopullimi dhe numri i kufizuar i personelit të specializuar, duke e bërë angazhimin ballë për ballë pothuaj të pamundur. Progresi i qëndrueshëm për trajtimin e mangësive në kapacitetet R&R do të jetë i vështirë që të arrihet nëse nuk i kushtohet më shumë vëmendje kufizimeve të kapaciteteve në një bazë më të gjerë, në veçanti duke pasur parasysh se një mjedis burgu profesional, i sigurt dhe i drejtë është identifikuar me rëndësi kritike si për reduktimin e rrezikut që një i burgosur të radikalizohet në dhunë edhe për rritjen e gjasave që procesi i shkëputjes të fillojë ndërkohë që individit është ende i burgosur.

Po ashtu, shërbimet e provës, aty ku ekzistojnë, shpesh nuk marrin fonde të mjaftueshme, edhe pse ato tashmë po bëhen një aktor gjithmonë e më i rëndësishëm në fushën e P/CVERLT-it, në veçanti në lidhje me mbikëqyrjen dhe realizimin e ndërhyrjeve R&R.

Përveç përparësive në forcimin e shërbimit të provës në një kuptim më të gjerë, qeveritë do të duhet të kërkojnë njohuri të thelluara të punonjësve të këtij shërbimi mbi VERLT-in, përfshirë ndërgjegjësim për motivimet dhe pakënaqësitë që mund të nxisin individët drejt VERLT-it dhe trajtimin për shkëputjen prej tij, dhe të rolit që mund të luajnë shërbimet e provës në procesin R&R. Gjithashtu, me gjasë do të kenë nevojë për mbështetje për të ndihmuar në administrimin e vështirësive të jashtëzakonshme emocionale dhe vështirësive të tjera që mund të lindin gjatë punës me autorë të veprave që lidhen me terrorizmin pas lirimit të tyre, duke pasur parasysh një vëmendje më të lartë nga media dhe publiku që mund të shoqërojnë punën e tyre.¹⁸¹

180 Shih, për shembull, Shtuni, “Western Balkans Foreign Fighters”, pp. 20–25; Azinovic, Regional Report, f. 11–12; dhe RCC, *Waiting Game*, f. 21–28.

181 RAN P&P Practitioners’ Working Paper, 2019.

Fatmirësisht, po hartohen gjithmonë e më shumë udhëzues, instrumente dhe programe që fokusohen te ndërtimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit të provës për të kontribuar në përpjekjet R&R P/CVERLT.¹⁸²

10.2 Punonjësit dhe këshilluesit e kujdesit psikologjik dhe shëndetësor

Nisur nga fakti se kujdesi psikologjik është shpesh në thell të proceseve R&R dhe të risocializimit, është me rëndësi kritike që të sigurohen kapacitetet dhe ekspertiza psikologjike në mënyrë që këto përpjekjet të jenë të efektshme dhe të qëndrueshme.

Brenda sektorit të shëndetit publik, kapacitetet mund të ndryshojnë ndjeshëm nga një vend në tjetrin. Në disa vende, për shembull, shërbimet komunitare të shëndetit mendor plotësojnë punën e bërë në spitale dhe klinika private nga psikiatritë, ndërkohë që në vende të tjera këto shërbime ose janë të kufizuara ose nuk ekzistojnë fare.¹⁸³ Në vende të tilla, nevojitet një investim madhor për të bërë të mundur që personat, në nevojë për mbështetje komunitare të shëndetit mendor, ta marrin atë.¹⁸⁴ Në disa vende, **profesionistët e shëndetit mendor mund të kenë nevojë për trajnim mbi mënyrën e realizimit të ndërhyrjeve për traumat, apo për të dhënë trajtim të bazuar në evidencë** duke ndjekur një vlerësim të strukturuar të rrezikut dhe të nevojave **si dhe për mënyrën se si të punojnë në një mjedis me shumë aktorë**, të tillë si pjesëtarët e familjes, udhëheqësit fetarë, apo ekspertët kulturorë, me qëllim që të kuptohet më mirë konteksti i individit.

Punonjësit e shëndetit mendor dhe aspekteve të tjera të shëndetit si dhe punonjësit socialë tipikisht janë mësuar të vendosin si prioritet mbështetjen dhe mirëqenien e klientit; ata kanë më pak përvojë për të punuar me aktorë të tjerë si policia që më së pari merren me zbutjen e rrezikut dhe janë më pak të vëmendshëm ndaj nevojave apo vulnerabiliteteve të individit i cili mund të paraqesë një rrezik.¹⁸⁵ më tej, këta punonjës mund të mos jenë të njohur me

182 Shih, për shembull, "UNODC and Partners Strengthen Capacity of Prison and Probation Staff to Manage Violent Extremist Offenders in Kyrgyzstan," prill 2019, në faqen e internetit të UNODC, <https://www.unodc.org/centralasia/en/news/unodc-and-partners-strengthen-capacity-of-prison-and-probation-staff-to-manage-violent-extremist-offenders-in-kyrgyzstan.html>; Raluca Ivan and Donche Boshkovski, "Deradicalisation in Prisons Projects in Western Balkans," 27 korrik 2018, në faqen e internetit të Këshillit të Evropës, https://www.era-comm.eu/radicalisation/kiosk/pdf/seminar_4/318DT65_8_Boshkovski_Ivan.pdf; Council of Europe *Handbook: the Integrated Community, Probation and Prison Services Radicalization Prevention Approach (INTEGRA)*, <http://www.integra-project.org/>; and Denmark's Train-the-Trainer Awareness Training and Resources Persons, https://ec.europa.eu/home-affairs/content/train-trainer-awareness-training-and-resource-persons_en.

183 OSCE, *Understanding Referral Mechanisms*, f. 52.

184 Ndonëse zgjerimi i kapaciteteve për shëndetin mendor me bazë në komunitet kërkon kohë dhe burime, si dhe angazhim nga Ministria e Shëndetësisë (apo një ministri e barasvlershme), mund të ndërmerrin disa hapa ndërkohë për të zhvilluar kapacitetet e nevojshme të shëndetit mendor për mbështetjen e punës R&R me shumë aktorë. Këto hapa përfshijnë (1) krijimin e njësite të lëvizshme që mund të veprojnë në disa bashki të ndryshme apo në një rajon apo në një vend dhe kjo njësi të trajnohet për P/CVERLT dhe të mentorohet për të punuar me pacientë ditore në bazë komuniteti; dhe (2) ndërtimi i një rrjeti profesionistësh të shëndetit mendor në një rajon apo në një vend për të ndihmuar për identifikimin e vulnerabiliteteve dhe nevojave përkatëse të shëndetit mendor të atyre që mund të jenë përfutues të programeve R&R dhe të përgatishin dhe të realizojnë ndërhyrje të informuara për traumat, sipas rastit. Shih, OSCE, *Understanding Referral Mechanisms*, f. 52.

185 EU RAN, *Multi-Agency Working and Preventing Violent Extremism: Paper 2*.

me terminologji dhe koncepte rreth VERLT-it dhe R&R-së dhe mund të mos kenë ekspertizën e nevojshme për të punuar në bashkëpunim me aktorë të tjerë si mësues dhe komunitete. **Në veçanti për ata punonjës të kujdesit shëndetësor dhe social, që nuk kanë përvojë në kontekstin e policisë shkencore dhe korrektimit, mund të jetë i dobishëm trajnimi për mënyrën se si të kontribuojnë në një nismë me shumë aktorë që kërkon shkëmbimin e informacionit dhe një bashkëpunim më të gjerë midis profesionistëve nga disiplina të ndryshme, me përparësi dhe kultura të ndryshme.**¹⁸⁶Për më tepër, shumë punonjës të kujdesit shëndetësor dhe social (së bashku me praktikuesit e vijës së parë) mund të kenë nevojë për orientim se si të kapërcejnë pengesat që mund të krijohen nga të punuarit me individë që etiketohen si “terroristë”.

Punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe social, në mënyrë tipike, ofrojnë mbështetje kur u kërkohet një gjë e tillë nga individi; përgjithësisht, ata nuk iniciojnë të parët një kontakt me një klient potencial apo me familjen e tij/saj. Megjithatë, në një numër rastesh R&R në kontekst jashtë burgut, përfshirë ato për “LHT” që kthehen në komunitetet e tyre pa kaluar nëpër sistemin e drejtësisë penale apo anëtarët e familjeve të tyre, punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe social mund të nevojitet të vendosin një kontakt të parë me klientin potencial dhe familjen e tij/saj për të nxitur pjesëmarrjen në një program vullnetar R&R. Në varësi të natyrës së rastit, ky kontakt mund të iniciohet në disa raste vetëm ose së bashku me policinë lokale. Për më tepër, siç u aludua më lart, këta punonjës nuk janë të trajnuar, tipikisht, për t’u angazhuar apo nuk janë mësuar të angazhohen me klientë që janë “të rrezikshëm” për sa i takon rrezikut për sigurinë. Prandaj, mund të jetë i nevojshëm një orientim në këtë fushë.

Grupi i Punës i RAN për Kujdesin Shëndetësor dhe Social ka zhvilluar një numër instrumentesh për të lehtësuar përfshirjen e këtyre punonjësve në P/CVERLT, përfshirë punën R&R, si në rastin e qeverive në Finlandë, Suedi dhe Mbretërinë e Bashkuar.¹⁸⁷ Ndoshta me më shumë ambicie, Zyra Federale në Gjermani për Migracionin dhe Regugjatët po financon hartimin e një kursi gjithëpërfshirës trajnimi të fokusuar te puna këshilluese R&R. Kjo vjen si përgjigje ndaj tre faktorëve: kërkesa e shtuar në të gjithë Gjermaninë për përfshirjen e ofruesve të

186 Ata me përvojë në fushën e policisë shkencore shpesh kanë njohuri të specializuar, trajnim dhe përvojë në parandalimin, trajnimin dhe menaxhimin e sjelljes në kundërshtim me ligjin (përfshirë mbështetjen R&R) dhe në punën e efektshme me autorët e veprave penale, përfshirë ata që mund të jenë përfshirë në terrorizëm apo ekstremizëm të dhunshëm. Prandaj, këta aktorë me njohuri nga “policia shkencore” mund të sjellin përfitime të dallueshme për përpjekjet P/CVERLT, përfshirë integrimin e përparësive dhe shqetësimeve të drejtësisë penale me ato përparësi dhe shqetësime që lidhen me agjencitë e kujdesit shëndetësor dhe të mirqenies. Këta aktorë mund të ndihmojnë aktorë të tjerë (të tillë si psikologët klinikë apo punonjësit socialë) që të kapërcejnë disa prej sfidave dhe konflikteve të rolit të tyre profesional të identifikuar në këtë seksion. Së fundi, dhe për këto arsye, praktikuesit e policisë shkencore kanë luajtur një rol qendror në disa juridiksione, si në Mbretërinë e Bashkuar, për përgatitjen e qasjeve për vlerësimin dhe ndërhyrjet P/CVERLT.

187 Shih, për shembull, Tarja Mankinen, *Proposal for Arranging Cross-sectoral Cooperation on Managing Returnees from Conflict Zones Including a Proposal for Combining NGOs' Services with the Action of the Authorities*, prill 2017, Ministria e Brendshme, <http://julkaisut.valtioneuvosto.fi/handle/10024/79612>; “Actions to Make Society More Resilient to Violent Extremism”, Swedish Government Communication 2014/15:144, 13 gusht 2015, <https://www.government.se/contentassets/ef243295e51d4635b4870963b18bfa89/actions-to-make-societymore-resilient-to-violent-extremism-2014-15-144.pdf>; Hertfordshire Safeguarding Children Partnership (HSCP), “The Role of the Social Worker in Tackling Violent Extremism”, f. 5. http://hertsscb.proceduresonline.com/pdfs/role_sw_violent_extreme.pdf.

parandalimit tretësor në një fokus specifik të këshillimi familjar; kompleksiteti në rritje të rasteve R&R; dhe mungesa e standardeve apo trajnimeve për të orientuar angazhimin e punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe social në këto raste.¹⁸⁸ Kursi, i cili do të fokusohet në një larmi temash, do të përfshijë si elementin teorik edhe atë praktik. Të gjithë ata që dëshirojnë të përfshihen në punën R&R në partneritet me qeverinë do të duhet ta përfundojnë këtë trajnim (dhe të plotësojnë kërkesën për 220 orë) me qëllim që të ndihmojnë për më shumë konsistencë në realizimin e ndërhyrjeve të parandalimit tretësor të lidhur me këshillimin.

Përtej instrumenteve specifike që janë hartuar, mund të jetë e nevojshme një mbështetje në kohë reale për punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe socialë (dhe aktorë të tjerë që nuk janë ligjzbatues) për trajtimin e rasteve specifike, siç jepet nga Qendra VINK (Njohuri-Integrim-Kopenhagë) në Kopenhagë. Qendra VINK u jep mësuesve (të cilët mund të kenë nevojë për trajnim për mënyrën se si të lehtësojnë përpjekjet ri-integruese në klasat e tyre ndërsa njohin sjellje të rrezikshme), punonjësit socialë, dhe punonjës të tjerë të bashkisë që janë në kontakt me individët që janë më vulnerabël ndaj VERLT-it apo ata që mund të jenë radikalizuara tashmë me trajnim dhe këshillë - përfshirë me anë të telefonit - se si të trajtojnë raste specifike në mënyrë të efektshme.¹⁸⁹

Përveç trajtimit të mangësive të kapaciteteve më gjerë në sektorin e mbështetjes psikologjike, duhet të ndërmerren hapa për të reduktuar barrierat kulturore për të kërkuar ndihmë profesionale nga profesionistë të shëndetit mendor (PSHM) çka vijon të mbeten prezente në disa shoqëri dhe komunitete. Këto barrierat krijohen nga një sërë faktorësh. Si fillim, në shumë kultura sëmundja mendore mbetet e stigmatizuar. Gjithashtu, disa individë dhe familje mund të mos e kuptojnë gamën e çështjeve, përfshirë ankthin, traumën dhe depresionin që mund të trajtojnë PSHM-të dhe se si mund t'i ndihmojnë ata vetë apo një familjar. Ata mund të mos jenë të vetëdijshëm për shumë faktorë që mund të kontribuojnë për interesimin dhe përfshirjen në ekstremizëm të dhunshëm që lidhen me çështje psikologjike (p.sh. pështjellim identiteti, nevojë për përkatësi) që nuk lidhen domosdoshmërisht me një një sëmundje mendore të diagnostifikueshme, në vetvete, por janë çështje që PSHM-të dhe ofrues të tjerë të kujdesit psikologjik mund të trajtojnë. Gjithsesi, një faktor tjetër është frika që ndiejnë disa prindër se do t'ua "marrin" fëmijën shërbimet e mbrojtjes së fëmijës nëse ata përdorin shërbimet e shëndetit mendor.¹⁹¹

Kur merret në konsideratë përgatitja e instrumenteve programeve apo ekspertizës së specializuar për përdorim në raste R&R (dhe ndoshta ndërhyrje P/CVERLT) - dhe për të forcuar qëndrueshmërinë dhe për të maksimizuar përdorimin e mbështetjes publike për këto investime - qeveritë duhet të marrin

188 Këto ishin disa prej gjetjeve në një vlerësim të kohëve të fundit nga Advice Center on Radicalisation [Qendra Këshillimore për Radikalizimin] në Gjermani. Shih Uhlmann, *Evaluation of the Advice Centre on Radicalisation*.

189 Bashkia Kopenhagë, "Less Radicalisation through an Effective and Coherent Effort: Recommendations of the Expert Group to Prevent Radicalisation", August 2015, <https://www.kk.dk/sites/default/files/uploaded/files/Abridged%20version.%20Less%20radicalisation%20through%20an%20effective%20and%20coherent%20effort..pdf>.

190 OSBE, *Understanding Referral Mechanisms*.

në konsideratë se si mund të shfrytëzohen në kontekstin jo-VERLT (p.sh. forma të tjera të krimeve të dhunshme apo krimet e urrejtjes).¹⁹¹

10.3 Shoqëria civile

OJF-të dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në përpjekjet R&R jashtë kontekstit të burgut; megjithatë, ato duhet të pajisen me aftësitë, njohuritë dhe burimet përkatëse për të maksimizuar kontributet e tyre. Për shembull, mentorët apo këshilluesit fetarë të përfshirë në përpjekjet për shkëputje mund të përfitojnë nga trajnime specifike para përfshirjes në ndërhyrje R&R. Ata mund të kërkojnë trajnim për kalimin nga një rol tradicional pastoral prej kujdestari shpirtëror në një rol që përfshin debat të hapur, kritik e që nuk i përmbahet hierarkisë, si dhe trajnim bazë në sferën e punës sociale dhe psikologjisë. Gjithashtu, nevojitet të kenë njohuri të mjaftueshme të organizatave terroriste përkatëse apo të ideologjive ekstremiste të dhunshme.

Duke e parë shoqërinë civile nga një këndvështrim më i gjerë, Seksioni 7.4 vuri në pah disa prej kapaciteteve, burimeve dhe sfidave të tjera që mund të pengojnë përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile në punën R&R jashtë kontekstit të burgut dhe që duhet të trajtohen me qëllim maksimizimin e avantazhit krahasues domethënës në këtë fushë. Qeveritë duhet të bëjnë më shumë për të lehtësuar këtë angazhim, përfshirë duke krijuar kushtet e domosdoshme ligjore, politike dhe të sigurisë. Si hap i parë, qeveritë duhet të njohin në mënyrë të qartë në strategjitë, kornizat dhe planveprimet kombëtare rolin e OJF-ve dhe të shoqërisë civile në një këndvështrim më të gjerë në të gjithë spektrin e çështjeve P/CVERLT, përfshi R&R në kontekst jashtë burgut.

Mund të ndërmerren një numër hapash të tjerë më specifike për të thelluar përfshirjen e shoqërisë civile në këtë punë, të cilat u renditën në një raport të kohëve të fundit mbi rolin e shoqërisë civile në R&R të atyre që janë shoqëruar apo janë ndikuar nga ekstremizmi i dhunshëm. Këta hapa përfshijnë:

1. Ndërtimin e kapaciteteve organizative të OJF-ve në lidhje me menaxhimin e projekteve, administrimin financiar dhe monitorimin dhe vlerësimin;
2. Lehtësimin e shkëmbimit të njohurive midis vetë OJF-ve si dhe midis OJF-ve dhe praktikuesve dhe profesionistëve të tjerë për P/CVERLT-in, përfshirë, për shembull, zhvillimin e një rrjeti të duhur në nivel kombëtar;
3. Trajnim për strategjitë e komunikimit dhe fushatave si dhe për aftësi për disiplina të ndryshme;
4. Mbështetje për të vënë në zbatim ekspertizën ekzistuese nga fusha përkatëse si ndërtimi i paqes, zgjidhja e konflikteve, fuqizimi në bazë gjinore dhe i të rinjve, dhe

191 Jackson et al., *U.S. National Approaches* f. 202.

- Edukim për punën R&R, duke i ndihmuar OJF-të hedhin poshtë pretendimet se OJF-të thjesht sa u rivendosin një emër të ri punës së tyre që nuk ka lidhje me P/CVERLT-in me qëllim që të marrin fonde për P/CVERLT; dhe
5. Angazhim më konstruktiv me OJF-të dhe komunitetet, që mund të përfshijë “dhënien e mbështetjes për një proces angazhimi shoqëri civile - qeveri, veçanërisht në rajone ku ka një nivel të ulët bashkëpunimi.”¹⁹²

Autorët e studimit vënë në dukje se “angazhimet pozitive me qeveritë pritëse mund të ndihmojnë për sigurimin e një mjedisi të sigurt pune për anëtarët e shoqërisë civile dhe për ndërtimin e lidhjeve më të forta midis qeverive dhe komuniteteve lokale, OJF-ve dhe aktorëve ndërkombëtarë. Këto angazhime mund të forcojnë, nga ana e tyre, shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave midis aktorëve të ndryshim, duke ndihmuar për ndërhyrje më të efektshme dhe të targetuara.”

192 GCCT and ICCT, *It Takes a Village*, f. 34. Shih edhe, GSX, “10 Steps”.



11. Kategori të veçanta të individëve: trajtimi i sfidave unike dhe nevojave të grave dhe fëmijëve

Një numër gjithnjë e më i madh i organizatave ndërkombëtare dhe rajonale, përfshirë Kombet e Bashkuara, OSBE-ja, GCTF-ja, dhe Bashkimi Evropian, kanë theksuar rëndësinë e sigurimit që strategjitë dhe programet R&R, përfshirë ato që zbatohen jashtë kontekstit të burgut, të marrin në konsideratë ndjeshmëritë gjinore dhe të moshës.¹⁹³ Për shembull, Rezoluta 2396 e Këshillit të Sigurisë të OKB-së, e thekson këtë pikë, duke njohur se gratë dhe fëmijët “mund të kenë shërbyer në role të ndryshme, përfshirë si mbështetës, lehtësues apo realizues të veprave që lidhen me terrorizmin dhe kërkojnë fokus të veçantë kur përgatiten strategji të përshtatura sipas rastit për ndjekjen penale, rehabilitimin, dhe riintegrimin.”¹⁹⁴ Këshilli i Sigurisë nënvizoi rëndësinë e realizimit të vlerësimeve

193 Kjo përfshin 197 fëmijë që u kthyen apo i rivendosën në vendet e Evropës Juglindore para viti 2018, ku dhjetëra të tjerë kanë ndjekur të njëjtën gjë që prej asaj kohe. Shih, për shembull, Azinovic, Regional Report; and Valerie Plesch and Serbeze Haxhiaj, “Kosovo Is Trying to Reintegrate ISIL Returnees. Will It Work?”, *Al Jazeera*, 9 June 2019, <https://www.aljazeera.com/indepth/features/kosovo-reintegrate-isil-returnees-work-190608200858002.html>. Disa kanë udhëtuar në zona konfliktive me zgjedhjen e tyre; të tjerë janë marrë me vete atje nga njëri apo të dy prindërit; dhe të tjerë akoma u lindën atje nga prindër shtetas të vendeve në rajonin e OSBE-së.

të rreziqeve dhe nevojave të tyre individuale - duke marrë parasysh si gjininë dhe moshën - për të siguruar që gratë dhe fëmijët e shoqëruar me "LHT"-të, si viktimat të mundshme të terrorizmit, të marrin asistencën e nevojshme.

Kjo vëmendje motivohet nga një numër faktorësh, përfshirë numrin e lartë të grave dhe fëmijëve që udhëtuan në zonën e konfliktit në Irak dhe Siri, njohjen gjithmonë e më të madhe të dinamikave komplekse që shoqërojnë përfshirjen e tyre me terrorizmin dhe VERLT-in, si dhe sfidat dhe nevojat unike që mund të paraqesin pas kthimit.¹⁹⁵ Sipas një mjeku koordinator për shëndetin dhe shëndetin mendor në kuadrin e një programi kombëtar për gratë dhe fëmijët në shtëpitë e tyre, "Që prej sesioneve të fillimit të psikoterapisë që kemi realizuar me fëmijët dhe me gratë [që kthehen nga konflikti në Irak dhe Siri], padyshim që mund të shohësh qartë shenja të PTSD-së."¹⁹⁶

11.1 Gratë

Studime të shumta kanë theksuar qasjet gjinore të rekrutimit dhe radikalizimit në dhunë ekstremiste dhe terrorizëm dhe, për rrjedhojë, përgjigjet e ofruara kan ndjekur të njëjtën qasje gjinore në hartimin dhe zbatimin e programeve R&R jashtë kontekstit të burgut.¹⁹⁷ Siç u vu në dukje më lart, integrimi i dimensionit gjinor në përpjekjet R&R (dhe më gjerë të P/CVERLT) jashtë kontekstit të burgut është në përpunje me rezoluta të shumta të kohëve të fundit të Këshillit të Sigurimit dhe rekomandimet e RAN-it, dhe inkurajohet si një praktikë e mirë nga GCTF-ja.¹⁹⁸

194 Rezoluta 2396 e Këshillit të Sigurisë të OKB-së (2017), para.31.

195 Shih, për shembull, Komisioni Evropian *High-Level Commission Expert Group on Radicalisation (HLCEG-R), Final Report*, 18 maj 2018, f. 8, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-security/20180613_final-report-radicalisation.pdf.

196 Plesch and Haxhiaj, "Kosovo Is Trying to Reintegrate ISIL Returnees".

197 Shih, për shembull, Joana Cook and Gina Vale, *From Daesh to 'Diaspora' II: The Challenges Posed by Women and Minors After the Fall of the Caliphate*, International Centre for the Study on Radicalisation, July 2019, p. 16, <https://icsr.info/wp-content/uploads/2019/07/ICSR-Feature-From-Daesh-to-%E2%80%98Diaspora%E2%80%99-II-The-Challenges-Posed-by-Women-and-Minors-After-the-Fall-of-the-Caliphate.pdf>; and Naureen Choudhury Fink, Sara Zeiger, and Rafia Bulai, *A Man's World: Exploring the Roles of Women in Countering Terrorism and Violent Extremism*, Hedayah and Global Center on Cooperative Security, April 2016, http://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2016/07/AMansWorld_FULLL.pdf. Për një diskutim mbi dinamikat gjinore dhe rolin e grave në VERLT dhe P/CVERLT, shih për shembull Irene Ndung'u and Mothepa Shadung, *Can a Gendered Approach Improve Responses to Violent Extremism?*, Institute for Security Studies, shtator 2017, <https://issafrika.s3.amazonaws.com/site/uploads/aitwr-5.pdf>; Iffat Idris me Ayat Abdelaziz, *Women and Violent Extremism: Helpdesk Research Report*, GSDRC Help Desk Research Report, 2017, http://www.gsdrc.org/wp-content/uploads/2017/05/HDR_1408.pdf; Emily Winterbotham dhe Elizabeth Pearson, "Different Cities, Shared Stories: A Five-Country Study Challenging Assumptions around Muslim Women and CVE Interventions", *RUSI Journal*, 30 November 2016, <https://rusi.org/publication/rusi-journal/different-cities-shared-stories-five-country-study-challenging-assumptions>.

198 Shih, për shembull, Rezoluta 2396 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (2017); GCTF, *Returning Families Good Practices; dhe RAN Returnee Manual*.

Ai pasqyrohet gjithashtu në angazhimet e OSBE-së, ku deklarata ministeriale e OSBE-së për VERLT-in, në 2015, u bën thirrje Shteteve pjesëmarrëse që, *ndër të tjera*, të marrin parasysh një këndvështrim gjinor në përpjekjet e tyre në kundërvënien ndaj terrorizmit dhe parandalimin dhe kundërvënien ndaj VERLT-ti, si dhe në rekomadimet përkatëse të udhëzimeve të OSBE/ODIHR-it për trajtimin e sfidave që paraqiten nga “LHT”-të brenda kuadrit të të drejtave të njeriut.¹⁹⁹

Megjithatë, pavarësisht nga kjo rritje e të kuptuarit dhe mbështetjes politike në nivel ndërkombëtar dhe rajonal, një studim i kohëve të fundit nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara dhe Rrjeti Ndërkombëtar për Veprim të Shoqërisë Civile ka gjetur se “politikat dhe programet aktuale [R&R] priren ose t’i shpërfillin gratë dhe vajzat që kanë pasur lidhje me grupe të ekstremizmit të dhunshëm, ose ta bëjnë çështjen më të thjeshtë se ç’është.”²⁰⁰ Për shembull, studimi theksoi se gratë dhe vajzat shpesh shihen “në terma të dyfishta, si viktima apo autore të dhunës” pavarësisht nga sa dihet për kompleksitetin e përfshirjes së tyre dhe nga çfarë nevojitet për të mundur shkëputjen e tyre nga dhuna dhe riintegrimin në komunitetet e tyre.²⁰¹ Realiteti është se ka pasur një ndërthurje faktorësh që ka nxitur vendimin e tyre për t’u asociuar me terrorizëm apo VERLT. Kjo mund të përfshijë “shtrëngimin, mobilizimin (co-option), skllavërimin ose marrjen peng, apo nënshtrimin në komunitetet e tyre dhe aspiratat e papërmbushura për përkatësi, qëllim, aventurë dhe fuqizim.”²⁰²

Pavarësisht nga nuancat - dhe rreziqet e sigurisë që gratë që kthehen (ashtu si burrat) mund të paraqesin - pjesa më e madhe e vendeve pritëse i shohin gratë që kthehen kryesisht si viktima, “bazuar në presupozime (shpesh të pavërteta) për aftësitë e tyre të limituara”, sipas një raporti nga Kombet e Bashkuara.²⁰³ Për këtë arsye, pjesa më e madhe e grave trajtohen jashtë sistemit të drejtësisë penale. Ky raport i Kombeve të Bashkuara vuri në dukje, gjithashtu, se gratë “priren të marrin mbështetje më të kufizuar për rehabilitim dhe ri-integrim, duke i vendosur ato, në këtë mënyrë, në një rrezik më të madh potencial për recidivizëm dhe riradikalizim dhe duke e dëmtuar potencialisht riintegrimin e suksesshëm të tyre në shoqëri.”²⁰⁴

199 OSBE, “Ministerial Declaration on Preventing and Countering Violent Extremism”, Paragrafi 13; dhe OSCE/ODIHR, *FTF Guidelines*.

200 *Invisible Women*, f. 12.

201 Për shembull, në prill 2019, të 32 gratë që ishin pjesë e 110 të kthyerve në Kosovë u trajtuan si të dyshuara dhe u vendosën nën arrest shtëpie. Elberta Begisholli, “Kosovo Detains More Returnees from Syrian Battlefields,” *Balkan Insight*, 24 April 2019, <https://balkaninsight.com/2019/04/24/kosovo-detains-more-returnees-from-syrian-battlefields/>

202 Po aty.

203 UNCTED, *Gender Dimensions of the Response to Returning Foreign Terrorist Fighters: Research Perspectives*, CTED Trends Report, February 2019, https://www.un.org/sc/ctc/wp-content/uploads/2019/02/Feb_2019_CTED_Trends_Report.pdf.

204 Po aty.

Ndër të tjera, hendeku i mësipërm nënvizon rëndësinë e vendosjes së një fokusi dhe vëmendjeje më të madhe në zhvillimin e programeve R&R jashtë kontekstit të burgut për gratë (dhe vajzat), ku të pasqyrohen ndjeshmëritë gjinore, përfshirë në to vlerësimin e rrezikut dhe nevojave dhe hartimin dhe realizimin e ndërhyrjeve.

Shpesh ka një numër dinamikash gjinore që institucionet dhe personat e përfshirë në hartimin dhe zbatimin e këtyre programeve duhet t'i marrin parasysh. Për shembull, ato që kanë qenë viktime të dhunës seksuale përballen edhe me këtë stigmë shtesë nga ana e komuniteteve të tyre dhe kanë kërkesa të dallueshme për mbështetje psikologjike dhe shëndetësore. Shpesh kanë fëmijë, që mund të kenë lindur nga një martesë e detyruar dhe/ose përdhunim. Gratë që kthehen mund të kenë vuajtur edhe pasoja ekonomike, pasi u është dashur të marrin mbi vete barrën e drejtimit të familjes pas vdekjes së bashkëshortit në fushëbetejë. Ndonëse disa gra mund të rikthehen shumë të radikalizuara dhe të mbahen pas ideologjisë ISIL-Da'esh, të tjera kthehen të zhgënjyera dhe me dëshirën e madhe për t'u ri-integruar në jetën normale dhe të rrisin fëmijët. Gratë mund të përballen me pengesa unike për R&R të tilla si norma të shoqërisë apo komunitetit që kufizojnë veprimtaritë e tyre; gjithashtu, ato janë vulnerabël ndaj abuzimeve nga zyrtarët e sigurisë.²⁰⁵ Po ashtu, turpërimi i grave që kanë pasur lidhje me terrorizmin dhe VERLT-in është shpesh më i lartë se te burrat, çka mund të krijojë barriera që ato të pranohen dhe të ri-integrohen në familjet dhe komunitetet e tyre.

Kombet e Bashkuara, OSBE-ja, GCTF-ja, Bashkimi Evropian dhe organizata të tjera kanë identifikuar rekomandime dhe praktika të mira, apo kanë dhënë orientime praktike për Shtetet në punën e tyre për të trajtuar sfida që shpesh janë unike për riintegrimin e grave. Shumë prej këtyre rekomandimeve mund të zbatohen më gjerë për hartimin e programeve R&R, me ndjeshmëri gjinore, në një kontekst jashtë burgut. Për shembull:

1. Instrumentet për vlerësimin e rrezikut dhe të nevojave, dhe praktikuesit që përfshihen në zbatimin e këtyre instrumenteve duhet të kenë ekspertizë për ndjeshmëritë gjinore dhe të trajtohen për të identifikuar dhe reduktuar anësi të pandërgjegjshme në vlerësimet e tyre. Vlerësimet duhet të marrin parasysh rrezikun që mund të paraqesin disa gra, si në aspektin e sigurisë edhe në atë të mundësisë për radikalizim të tjerëve në dhunë.
2. Programi R&R duhet t'u përgjigjet mënyrave se si gratë dhe vajzat përjetojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe konfliktin, të cilat mund të ndryshojnë ndjeshëm nga përjetimet e burrave dhe djemve. Programi për gratë dhe vajzat duhet të përfshijë elemente që janë të përshtatshme për to, që mund të përfshijnë ato që trajtojnë dhunën seksuale dhe dhunës me bazë gjinore, prindërimin, fuqizimin social-ekonomik, dhe rrjetëzimin, për shembull.²⁰⁶

205 Shih, për shembull, *Invisible Women*, f. 9; GCTF, *Addendum to the GCTF Good Practices on Women and CVE, with a Focus on Mainstreaming Gender*, Shtator 2019, www.thegctf.org.

206 Shih, për shembull, *GCTF, Returning Families Good Practices*, Good Practice 16.

3. Programet R&R duhet të udhëhiqen nga profesionistë që janë të ndjeshëm ndaj aspekteve gjinore dhe me njohuri mbi traumat, dhe duhet të **trajtojnë jo vetëm shqetësimet praktike të grave, por edhe ‘faktorët shtytës’ të urrejtjes dhe paragjykitimit (misogjinisë), padrejtësisë dhe mungesës së dinjitetit që përjetojnë gratë në shoqëritë ku ato janë.** Nëse nuk trajtohen, “rreziku që gratë të tërhiqen drejt mesazheve të grupeve ekstremiste të dhunshme vazhdon të jetë i pranishëm.”²⁰⁷
4. Profesionistet dhe praktikueset femra, përfshirë nga agjenci të zbatimit të ligjit, ofrueset e shërbimeve psikologjike, këshilltare ligjore dhe të fushave të tjera, dhe gra udhëheqëse të OJF-ve, duhet të përfshihen në përgatitjen dhe realizimin e ndërhyrjeve për gratë (dhe vajzat), si dhe më gjerësisht në përpjekjet P/CVE.²⁰⁸
5. Qeveritë duhet të ofrojnë trajnime të duhura mbi aspekte të ndjeshmërisë gjinore për profesionistët, praktikuesit dhe organizatat përkatëse që ndërveprojnë me femra të kthyer apo gra (dhe vajza) të tjera që mund të jenë subjekt i programeve R&R në kontekst jashtë burgut.

11.2 Fëmijët

Ashtu si edhe gratë, fëmijët kanë nevoja unike në lidhje me R&R. Për shembull, “zhvillimi i tyre normal social, moral, dhe emocional mund të jetë ndërprerë nga një përjetim luftime.”²⁰⁹ Ata mund të jenë ekspozuar apo të kenë qenë viktime të dhunës ose mund të kenë kryer vepra të dhunshme, duke e bërë gjasën dhe seriozitetin e traumës tejet akute krahasuar me të kthyer të tjerë apo që mund të jenë subjekt i R&R.²¹⁰

Raporti i OSBE/ODIHR-it 2018 për mënyrën e trajtimit të sfidave të paraqitura nga “LHT”-të e kthyer inkurajon shtetet të hartojnë dhe “të zbatojnë programe riintegrimi për fëmijët e kthyer të përshtatura sipas rastit, përfshirë caktimin e mentorëve dhe një gamë të gjerë mbështetjeje, për t’u mundësuar atyre që të kthehen në jetën e mëparshme pa stigmatizim apo pa përjashtim.”²¹¹ Kjo këshillë u bën jehonë pikëpamjeve të një numri organesh të tjera shumëpalëshe, përfshirë Kombet e Bashkuara dhe GCTF-në, të cilët kanë hartuar udhëzues praktikë apo rekomandime ose kanë përgatitur seri parimesh më mënyrën e trajtimit të kësaj kategorie rastesh (shpesh ndahen në tej në grupmosha),

207 *Invisible Women*, f. 13.

208 Edhe përfshirja e tyre në ndërhyrjet për burrat dhe djemtë është po ashtu e rëndësishme.

209 Parlamenti Evropian, *Child Returnees: Managing the Return of European Children from Jihadist Conflict Zones*, 31 Janar 2018, <https://alde.livcasts.eu/child-returnees-managing-the-return-of-european-children-from-jihadist-conflict-zones>.

210 GCTF, *Returning Families Good Practices*.

211 OSCE/ODIHR, *FTF Guidelines*.

përfshirë në lidhje me R&R jashtë kontekstit të burgut, duke njohur rreziqet dhe mbrojtjet unike, si dhe nevojat, kur kemi të bëjmë me minorenë.²¹²

Këto udhëzime përfshijnë si më poshtë:

1. Përgjigjet duhet të jenë **të informuara përmes shpjegimit të të drejtave dhe të interesit më të lartë të fëmijës**, duke marrë parasysh kontekstin specifik dhe të zbatohen në një mënyrë që është në përputhje me të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe ligjin humanitar, si dhe të theksojnë se fëmijët duhet të trajtohen më së pari si viktima dhe se përpjekja për të jetuar një jetë “normale” duhet të jetë përparësia kryesore.²¹³ Si të tillë, fëmijëve të kthyer dhe të tjerë duhet t’u jepet mbështetje e mjaftueshme për t’i ndihmuar në rikuperimin dhe riintegrimin e tyre, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës.²¹⁴ Ashtu si nënvizohet nga udhëzimet e OSBE/ODIHR-it dhe të tjera, kjo duhet të përfshijë, kujdesin e nevojshëm dhe të përshtatur sipas rastit, si dhe mbështetje mjekësore, psikologjike dhe arsimore.
2. Për fëmijët që kanë qenë të lidhur me grupe terroriste ose ekstremiste të dhunshme apo që janë ekspozuar ndaj terrorizmit ose VERLT-it, R&R dhe parandalimi i stigmatizimit të mëtejshëm duhet të marrin përparësi.²¹⁵
3. Për të ndihmuar zhvillimin e në përgjigjeje koherente dhe të efektshme për fëmijët e kthyer (si dhe raste të tjera R&R jashtë kontekstit të burgut që përfshijnë të miturit), shtetet duhet të **përdorin instrumente** të rëndësishëm për vlerësimin e rrezikut dhe të nevojave për këtë segment të popullsisë apo që janë hartuar në mënyrë specifike për fëmijët dhe të miturit. Sipas rastit, ata duhet të **konsiderojnë zhvillimin e një instrumenti specifik për fëmijët** që mund të zbatohet edhe për një grup më të gjerë të synuar për të përfshirë fëmijët që janë të radikalizuar apo janë vulnerabël ndaj radikalizimit në dhunë. Nisur nga nevoja për të marrë parasysh fazat e zhvillimit të fëmijës - dhe gjininë e tij/saj - mund të mos mjaftojë thjesht përshtatja e një instrumenti apo e një kornize fillimisht e hartuar për të rritur.²¹⁶

212 Shih, për shembull, *United Nations, Key Principles for the Protection, Repatriation, Prosecution, Rehabilitation and Reintegration of Women and Children with Links to United Nations Listed Terrorist Groups*, Prill 2019 (në vijim *United Nations, Key Principles*); UNSC Madrid Addendum; UNODC, *Handbook on Children Recruited and Exploited by Terrorists and Violent Extremist Groups*, 2018 https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Child-Victims/Handbook_on_Children_Recruited_and_Exploited_by_Terrorist_and_Violent_Extremist_Groups_the_Role_of_the_Justice_System.E.pdf; GCTF, *Returning Families Good Practices*; RAN Manual on Responses to FTF Returnees, 2017, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/ran_br_a4_m10_en.pdf. Gjithashtu, ndonëse fokusohet më gjerësisht te LHT-të, OSBE/ODIHR-i ka përgatitur një seri udhëzuesish që përfshijnë fokusimin te trajtimi i sfidave unike që paraqesin fëmijët e rikthyer. Shih OSCE/ODIHR, *FTF Guidelines*.

213 Council of Europe *Handbook*, Paragrafi 109.

214 Neni 39 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës parashikon që “Shtetet Palë të marrin të gjitha masat e duhura për të lehtësuar riaftësimin fizik e psikologjik dhe riintegrimin në shoqëri të çdo fëmije që është viktimë: e çdo forme pakujdesie, shfrytëzimi ose keqtrajtimi, torture ose çdo forme tjetër të një trajtimi ose dënimi mizor, çnjëzësor e poshtëruar ose konflikti të armatosur. Ky riaftësim dhe ky ri-integrim duhet të bëhen në kushtet e një mjedisi, që ndihmon shëndetin, personalitetin dhe dinjitetin e fëmijës.” Neni 24 i ICCPR-së parashikon që çdo fëmijë, pa asnjë dallim, ka të drejtë të ketë masat e atilla të mbrojtjes që kërkon gjendja e tij apo e saj si i mitur.

215 Kombet e Bashkura, *Parimet kyçe*, f. 6.

216 RAN Returnee Manual, f. 5. Megjithatë, të paktën një prej instrumenteve ekzistues, VERA-2R, është vlerësuar se mund të zbatohet në rastin e të miturve dhe të rinjve.

4. Kur bëhet një vlerësim, praktikuesit duhet të marrin parasysh se fëmijët mund të kenë qenë dëshmitarë të dhunës, apo t'i jenë nënshtruar vetë asaj, disa herë forma ekstreme të dhunës; dhe/ose mund të jenë të prirur ndaj dhunës vetë. Për këtë arsye, vlerësimet - dhe vendimet (të tilla is nëse duhet rekomanduar ndonjë formë e R&R-së, kujdestaria, dhe/ose mbikëqyrja) - **duhet të baraspeshojnë nevojën për të marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës me nevojën për të siguruar sigurinë publike.**
5. Për të realizuar vlerësime të tilla dhe për të përcaktuar ndërhyrjet e duhura, duhet të përfshihen profesionist të shëndetit mendor që janë të trajnuar për traumat dhe kanë përvojë pune me fëmijët. Përfshirja e tyre është e rëndësishme për të reduktuar rrezikun që të shkaktohen më shumë trauma gjatë procesit të vlerësimit.
6. Programet R&R për fëmijët duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përfshijnë elementin social, arsimor (përfshirë arsimin parashkollor dhe atë fillor, sipas rastit), mentorimin dhe atë të shëndetit mendor, përfshirë për prindërit, gjyshërit dhe anëtarë të tjerë përkatës të familjes dhe komunitetit. Më specifikisht, për shembull:
 - a. Programet duhet të mbështesin aftësi pozitive të fëmijës për jetën, ndërkohë që zbusin rrezikun e riviktimizimit që mund të lindë si rrjedhojë e stigmës në komunitet, keqperceptimeve, dhe paragjytimeve; i dobishëm është edhe komunikimin me publikun për rreziqet aktuale dhe specifike për rastin që kanë të bëjnë me fëmijët që kthehen (ose të tjerë) e që marrin pjesë në programe R&R jashtë kontekstit të burgut;
 - b. Shërimi i traumave duhet të jetë një përparësi dhe për këtë arsye trajnimi për sensibilizimin për traumat për personat që mund të vendosen në kontakt të drejtpërdrejtë dhe vazhdimisht me fëmijët mund të jetë një veprim i duhur;
 - c. Për ata fëmijë që mund të jenë rritur të rrethuar nga ekstremizmi i dhunshëm apo në një zonë konflikti mund të duhet një qasje e ndryshme për shkaputjen nga ideologjia e dhunshme, nga qasja për të rriturit; dhe
 - d. Institucionet e arsimit parashkollor dhe fillor luajnë një rol të rëndësishëm në programet R&R që kanë në fokus fëmijët: qasja në arsim mund të jetë me rëndësi kritike për procesin R&R për fëmijët, pasi, *ndër të tjera*, sjell një sens sigurie, normalizon jetën e përditshme të fëmijës, siguron ekspozim ndaj një diversiteti kulturor dhe rrit ndërveprimin me individë jashtë shtëpisë.²¹⁷ Ndaj, i duhet kushtuar vëmendje sensibilizimit dhe trajnimit të mësuesve, të cilëve mund t'u kërkohet të integrojnë fëmijët e rikthyer në klasat e tyre.
7. **Bashkërendimi dhe bashkëpunimi midis aktorëve dhe strukturave të ndryshme**, përfshirë sektorët për mbrojtjen e fëmijës, kujdesin për të rinjtë, dhe arsimin - që mbështeten në struktura dhe procedura ekzistuese - është i rëndësishëm për lehtësimin e vlerësimeve dhe ndërhyrjeve të integruara.

8. Organizatat, praktikuesit dhe profesionistët e përfshirë në rastet R&R që kanë të bëjnë me fëmijë duhet të marrin trajnim të mjaftueshëm për të punuar me këto raste, duke njohur shqetësimet dhe nevojat unike të të miturve.
9. Përpjekjet R&R të fokusuara te fëmijët duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë ndikimit të mundshëm negativ të medias sociale dhe internetit për shkëputjen nga dhuna dhe riintegrimin. Për shembull, kur merren me trajtimin e sfidave që mund të paraqesë riintegrimin, të rinjtë mund të jenë veçanërisht vulnerabël ndaj ri-përfshirjes online me grupe, kauza, dhe ideologji të caktuara.²¹⁸
10. Jini të ndjeshëm ndaj terminologjisë dhe kornizimit në një kuadër më të gjerë të një angazhimi R&R me fëmijët, duke pasur parasysh se kjo mund të përforcojë apo të reduktojë stigmatizimin dhe mund të lehtësojë apo të pengojë shkëputjen.²¹⁹

Disa vende në rajonin e OSBE-së kanë zhvilluar qasje sistematike për menaxhimin e kthimit të fëmijëve nga zonat e konfliktit, të cilat përfshijnë një komponent R&R. Në Francë, për shembull, kjo qasje, përfshin, *ndër të tjera*, (1) një referim sistematik të një gjyqtar për të mitur për masa mbrojtëse; (2) një vlerësim të udhëhequr nga shërbimet e mbrojtjes gjyqësore të të rinjve; (3) një vlerësim të shëndetit mendor dhe një vlerësim më të gjerë mjekësor; (4) futja (ose rifutja) në shkollë sa më shpejt që të jetë e mundshme; (5) përfshirja e njësive lokale kriminale dhe të radikalizimit dhe të mbështetjes familjare - të krijuara sipas Planit Kombëtar për Parandalimin e Radikalizimit 2018 - për të siguruar një vijimësi të qëndrueshme të punës me fëmijët dhe familjet; dhe (6) trajnim specifik për profesionistët përkatës.²²⁰

218 GCCS, *Compendium of Good Practices*, f. 52 219 Po aty, f. 51

220 Qeveria Franceze, *Prevent to Protect (Parandalo për të Mbrojtur)*. Shih edhe RAN, Qendra e Ekselencës, *Common P/CVE Challenges in the Western Balkans and European Union*, RAN Ex Post Paper, RAN Policy & Practice Event, Sofia, 4 April 2018, p. 12, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/ran_policy_practice_common_pcve_challenges_sofia_04042018_en.pdf.



12. Përfundim: parime kyçe

R&R për ata individë të vlerësuar se kanë pasur një përfshirje domethënëse apo ekspozim ndaj terrorizmit dhe VERLT-it njihet gjerësisht si një element i domosdoshëm për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj trajtimit të këtyre sfidave në periudhën afatgjatë. R&R-ja është me rëndësi thelbësore jo vetëm për parandalimin e veprave të dhunës në periudhën afatshkurtër, por edhe për ndërtimin e një rezistence të përgjithshme ndaj VERLT-it në nivel komuniteti. Si i tillë, koncepti i R&R-së zë një vend të rëndësishëm në Planveprimin PVE të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe në shumë planveprime dhe strategji kombëtare për P/CVERLT me të cilat vijohet të punohet.²²¹

Siç u vu në dukje në fillim të këtij udhëzuesi, R&R po merr një vëmendje të shtuar nga organe shumëpalëshe, qeveri (përfshirë donatorët), OJF dhe aktorë të tjerë joqeveritarë në mjedisin aktual. Megjithatë, pjesa më e madhe e fokusit është vendosur te R&R-ja jashtë kontekstit të burgut - dhe kjo pasqyrohet në udhëzuesit e shumtë, rekomandimet dhe manualët që fokusohen në këtë aspekt të sfidës. Ky udhëzues, që mbështetet pjesërisht nga mësimet e nxjerra nga praktikatat e mira që fokusohen te konteksti në burg dhe përvoja të tjera dhe ekspertizë në rajonin e OSBE-së, synon t'i plotësojë ato përpjekje duke trajtuar mjedisin e ndryshme *jashtë kontekstit të burgut*. Ai thekson disa prej hapave që duhet të ndërmarrin shtetet dhe aktorët përkatës, dhe sfidat me të cilat mund të përballen, nëse vendosin që të përgatisin programe R&R jashtë kontekstit të burgut si pjesë e një qasjeje gjithëpërfshirëse, shumëdisiplinëshe ndaj P/CVERLT.

Siç është vënë në dukje në këtë udhëzues, nuk ka një qasje që t'i përshtatet të gjitha rasteve. Ashtu si edhe në kontekstin më të gjerë të programeve P/CVERLT, përfjekjet R&R vijnë në forma dhe përmasa të ndryshme, të informuara, *ndër të tjera*, nga objektivat specifike dhe kontekstet përkatëse lokale shoqërore,

221 UNGA, Plan of Action to Prevent Violent Extremism. Shih, për shembull, *National Strategy on Countering Radicalization to Violence*, 2018, të Kanadasë <https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrscs/pblctns/ntnl-strtg-cntrng-rdclztn-vinc/index-en.aspx>; the *National Strategy for Counterterrorism of the United States of America*, 2018, <https://www.whitehouse.gov/wp-content/uploads/2018/10/NSCT.pdf>; Lebanon's *National Strategy for Preventing Violent Extremism*, 2018, http://www.pvelebanon.org/Resources/PVE_English.pdf; and Switzerland's *National Action Plan to Prevent and Counter Radicalisation and Violent Extremism*, <https://www.news.admin.ch/newsd/message/attachments/50703.pdf>.

kulturore dhe historike, marrëdhëniet në komunitet dhe kapacitetet e disponueshme. Megjithatë, në reflektim të përvojave përkatëse në rajonin e OSBE-së, udhëzuesi hedh dritë mbi disa parime bazë, shpesh të ndërlydhura që duhet të informojnë zhvillimin dhe zbatimin e programeve të tilla. Ndër më kryesoret e këtyre parimeve janë si më poshtë:

1. **Paraqet rëndësinë e R&R.** Qeveritë duhet të komunikojnë me efektshmëri qëllimet dhe përfitimet e R&R në kontekst jashtë burgut, nga njëra anë, publikut që mund ta shohë këtë si një qasje shumë të butë për trajtimin e terrorizmit - ku një segment i popullsisë parapëlqen një reagim të tipit “futini brenda dhe hidheni çelësin në det” - dhe, nga ana tjetër, individëve të synuar dhe komuniteteve që mund t’i shohin masat R&R si një stigmatizim i mundshëm.

Sa i takon pjesës skeptike të publikut, duhet theksuar se investimi në këto masa është një element i rëndësishëm për një strategji gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe kundërvënien ndaj terrorizmit dhe VERLT-it. Në vend që të ndihmohen “terroristët” apo të vendosen nën shënjestër individë dhe komunitete në mënyrë të padrejtë, kjo paraqet “një mënyrë të zgjuar për të punuar për reduktimin e rrezikut të recidivizmit, për të punuar me ish autorë të veprave terroriste për të parandaluar akte dhune në të ardhmen të kryera nga të tjerë”²²² si dhe radikalizimin në dhunë të të tjerëve në komunitetet përkatëse.

Në veçanti, po të kemi parasysh kohën e limituar që shumë autorë të veprave që lidhen me terrorizmin ka gjasë të kalojnë në burg, rrezikun e radikalizimit (të mëtejshëm) në burg, moshën relativisht të re të pjesës më të madhe të autorëve të liruar të veprave që lidhen me terrorizmin, dhe numrin e individëve që kthehen nga zonat e konfliktit që mund të mos ndiqen penalisht, politikanët dhe politikëbërësit duhet të theksojnë, për ato segmente skeptike të publikut, se mosinvestimi në ndërhyrje për të lehtësuar shkëputjen nga dhuna dhe rifutjen paqësore në shoqëri do të ishte, në rastin më të mirë, dritëshkurtër.

Më tej, vlen të theksohet se ndërhyrjet e realizuara në komunitet janë tipikisht më të efektshme se ato që realizohen në burg apo kontekste të tjera të privimit të lirisë.²²³ Të pakta janë arsyet për të sugjeruar se pse ky nuk do të ishte rasti në punën P/CVERLT R&R në një kontekst jashtë burgut. Të dhëna empirike për të mbështetur këtë pohim janë të kufizuara, por, sikurse është shpjeguar në këtë udhëzues, mospasja e caq shumë të dhënave ka të bëjë më shumë me vështirësitë metodologjike për t’i mbledhur ato sesa me vlerën dhe ndikimin e vetë masave R&R.

222 Morton and Silber, *When Terrorists Come Home*, f. 14.

223 Shih, për shembull, James Bonta and D.A. Andrews, *The Psychology of Criminal Conduct*, 6th Ed., (Abingdon: Routledge, 2017); Mark Lipsey, “The Primary Factors that Characterise Effective Interventions with Juvenile Offenders: A Meta-Analytic Overview,” *Victims & Offenders*, no. 4 (2009): f. 124–47, http://www.episcenter.psu.edu/sites/default/files/community/Lipsey_Effective%20interventions%20-%202009.pdf; Friedrich Losel and Martin Schmucker, “The Effectiveness of Treatment for Sexual Offenders: A Comprehensive Meta-Analysis,” *Journal of Experimental Criminology*, no. 1 (2005): pp. 117–146, <https://link.springer.com/article/10.1007%2F11292-004-6466-7>.

2. **Adresimi i të gjitha formave të VERLT-it.** Programet nuk duhet të kufizohen vetëm te një formë të vetme të VERLT-it por duhet të jenë të disponueshme (tipikisht në baza vullnetare) për ata që kërkojnë të shkëputen nga çdo formë e tillë dhune, goftë të lidhur me ISIL-Da'esh apo me grupe të tjera terroriste "xhihadiste" apo ato me motivime të krahut të djathtë apo etno-nacionaliste. Jo vetëm që kjo shtrirje ka gjasë të garantohet nga një perspektivë sigurie, veçanërisht duke marrë parasysh shqetësimet në rritje për dhunën ekstremiste jo-"xhihadiste" në një numër vendesh të rajonit të OSBE-së, por edhe ka më pak gjasë që të stigmatizohen ata që përfshihen në programe - përfituesit e synuar apo edhe praktikuesit dhe profesionistët - që rrjedhin prej saj duke përmirësuar në këtë mënyrë perceptimin e publikut për këto programe. Si të tillë, programet e zhvilluar sipas një kornize me bazë të gjerë ka më shumë gjasë të pranohen dhe të marrin mbështetje nga ata aktorë, bashkëpunimi me të cilët ka rëndësi kritike për suksesin.
3. **Theksi tek shkëputja.** Programet duhet të fokusohen më së pari te shkëputja nga dhuna, duke kuptuar mënyrën se si dhe pse dikush përfshihet në VERLT. Ata duhet të kuptojnë se arsyet janë të ndryshme dhe përgjithësisht shtrihen përtej përfaqimit të një ideologjie të veçantë. Programet duhet të jenë fleksibël dhe të përshtaten sipas kontekstit specifik dhe motiveve të individit. Këndvështrimi ideologjik dhe teologjik i individit - apo mendësia në një rrafsh më të gjerë - nuk duhet të shpërfillen. Në të vërtetë, përfituesit e ndërhyrjeve R&R mund të kërkojnë angazhim më të madh në çështje psikologjike, ideologjike dhe teologjike se sa përfituesit e programeve që fokusohen te parandalimi. Megjithatë, ndërhyrjet nuk duhet të kërkojnë ta konvertojnë individin nga njëri besim apo ideologji në një tjetër, apo përndryshe të kërkojë ose ta shtrëngojë dikë të ndryshojë bindjet apo ideologjinë.
4. Qasja gjithëpërfshirëse për shumë aktorë dhe sektorë. Individët dhe familjet që janë të gatshëm të përfitojnë nga programet R&R jashtë kontekstit të burgut do të kenë vulnerabilitete dhe nevoja të ndryshme, të cilat një profesionist apo institucion i vetëm nuk do të mundet t'i trajtonte i vetëm. Për këtë arsye, me gjasë do të duhet një qasje që lejon kontribute nga një gamë e gjerë profesionistësh, praktikuesish, dhe aktorësh të tjerë nga disiplina të ndryshme brenda dhe jashtë qeverisë, duke u mbështetur në një ekspertizë të pasur e të gjerë dhe duke shfrytëzuar ata që ka më shumë gjasë të kenë besueshmëri dhe të kenë marrëdhënie besimi brenda komunitetit në të cilin individit do të integrohet apo ri-integrohet. Çështjet që mund ta kenë shtyrë individin në rrugën e VERLT-it është pothuajse e sigurt se janë komplekse mund të trajtohen si duhen vetëm nëpërmjet një qasjeje që përfshin shumë aspekte.

Ofruesit e ndërhyrjes - të cilët, sipas rastit, duhet të përfshihen edhe në vlerësimin e rrezikut dhe nevojave të një individit të veçantë dhe të vendosin për trajtimin e duhur - mund të përfshijë një nga sa më poshtë, në varësi të rastit dhe kontekstit në fjalë si dhe të kapaciteteve të disponueshme:

psikologë, psikiatër, ose profesionistë të tjerë të shëndetit mendor; “ishët”; punonjës socialë; punonjës të strehimit; punonjës të shërbimeve për të rinjtë; ekspertë të kujdesit pasues; anëtarë të familjes; punonjës të shërbimit të provës; dhe oficerë të policisë. Këta aktorë do të kenë detyra, mandate dhe objektiva të ndryshme, të cilat mund të paraqesin një sfidë për shkëmbimin e informacionit dhe për forma të tjera të bashkëpunimit; rolet dhe përgjegjësitë e ndryshme që kanë do të duhen të qartësohen. Prandaj, shtetet duhet të ndërmarrin hapa për të lehtësuar një shkëmbim informacioni midis aktorëve të shumtë në mënyrë transparente si dhe një bashkëpunim më të gjerë, ndërkohë që respektohen privatësia, mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti. Gjithsesi, duhet të marrin parasysh se klientët do të përfitojnë tipikisht duke pasur vetëm një praktikues, profesionist, apo ekspert tjetër si pikën kryesore të kontaktit, dhe ky individ të bashkërendojë përfshirjen e ofruesve të tjerë të shërbimeve. Ndër të tjera, besimi që mund të vijë si rezultat i kësaj marrëdhënieje midis një koordinatori të vetëm dhe përfituesit mund ta rrisë gatishmërinë e këtij të fundit për të pranuar shërbime të tjera të rekomanduara nga koordinatori.

5. **Garantimi i proporcionalitetit dhe vijmësisë.** Ndonëse ka një numër ndërhyrjesh të mundshme, mbështetja e ofruar apo e rekomanduar duhet të jetë proporcionale me rreziqet, nevojat dhe vulnerabilitetet e individit. Rekomandimi i shumë ndërhyrjeve në të njëjtën kohë, mund të sjellë efekt të kundërt, pasi rreziqet e “mbindërhyrjes” përfshijnë stigmatizim, me potencialin për ta mbyllur hapësirën kognitive të nevojshme për rehabilitimin, dhe të krijojë pa qenë nevoja një ndjesi alarmi në komunitetin përkatës, bashkëpunimi dhe mbështetja e të cilit mund të jetë me rëndësi kritike për suksesin e rifutjes së individit në këtë komunitet. Mbikëqyrësit e programeve R&R jashtë kontekstit të burgut duhet të vlerësojnë rregullisht nëse ndërhyrjet janë në raport të drejtë me nivelin e rrezikut dhe të nevojës së paraqitur apo programi po sjell më shumë dëm se sa përfitim.²²⁴

Vijmësia e programve R&R bazuar në burg dhe programeve R&R pas lirimit është po aq e rëndësishme për shkëputjen dhe risocializimin e efektshëm. Përfituesit e programeve R&R kanë pasur një seri marrëdhëniesh të ndërprera gjatë gjithë jetës së tyre dhe krijimi i një ndjesie stabiliteti dhe sigurie kur kërkojnë të rifuten në shoqëri ndihmon për suksesin e çdo qasjeje që përfshin autorët e veprave që lidhen me terrorizmin. Krijimi i këtij stabiliteti mund të përfshijë ndërmarrjen e hapave të tilla si fillimi i programeve të nevojshme R&R sa më shpejt të jetë e mundshme gjatë vuajtjes së dënimit në burg; përgatitja e një plani pas lirimit që fillon të paktën gjashtë muaj para përfundimit të vuajtjes së dënimit në burg; vazhdimin nga ana e praktikuesve dhe profesionistëve që punojnë brenda burgut, kur është e mundur, të këshillimit të ish-të dënuarit pas

224 Christopher Dean, *Addressing Violent Extremism in Prisons and Probation: Principles for Effective Programs and Interventions*, Global Center on Cooperative Security, September 2016, <https://www.globalcenter.org/publications/addressing-violent-extremism-in-prisons-and-probation>.

lirimit me qëllim forcimin e marrëdhënieve afatgjata dhe mbi bazë besimi; dhe sigurimi që procesi i shkëmbimit të informacionit midis aktorëve përkatës (si ata që punojnë brenda edhe ata që punojnë jashtë kontekstit të burgut) të jetë i konsoliduar dhe i vazhdueshëm dhe që të ketë shërbime mbështetëse aktive ku rol thelbësor të luajnë shërbimi i provës apo një shërbim kombëtar i barasvlershëm. Një element kritik për të gjithë këtë është sigurimi i një mjedisi në burg me kushte humane dhe që respekton të drejtat e njeriut.

- 6. Trajtimi dhe zbutja e stigmës dhe shmangia e (perceptimit të) dhënies së një trajtimi preferencial.** Ata që përfshihen në përgatitjen dhe zbatimin e programeve R&R në kontekstin jashtë burgut duhet të tregojnë kujdes për stigmat që, nëse nuk identifikohen dhe zbuten, mund të pengojnë efektshmërinë e përpjekjeve. Këto stigma mund të nxiten nga përdorimi i etiketimeve si “terrorist”, “ekstremist i dhunshëm”, ose “LHT” për një program, çka mund të krijojë barriera për qasjen në mbështetje sociale, arsimim, apo shërbime të tjera jetësore për riintegrimin, apo duke theksuar shëndetin mendor ose çështje të tjera që mund të nxisin ndjeshmëri kulturore në një komunitet të caktuar.

Po ashtu, etiketimi i individëve duke përdorur këto terma mund t'i përforcojë këto identitete se janë parësore për mënyrën se si e përkufizon individi ecurinë përpara. Është e rëndësishme të theksohen dhe të inkurajohen identitete të tjera në jetën e një individi - identitete të tilla si prind, punonjës, student apo bashkëshort.

Në varësi të ndërhyrjeve dhe mbështetjeve të tjera të ofruara në një kuadrin e R&R jashtë kontekstit të burgut - dhe shkallën në të cilën këto shërbime janë të disponueshme më gjerë për pjesën tjetër të popullsisë - programet R&R mund të gjenerojnë ndjenja pakënaqësie në komunitet karshi individëve që synojnë të arrijnë këto programe bazuar në perceptimin (ndoshta edhe realitetin) se ata që mund të kenë pasur ndonjë lidhje me terrorizmin apo ekstremizmin e dhunshëm po marrin trajtim më të mirë se të tjerët. Dhënia (madje edhe perceptimi se po u jepet) një trajtim preferencial ish ekstremistëve të dhunshëm apo të kthyerve nga një zonë konflikti mund të krijojë pakënaqësi të anëtarët e tjerë të komunitetit, të cilët mund të ndihen se po disavantazhohen pa të drejtë. Rreziku shtohet më tej në rastet kur komunitetet ndjejnë se qeveria nuk ka reaguar mjaftueshëm ndaj nevojave të tyre materiale, për arsimin, apo ato psikologjike.

- 7. Përgatitja dhe angazhimi i komuniteteve.** Shkalla në të cilën komuniteti ku individi kërkon të ri-integrohet e pranon dhe e mbështet procesin është shpesh një faktor kyç për suksesin e çdo programi R&R jashtë kontekstit të burgut. (Siç u vu në dukje në Seksionin 1, mund të ketë disa raste në të cilat individi nuk kthehet në komunitetin e tij apo të saj të origjinës, po zhvendoset në një komunitet tjetër.). Në fund, puna R&R jashtë kontekstit

te burgut mund të funksionojë më mirë kur qeverisja vendore dhe bizneset, organizatat me bazë besimin, OJF-të, ofruesit e kujdesit psikologjik, shkollat dhe grupet komunitare angazhohen që herë dhe prëfshihen si në përgatitjen edhe zbatimin e programeve që kanë të bëjnë me individë në komunitetin e tyre.²²⁵ Megjithatë, ata që janë etiketuar si “terrorist”, “ekstremist i dhunshëm”, “LHT”, ose “i kthyer” mund të nxisin frikë dhe të ngrënë dyshime në komunitetet ku ata kërkojnë të rifuten (ose të futen). Si rrjedhojë, përfshirja e shkollës, komunitetit të vendit të punës, rrethit shoqëror, qendrave fetare apo qendrave të tjera komunitare, si dhe aktorë të tjerë lokalë që të kenë besim tek ata që mund të kenë pasur ndonjë lidhje me terrorizmin apo esktrimizmin e dhunshëm, pavarësisht sa e papërfillshme dhe pavarësisht nga motivet e tyre apo çfarë mund të kenë bërë, mund të jetë një sfidë.²²⁶ Kjo mund të pengojë qasjen në mbështetje sociale, shkolla, punë, të cilat janë shpesh elemente kyçe për një qasje gjithëpërfshirëse për integrimin. Në disa raste, ata individë në komunitet, në veçanti anëtarët e familjes, mund të kërkojnë mbështetje psikologjike dhe të formave të tjera me qëllim që të luajnë një rol konstruktiv në procesin e riintegritit dhe shkëputjes.

Duhet rritur ndërgjegjësimi, duhen zbutur stigmat dhe veprimet që mund të sjellin efekt të kundërt, si dhe paragjykimet që ndeshen si pjesë e një përpjekjeje për të përgatitur komunitetet që të presin këta individë. Për këtë qëllim, qeveritë, sidomos në nivel lokal, duhet të informojnë komunitetet përkatëse për parametrat e programit R&R, të theksojnë aktorët e ndryshëm të përfshirë në të, dhe të nënvizojnë se siguria publike mbetet përparësi.

8. Sigurimi i qasjeve që kanë ndjeshmëri dhe trajtojnë nevojat unike të grave dhe fëmijëve. Instrumentet për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave duhet të tregojnë ndjeshmëri ndaj faktorit gjinor dhe profesionistët dhe praktikuesit e përfshirë në përgatitjen dhe zbatimin e këtyre instrumenteve duhet të kenë ekspertizë për ndjeshmëritë gjinore. Programi duhet t’u përgjigjet mënyrave se si gratë dhe vajzat përjetojnë ekstremizmin e dhunshëm dhe konfliktin, të cilat mund të ndryshojnë ndjeshëm nga përjetimet e burrave dhe djemve. Programet duhet të udhëhiqen nga profesionist që janë të ndërgjegjësuar për çështjet gjinore, dhe kanë njohuri mbi traumat, të cilët janë jo vetëm të pajisur për të trajtuar shqetësimet praktike të grave, por edhe kanë njohuri për faktorë të veçantë që lidhen me gjininë dhe rrethana që mund të kontribuojnë për interesin dhe përfshirjen në ekstremizëm të dhunshëm. Për hartimin dhe realizimin e ndërhyrjeve për gratë (dhe vajzat) duhet të përfshihen praktikuese femra dhe OJF të udhëhequra nga femra. Qeveritë

225 GCTF, *Returning Families Good Practices*, Good Practice 19.

226 Kjo është gjithashtu arsyeja se pse mund të jetë e dobishme për një agjenci qeveritare që të identifikohet se është përgjegjëse për individin në fjalë gjatë periudhës së mbikëqyrjes dhe riintegritit të tyre në komunitet. Anëtarët e komunitetit janë më të gatshëm të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë nëse mund të lidhen me një partner të besuar qeveritar, të cilin e dinë se ka përgjegjësinë finale për këtë individ (përfshirë mbajtjen e rrezikut) dhe që mund të japë këshilla dhe mbështetje, nëse është e nevojshme.

duhet të ofrojnë trajnime të duhura mbi aspekte të ndjeshmërisë gjinore për profesionistët, praktikuesit dhe organizatat përkatëse që ndërveprojnë me femra të kthyer apo gra (dhe vajza) të tjera që mund të jenë subjekt i programeve R&R jashtë kontekstit të burgut.

Qasjet që përfshijnë fëmijët, edhe ata që mund të kenë kryer vepra që lidhen me terrorizmin, duhet të bazohen mbi njohurinë dhe të kuptuarit e të drejtave dhe interesit më të lartë të fëmijës, të cilët duhet të shihen më së pari e mbi të gjitha si viktimë. Dhënia e kujdesit të duhur dhe të përshtatur si pas nevojës në aspektin mjekësor, psikologjik dhe arsim mund të lehtësojë riintegrimin dhe të shmangë trauma dhe stigmatizim të mëtejshëm, ndërkohë që ofrimi i sigurisë publike duhet të mbetet një prioritet. Programet duhet të përshtaten dhe të marrin parasysh se fëmijët që mund të jenë rritur të rrethuar nga ekstremizmi i dhunshëm apo në një zonë konflikti mund të kërkojnë një qasje ndryshe nga të rriturit sa i takon shkëputjes nga një ideologji e dhunës. Shërbimet e mbrojtjes së fëmijës, institucionet parashkollore dhe shkollore, si dhe gjyshërit dhe anëtarë të tjerë të rrethit më të gjerë familjar - aktorë që nuk përfshihen tipikisht në përpjekjet R&R për të rriturit - janë ndër aktorët kyçë që do të duhet të përfshihen në programet R&R që fokusohen te fëmijët. Ata që punojnë me fëmijët në këto programe duhet të kenë marrë trajnim për ndjeshmërinë ndaj traumave dhe trajnime të tjera të specializuara, për të njohur shqetësimet dhe nevojat unike të fëmijëve.

9. Mbështetja në kapacitetet ekzistuese dhe forcimi i tyre kur është e nevojshme. Programe të efektshme dhe të qëndrueshme R&R jashtë kontekstit të burgut kërkojnë përfshirjen e institucioneve dhe organizatave të ndryshme si dhe të profesionistëve, praktikuesve dhe ekspertëve të tjerë. Ky grup i larmishëm në përbërje duhet të përfshijë individë me ekspertizë specifike për VERLT-in dhe administratorë dhe menaxherë që mund të ofrojnë një mjedis mbështetës organizativ për përpjekjet P/CVERLT R&R që janë të ndjeshme ndaj aspekteve gjinore dhe të moshës. Aty ku është e mundur, qeveritë duhet të shfrytëzojnë kapacitetet institucionale dhe kapacitete të tjera ekzistuese, përfshirë ato që nuk janë specifikisht për çështje P/CVERLT, për të shmangur krijimin e strukturave paralele. Megjithatë, hartimi dhe zbatimi i nismave R&R në kontekst jashtë burgut në disa vende mund të kërkojnë investimin në trajnim dhe instrumente të specializuara si dhe në një kuptim më të gjerë në forcimin e kapaciteteve themelore të institucioneve. Rasti i parë përfshin trajnimin për mënyrën e vlerësimit të rrezikut apo të nevojave të atyre që mund të kenë pasur kontakt me terrorizmin ose VERLT-in, mënyrën e angazhimit në bashkëpunim midis shumë agjencive apo aktorëve për raste specifike, dhe/ose mënyrën për të nisur dhe për t'u angazhuar në biseda të vështira që mund të lehtësojnë shkëputjen nga VERLT-i. Rasti i dytë përfshin kapacitetet e policisë, burgjeve, shërbimit të provës, shëndetit mendor, mirëqenies sociale, arsimit dhe agjencive të tjera qeveritare si dhe të OJQ-ve të bazuara në komunitet apo OJQ-ve të tjera të përfshira në një formë apo një tjetër. Këto kapacitet janë veçanërisht të rëndësishme po të mbajmë parasysh vështirësitë për realizimin e ndërhyrjeve të specializuara dhe të targetuara si dhe

shërbime të tjera që lidhen me një qasje gjithëpërfshirëse ndaj një R&R në kontekst jashtë burgut në mungesë të disa aftësive bazë. Përtej faktit që të sigurohet prania e kapaciteteve të nevojshme qeveritare në nivel kombëtar dhe nënkombëtar, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar sigurimit të faktit që për OJF-të (dhe shoqëria civile në një kuptim më të gjerë) - duke pasur parasysh avantazhet e shumta krahasuese që kanë në punën me komunitetet për çështje të ndjeshme - të ekzistojë hapësira e nevojshme ligjore dhe e politikave, kapacitetet dhe burimet për të kontribuar.

10. **Përfshirja e teorisë së ndryshimit.** Në bazë të programeve R&R duhet të jetë një teori ndryshimi që shpjegon mënyrën se si qasja e propozuar lidhet me objektivin dhe rezultatet e ndërhyrjes. Synimet e programit (p.sh. në lidhje me qëndrimin, motivimin, dhe/ose afëtsitë) ndihmojnë për të përcaktuar strukturën e programit, nëse është i efektshëm për të arritur rezultatet që synohen, si dhe për të lehtësuar matjen e progresit në vijim.²²⁷ Artikulimi i qartë i rezultateve që synojnë të arrijnë programet R&R janë tejet të rëndësishme për një vlerësim të efektshëm, çka në vetvete është me rëndësi kritike për mobilizimin e financimit të qëndrueshëm dhe për patur mbështetjen e publikut. Më tej, është e rëndësishme të mundësohet që progresi të vlerësohet në vijimësi për të siguruar që ndërhyrja të vazhdojë të trajtojë ato që me gjasë mund të jenë nevoja në ndryshim të individit. Gjithashtu, është e rëndësishme të njihen barrierat potencialisht domethënëse shoqërore, kulturore dhe barrierat të tjera që konfrontojnë ata që shpresojnë të shkëputen nga VERLT-i, kur vlerësohet ndikimi i ndërhyrjeve.

227 Shih, për shembull, CREST, *Deradicalisation Programmes*, ku përcaktohen llojet e ndërhyrjeve, metodat që ata përdorin dhe mënyrën e vlerësimit të efekteve të tyre.

SHTOJCA 1:

Manuale, Udhëzues dhe Instrumente të tjera në lidhje me R&R në kontekst jashtë burgut

Kjo Shtojcë përfshin si materialet e përgatitura nga organizata ndërkombëtare, rajonale dhe joqeveritare në mënyrë specifike për R&R në një kontekst burgu, edhe instrumentet në një numër më të kufizuar të hartuara për programet dhe gasjet R&R jashtë mjedisit të burgut. Të dyja këto grupe materialesh lidhen me R&R në kontekstin jashtë burgut.

Këshilli i Evropës

1. Compendium of Conventions, Recommendations and Resolutions Relating to Prisons and Community Sanctions and Measures. March 2019. <https://rm.coe.int/compendium-e-2019/16809372d2>.
2. Recommendation of the Committee of Ministers to Member States on the European Rules on Community Sanctions and Measures, CM/Rec. 2017. https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=0900001680700a5a.
3. *Council of Europe Handbook for Prison and Probation Services Regarding Radicalization and Violent Extremism*. 2016. <https://www.researchgate.net/publication/322100931>.
4. Guidelines for Prison and Probation Services Regarding Radicalization and Violent Extremism. 2016. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806f3d51>.
5. Recommendation CM/Rec(2010)1 of the Committee of Ministers to Member States on the Council of Europe Probation Rules. January 2010. https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cfbc7.
6. Commentary on Recommendation CM/Rec(2010)1 of the Committee of Ministers to Member States on the Council of Europe Probation Rules. January 2010. https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cff79.
7. Recommendation CM/Rec(2008)11 of the Committee of Ministers to Member States on the European Rules for Juvenile Offenders Subject to Sanctions or Measures. 2008. https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805d2716.
8. Recommendation Rec(2003)22 of the Committee of Ministers to Member States on Conditional Release (Parole). 2003. https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805df03f.

Rrjeti i BE-së për Ndërgjegjësimin kundër Radikalizmit

9. *Approaches to Countering Radicalisation and Dealing with Violent Extremist and Terrorist Offenders in Prisons and Probation*. RAN Prison and Probation Practitioners' Working Paper. 2019. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ran_wrk_pp_pract_3rd-2018_20190606_en.pdf.
10. *Multi-Agency Working and Preventing Violent Extremism: Paper 2*. RAN Health & Social Care Working Paper. 2019. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-h-and-sc/docs/ran_hsc_policy_mawr_report_sarma_26032019_en.pdf.
11. *What Role Do Police Play in the Resocialisation and Risk Management of Released Former Terrorist Offenders?* RAN Ex Post Paper. May 2019. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-pol/docs/ran_pol_role_do_police_play_in_resocialisation_marseille_20190520_en.pdf.
12. *The Role of Family and Social Networks in the Rehabilitation of (Violent) Extremist and Terrorist Offenders*. RAN Ex Post Paper. March 2018. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ran_pp_role_family_social_networks_rehabilitation_extremist_terrorist_offenders_06-07_03_2018_en.pdf.
13. *Preventing Radicalisation to Terrorism and Violent Extremism Prison and Probation Interventions*. 2018. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/prison-and-probation-interventions_en.pdf.
14. *The Challenge of Resocialisation: Dealing with Radicalised individuals during and after Imprisonment*. RAN Ex Post Paper". November 2018. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ran_pp_dealing_with_radicalised_individuals_06_112018_en.pdf.
15. *Responses to Returnees: Foreign Terrorist Fighters and Their Families*. – RAN Manual. July 2017. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/ran_br_a4_m10_en.pdf.
16. *The Role of Religion in Exit Programmes and Religious Counselling in Prison and Probation Settings*. RAN Ex Post Paper. October 2017. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ran_pp_role_of_religion_in_exit_programmes_10-11_10_2017_en.pdf.
17. *Approaches to Violent Extremist Offenders and Countering Radicalisation in Prisons and Probation*. RAN Prison and Probation Practitioners' Working Paper. 2016. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ran_pp_approaches_to_violent_extremist_en.pdf.

18. *Minimum Methodological Requirements for Exit Interventions, RAN EXIT Ex Post Paper*. 2016. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-exit/docs/ran_exit-ex_post_paper_london_15-16032016_en.pdf.
19. *Exit Programmes and Interventions in Prison and Probation*. RAN Prison and Probation Ex Post Paper. 14–15 June 2016. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-p-and-p/docs/ex_post_paper_ran_p_and_p_14-15_06_2016_en.pdf.

Forumi Global Kundër Terrorizmit

20. *Addendum to the GCTF Good Practices on Women and CVE, with a Focus on Mainstreaming Gender*. September 2019. <https://www.thegctf.org/LinkClick.aspx?fileticket=JA1tbXKhobE%3D&portalid=1>.
21. *Good Practices on Addressing the Challenge of Returning Families of Foreign Terrorist Fighters (FTFs)*. 2018. https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/C/GCTF-Good-Practices-on-Returning-Families-of-FTFs_ENG.pdf?ver=2018-09-25-101427-323.
22. *Initiative to Address Homegrown Terrorism: Rabat-Washington Good Practices on the Prevention, Detection, Intervention and Response to Homegrown Terrorism*. 2018. https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/C/GCTF-Rabat-Washington-Good-Practices_ENG.pdf?ver=2018-09-21-122245-707.
23. *Initiative to Address the Life Cycle of Radicalization to Violence: The Role of Families in Preventing and Countering Violent Extremism: Strategic Recommendations and Programming Options*. 2016. <https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Lifecycle%20Toolkit-documents/English-The-Role-of-Families-in-PCVE.pdf?ver=2016-09-13-141058-860>.
24. *Initiative to Address the Life Cycle of Radicalization to Violence: Addendum to The Hague-Marrakech Memorandum on Good Practices for a More Effective Response to the FTF Phenomenon*. 2016. https://toolkit.thegctf.org/Portals/1/Documents/En/16Aug01_ENGLISH_Addendum_to_The_Hague-Marrakech_Memorandum.pdf.
25. *Initiative to Address the Life Cycle of Radicalization to Violence: Recommendations on the Effective Use of Appropriate Alternative Measures for Terrorism-Related Offenses*. 2016. <https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Lifecycle%20Toolkit-documents/English-Effective-Use-of-Appropriate-Alternatives.pdf?ver=2016-09-13-141050-207>.
26. *Detention and Reintegration Working Group—Workshop on Education, Life Skill Courses and Vocational Training for Incarcerated Violent Extremist Offenders, Co-Chairs' Summary*. 7–8 October, 2015. <https://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2015/10/15Nov18-GCTF-DRWG-Co-Chairs-Summary-Workshop-7-8-October-Nairobi.pdf>.

27. *Rome Memorandum on Good Practices for Rehabilitation and Reintegration of Violent Extremist Offenders*. 2012. <https://www.thegctf.org/Portals/1/Documents/Framework%20Documents/A/GCTF-Rome-Memorandum-ENG.pdf>.

Instituti Ndërkombëtar për Drejtësi dhe Sundimin e Ligjit

28. *International Institute for Justice and the Rule of Law. Prison Management Recommendations to Counter and Address Prison Radicalization*. 2015. <https://theiij.org/wp-content/uploads/Prison-Recommendations-FINAL-1.pdf>.

Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë

29. *Understanding Referral Mechanisms in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism and Violent Extremism: Navigating Challenges and Protecting Human Rights—A Guidebook for South-Eastern Europe*. 2019. <https://www.osce.org/secretariat/418274?download=true>.
30. OSBE dhe ODIHR *Guidelines for Addressing the Threats and Challenges of “Foreign Terrorist Fighters” within a Human Rights Framework*. 2018. <https://www.osce.org/odihr/393503>.
31. *ODIHR and Penal Reform International, Guidance Document on the Nelson Mandela Rules: Implementing the Revised Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners*. 2018. <https://www.osce.org/odihr/389912?download=true>.
32. *The Role of Civil Society in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: A Focus on South-Eastern Europe*. 2018. <https://www.osce.org/secretariat/400241?download=true>.
33. *Preventing Terrorism and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism: A Community-Policing Approach*. 2014. <https://www.osce.org/secretariat/111438?download=true>.

Organizata e Kombeve të Bashkuara

34. Organizata e Kombeve të Bashkuara. Key Principles for the Protection, Repatriation, Prosecution, Rehabilitation and Reintegration of Women and Children with Links to United Nations Listed Terrorist Groups. April 2019.
35. United Nations General Assembly. United Nations Resolution 10/75, Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners (The Nelson Mandela Rules). RES/70/75. 2015. <https://cdn.penalreform.org/wp-content/uploads/1957/06/ENG.pdf>.
36. United Nations Centre on Counter-Terrorism (UNCCT) and United Nations InterRegional Crime Institute (UNICRI). *Additional Guidance on Aftercare and Reintegration Programmes for Violent Extremist Offenders*. 2014. <https://toolkit.thegctf.org/Portals/1/Documents/En/Additional-Guidance-on-Aftercare-and-Reintegration-Programmes-for-VEO.pdf>.

37. United Nations Counter-Terrorism Committee Executive Directorate (UNCTED). *Analytical Brief: The Repatriation of ISIL-Associated Women*. September 2019. https://www.us2.list-manage.com/track_click?u=8343c3b932a7be398ceb413c9&id=9138ee934f&e=55e0563485.
38. UNCTED. *Analytical Brief, The Repatriation of ISIL-Associated Children*, September 2019, <https://www.un.org/sc/ctc/wp-content/uploads/2019/09/CTED-Analytical-Brief-Repatriation-of-Children.pdf>
39. UNCTED. Research Digest, issue 5. January 2019. <https://us2.campaign-archive.com/?u=8343c3b932a7be398ceb413c9&id=13afc5ab5e/?u=8343c3b932a7be398ceb-413c9&id=13afc5ab5e&awesome=no&e=#FTF>.
40. UNCTED. *Trends Alert, Concern at Potential Risks Posed by the Forthcoming Release of Imprisoned FTFs*. July 2018. https://www.un.org/sc/ctc/wp-content/uploads/2018/07/Trends_Alert_July_2018.pdf.
41. United Nations Counter-Terrorism Implementation Task Force, Working Group on Promoting and Protecting Human Rights and the Rule of Law while Countering Terrorism. *Guidance to States on Human Rights-Compliant Responses to the Threat Posed by Foreign Fighters*. 2018. <https://www.ohchr.org/EN/newyork/Documents/Human-Rights-Responses-to-Foreign-Fighters-web%20final.pdf>.
42. United Nations Inter-Regional Crime Institute and Government of Spain. *Building on the GCTF's Rome Memorandum: Additional Guidance on the Role of Religious Scholars and Other Ideological Experts in Rehabilitation and Reintegration Programmes*. https://toolkit.thegctf.org/Portals/1/Documents/En/UNICRI_SPAIN_Religious_Scholars_in_Rehab.pdf.
43. United Nations Office of Counter-Terrorism. *Handbook—Children Affected by the Foreign-Fighter Phenomenon: Ensuring a Child Rights-Based Approach*. 2019. https://www.un.org/counterterrorism/ctitf/sites/www.un.org.counterterrorism.ctitf/files/ftf_handbook_web_reduced.pdf.
44. United Nations Office on Drugs and Crime. *Handbook on Children Recruited and Exploited by Terrorist and Violent Extremist Groups: The Role of the Justice System*. 2017. https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/ChildVictims/Handbook_on_Children_Recruited_and_Exploited_by_Terrorist_and_Violent_Extremist_Groups_the_Role_of_the_Justice_System.E.pdf.
45. ———. *Handbook on the Management of Violent Extremist Prisoners and the Prevention of Radicalization to Violence in Prisons*. 2016. https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/Handbook_on_VEps.pdf.
46. ———. *Key Principles and Recommendations for the Management of Violent Extremist Prisoners and the Prevention of Radicalization to Violence in Prisons*. 2016. https://www.unodc.org/pdf/criminal_justice/Summary-of-recommendations-on-VEps.pdf.

47. ———. *Introductory Handbook on the Prevention of Recidivism and the Social Reintegration of Offenders*. 2012. https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/Introductory_Handbook_on_the_Prevention_of_Recidivism_and_the_Social_Reintegration_of_Offenders.pdf.
48. *Security Council, Counter-Terrorism Committee, 2018 Addendum to the 2015 Madrid Guiding Principles*, 2018, https://www.un.org/sc/ctc/wp-content/uploads/2018/12/2018-Addendum-to-the-2015-Madrid-Guiding-Principles_as_adopted.pdf.

Organizata joqeveritare dhe subjekte të tjera

49. Dean, Christopher, and Eelco Kessels. *Compendium of Good Practices in the Rehabilitation and Reintegration of Violent Extremist Offenders*. Global Center on Cooperative Security. 2018. <https://www.veocompendium.org/download.html>.
50. Nemr, Christina, Lara Nonninger, Eva Entenmann, Fulco van Deventer, and Bibi van Ginkel. *It Takes a Village: An Action Agenda on the Role of Civil Society in the Rehabilitation and Reintegration of Those Associated With and Affected by Violent Extremism*. Global Center on Cooperative Security; International Centre on Counter-Terrorism – The Hague. 2018, p. 24. https://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2018/08/GC_It-Takes-a-Village_WEB.pdf.
51. Global Solutions Exchange, *Improving PVE Practice—10 Steps to Strengthening Rehabilitation and Reintegration Efforts for Terrorism Offenders, Returning Foreign Terrorist Fighters, and Victims of Violent Extremism*. 2017. <http://www.icanpeacework.org/wp-content/uploads/2018/05/GSX-Ten-Steps-to-Strengthening-Rehabilitation-and-Reintegration-2017.pdf>.
52. Hedayah and the International Institute for Justice and the Rule of Law. *Malta Principles for Reintegrating Returning Foreign Terrorist Fighters (FTFs)*. 2016. <http://www.hedayahcenter.org/Admin/Content/File-26102016223519.pdf>.
53. International Civil Society Action Network (ICAN) and United Nations Development Programme (UNDP). *Invisible Women: Gendered Dimensions of Return, Rehabilitation and Reintegration from Violent Extremism*. 2019. <http://www.icanpeacework.org/wp-content/uploads/2019/02/ICAN-UNDP-Rehabilitation-Reintegration-Invisible-Women-Report-2019.pdf>.

SHTOJCA 2:

Shembuj nga qasje të ndryshme për R&R jashtë kontekstit të burgut në rajonin e OSBE-së

BELGJIKË

Brussels Prevention Service (në nivel bashkie)

Njësia kundër radikalizimit e **Bruxelles Avance Brussel Vooruit (BRAVVO)**²²⁸ përbëhet nga pesë pjesëtarë të personelit me kohë të plotë - një specialist ligjor/i shkencave politike; një psikolog klinik; një punonjës social; një ekspert i fesë krahasuese; dhe një ekspert sociolog/i arsimit - dhe është e lidhur me një rrjet të gjerë të ofruesve të shërbimeve në qytet. Njësia punon në hapësirat e parandalimit parësor, dytësor dhe tretësor, ku objektivat e saj janë menaxhimi i rreziqeve psikologjike dhe të sigurisë të individëve të përfshirë në dhunë ekstremiste dhe reduktimi i ndikimit të ekstremizmit të dhunshëm në disa lagje duke rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm dhe duke forcuar faktorët mbrojtës të të rinjve vulnerabël dhe prindërve të tyre. Veprimtaritë e saj përfshijnë dhënien e informacionit komuniteteve mbi radikalizimin në dhunë, trajnimin e profesionistëve se si të dallojnë shenjat e vulnerabilitetit ndaj radikalizimit dhe si t'i trajtojnë ato, vlerësimin e vulnerabiliteteve individuale dhe ofrimin e shërbimeve “mbështjellëse” - duke ofruar mbështetje për të gjitha aspektet e nevojshme për individin - nëpërmjet rrjetit të ofruesve të ndërhyrjeve. Njësia ka rregulla transparente për kohën kur dhe mënyrën si do të ndodhin ndërhyrjet, protokolle transparente për shkëmbimin e informacionit, dhe fleksibilitet për të mundësuar që burimet të shpërndahen sipas nevojave të identifikuara. Gjithashtu, cakton një drejtues skuadre për secilin rast, ndërkohë që linjat e komunikimit midis anëtarëve të skuadrës janë të qarta.

Ndërhyrja terciare BRAVVO-s, ose R&R, realizohet sipas strategjisë kombëtare të Belgjikës kundër terrorizmit 2005, ku pjesa më e madhe e rasteve në këtë fushë i referohen nga njësi të posaçme lokale të fokusuar te siguria, të cilat janë krijuar në çdo bashki në të gjithë vendin sipas strategjisë.²²⁹

228 Për më tepër informacion mbi BRAVVO-n, vizitoni faqen e saj të internetit <https://www.brussels.be/prevention-service-bravvo>.

229 European Forum for Urban Security (EFUS), “Practice Sheet”, https://efus.eu/files/2016/10/PS_Brussels_RadicalisationUnit_EN.pdf.

DANIMARKA

Aarhus (në nivel bashkie)

Programi i Aarhus-it, ashtu si programet P/CVERLT në bashki të tjera në Danimarkë, trajton të gjitha llojet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit dhe bazohet në një bashkëpunim të sistematizuar midis shumë agjencive që ka evoluar përgjatë një dekade midis ofruesve të ndryshëm të shërbimeve sociale, sistemit arsimor, sistemit të kujdesit shëndetësor, policisë dhe shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë.²³⁰ Policia lokale është agjencia që udhëheq zbatimin, megjithëse programi përfshin bashkëpunimin midis bashkisë dhe policisë. Që prej vitit 2014, programi është bërë i disponueshëm për “LHT”-të e kthyer mbi baza vullnetare, me kushtin që të mos kenë kryer krime dhe të jenë analizuar dhe vlerësuar se nuk përbëjnë rrezik për komunitetin. Ky model funksionon me efektshmëri ndërkohë që ruan një linjë të hapur komunikimi midis LHT-ve të kthyer dhe qeverisjes vendore dhe konsiderohet si një faktor kyç për rindërtimin e besimit. Aarhus-i i mbështet pjesëmarrësit të gjejnë punë dhe strehim, ofron këshillim psikologjik (për t'i ndihmuar me trajtimin e PTSD-së_ dhe kujdes mjekësor falas, si dhe ofron mbështetje për familjen.

Mentorë të trajnuar posaçërisht (përfshirë ish xhihadistë) luajnë një rol si persona reference për të kthyerit dhe i mbështesin ata jo vetëm për t'u kthyer në një jetë të rregullt por u japin edhe këshillime fetare. Qëllimi nuk është që të kthyerit të detyrohen të heqin dorë nga besimi, por të inkurajohet një pozitë mendimi më e nuancuar.

Back on Track (nivel kombëtar)

Fillimisht i financuar nga Bashkimi Evropian nga viti 2011 deri në vitin 2014, Back on Track është tani një prej programeve të ofruara nga Shërbimet Daneze të Burgjeve dhe të Provës për personat që janë të akuzuar apo të dënuar për vepra që lidhen me terrorizmin, ata veprat e të cilëve ishin të lidhura me urrejtje për një grup tjetër, dhe ata të burgosur që çmoheshin si vulnerabël ndaj radikalizimit në ekstremizëm të dhunshëm.²³¹

Qëllimi i programit të mentorimit është që t'i ndihmojë të burgosurit të jenë më të aftë të përballen me situatat dhe problemet e përditshme, dhe me konfliktet në mënyrë që t'i parandalojë ata të kryejnë në të ardhmen vepra të ekstremizmit të dhunshëm. Roli i mentorit është të mbështesë dhe forcojë motivimin e të burgosurit për të zgjedhur në stil jete i lirë nga krimet, dhe për të ndërtuar marrëdhënie të reja në mjedise jo kriminale dhe pa ekstremizëm të dhunshëm.

230 Për hollësi mbi programin Aarhus, shih EU RAN, *Aarhus Model: Prevention of Radicalisation and Discrimination in Aarhus*, https://ec.europa.eu/home-affairs/node/7423_en. Për përpjekjet P/CVERLT në vendet nordike më në përgjithësi, shih Ramboll (for the Danish Ministry of Immigration and Integration), *Efforts to Prevent Extremism in the Nordic Countries*, Dhjetor 2017, <https://uim.dk/publikationer/efforts-to-prevent-extremism-in-the-nordic-countries>.

231 Për më shumë informacion mbi Back on Track, shih https://ec.europa.eu/home-affairs/node/7411_en.

mjedise. Fokusi vendoset te përfshirja e familjes së të burgosurit dhe rrjeti shoqëror jashtë burgut, duke u dhënë atyre një rol aktiv gjatë vuajtjes së dënimit në burg dhe riintegrit të individit.

Gjatë riintegrit, mentorët fokusohen te ndihma për t'u përballur me sfidat praktike të cilat hasin personat pas lirit. Kjo mund të përfshijë dhënien e ndihmës për të gjetur një vend për të jetuar, për arsimimin, apo për të gjetur një punë si dhe për ndërtimin e rrjeteve të reja shoqërore. Mentorët trajnohen për teknika të ndryshme dialogu, për udhëheqje dhe aftësi për menaxhimin e konfliktit si dhe për angazhimin e familjes. Ata marrin gjithashtu njohuri mbi radikalizimin në VERLT në mënyrë që të kuptojnë më mirë personat të cilët i këshillojnë dhe të jenë në gjendje të përgatisin e përshtatsin ndërhyrjen sipas rastit.²³²

FINLANDA

RADINET (partneritet publik-privat i udhëhequr nga një OJQ)

Nisur si pjesë e planveprimit kombëtar 2016 për parandalimin e ekstremizmit, ²³³ RADINET-i është një shërbim daljeje i zbatuar nga Vuolle Setlementti Vuolle, një shoqatë jofitimprurëse, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme Finlandeze dhe organizata dhe institucione të tjera që punojnë me individë që janë përfshirë në grupe ekstremiste të dhunshme me arsye politike apo fetare, por që kanë vendosur të largohen nga grupi.²³⁴ Disa janë ende të përfshirë por po mendojnë të largohen. Fokusi është te shkëputja nga dhuna dhe riintegritimi.

Grupi drejtues përfshin përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, komuniteteve fetare, OJQ-ve, institucioneve që ofrojnë shërbime, dhe autoriteteve vendore. Grupi vlerëson rreziqet dhe nevojat e individëve që kërkojnë të shkëputen nga VERLT dhe më pas ndihmon për organizimin e shërbimeve të nevojshme dhe për mbështetje të natyrave të tjera, përfshirë mentorimin për të mbështetur shkëputjen nga dhuna e motivuar prej ideologjisë. Pjesëmarrja në program, i cili financohet nga Ministria e Brendshme, është me dëshirë. Është vënë re se pasja e një OJQ-je si fytyrë të kësaj nisme ka qenë e rëndësishme për të fituar besimin e pjesëmarrësve, të cilët me gjasë do të ishin më pak të gatshëm të merrnin pjesë në një nismë për shkëputje dhe ri-integritim të udhëhequr nga qeveria.²³⁵

232 GCCS, *Compendium of Good Practices*, f. 45; and Danish Department of Prisons and Probation and Danish Ministry of Children, Gender Equality, Integration and Social Affairs, "Back on Track: A Pilot Project on the Prevention of Radicalization among Inmates," June 2014, https://www.kennisplein.be/Documents/Back%20on%20Track_Denemarken.pdf.

233 Ministria e Brendshme e Finlandës, *National Action Plan for Prevention of Terrorism and Violent Extremism*, 2016, http://julkaisut.valtioneuvosto.fi/bitstream/handle/10024/75040/Kansallinen_vakival_radikalisoituminen_eng_NETTI.pdf.

234 Për më shumë informacion rreth RADINET, shih <https://vuolleoulu.fi/hyvinvointi-ja-yhteistyo/asiantuntijuutta-ja-osallisuutta/kehittamisty-ja-hankkeet/radinet-hanke/>.

235 Ministria e Brendshme e Finlandës, Propozim për Rregullimin e Bashkëpunimit Ndërsëktorial për Menaxhimin e të Kthyerve nga Konflikti Zones: Including a Proposal for Combining NGOs' Services with the Action of the Authorities, 2017, f. 25. <http://julkaisut.valtioneuvosto.fi/bitstream/handle/10024/79612/Palaajat%20enkku.pdf>.

Nisma Financohet nga Slot Machine Finlandë. Shoqatë, që dha financime për tre vitet e para, por sipas qeverisë, kërkesa për shërbim po i tejkalon burimet e disponueshme.²³⁶

FRANCA

Entr'Autres (OJQ)

Entr'Autres, një OJQ që trajton disa prej rasteve të deradikalizimit në Francë, punon me individë të radikalizuar në përpjekje për të hequr ideologjinë xhihadiste dhe për shkëputje nga dhuna. Ajo fokusohet te forcimi i lidhjeve me familjen dhe i ndihmon klientët të sigurojnë punësim dhe të risocializohen si pjesë e përpjekjeve të saj për të lehtësuar riintegrimin në komunitet. Puna e Entr'Autres bazohet te të kuptuarit më së pari të arsyeve që shtynë individin drejt radikalizimit në dhunë (p.sh. faktorë psikologjikë, krizë në familje, çështje identiteti, bindje fetare ose ideologjike), dhe më pas në dhënien e ndërhyrjeve të përshtatura sipas rastit në bazë të informacionit për këto motive.²³⁷

Hulumtim dhe Ndërhyrje për Ekstremizmin e Dhunshëm (OJQ)

Hulumtim dhe Ndërhyrje për Ekstremizmin e Dhunshëm (RIVE), e cila ka 10 anëtarë në personelin e saj, është një degë e Shoqatës për Politikën e Aplikuar Kriminale dhe Riintegrimin Social (APCARS),²³⁸ një OJQ franceze e specializuar në fushat e të drejtës sociale, rehabilitimit social, mbështetjes për viktimat, dhe drejtësinë restauruese dhe vepron në Paris dhe Marsejë. Me financime nga Ministria franceze e Drejtësisë, RIVE përdor një qasje mentorimi që ka për synim deradikalizimin dhe riintegrimin social; objektivi i saj janë individët mbi 18 vjeç që janë akuzuar për kryerjen e një veprë terroriste apo që janë identifikuar nga shërbimi i provës se janë radikalizuar në fazën para apo pas dënimit. Programi Exit, i cili është i hartuar për të trajtuar të gjitha format e VERLT-it, zgjat për një vit dhe përdor një qasje mentorimi të përshtatur sipas rastit dhe që zbatohet nga një skuadër që mbulon shumë disiplina me anëtarët e saj që janë edukatorë, psikologë, këshillues fetarë, një psikiatër, dhe një jurist penal.

236 Po aty, f. 42.

237 Shih https://ec.europa.eu/home-affairs/node/11455_en.

238 Për më shumë informacion rreth APCARS, shih <http://www.apcars.fr/en/>.

Programi zbatohet sipas një vendimi gjyqësor (d.m.th. nuk është mbi baza vullnetare) në bashkëpunim me shërbimin e provës jashtë kontekstit të burgut. Ndërhyrjet përcaktohen pas një procesi tremujor për mbledhjen e informacionit që përfshin vendosjen e kontaktit me familjen dhe rrethin shoqëror të individit, dhe vlerësimin e rrezikut dhe nevojave që realizohet në fund të procesit. Çdo muaj, RIVE, së bashku me shërbimin e provës, bën vlerësimin e çdo rasti.²³⁹

GJERMANIA

Hayat (OJQ si pjesë e një partneriteti publik-privat)

Hayat (në turqisht dhe arabisht do të thotë “jetë”) është programi i parë gjerman për këshillim për personat e përfshirë në grupet radikale salafiste ose që janë në rrugën e radikalizimit të dhunshëm xhihadist, përfshirë ata që udhëtojnë në Siri apo zona të tjera luftimi.²⁴⁰ Hayat është i disponueshëm për prindërit, vëllezërit dhe motrat, shokët, mësuesit, punëdhënësit, dhe këdo tjetër që ka një marrëdhënie me personin potencialisht në rrugën drejt një radikalizimi (të dhunshëm). Më tej, Hayat punon drejtpërdrejt me personat e radikalizuar me qëllim që të demonstrojë parakushtet dhe mundësitë për të ndërprerë sjelljen radikale dhe për të braktisur grupet dhe ideologjitë radikale. Që prej janarit 2012, Hayat është partnere e Zyrës Federale për Migracionin dhe Refugjatët , e cila ka ngritur një linjë të dedikuar kombëtare këshillimi për radikalizimin.

Kërkesat për asistencë mund t'i drejtohen drejtpërdrejtë Hayat-it me anë të telefonit apo e-mailit. Me marrjen e kërkesës, Hayat-i bën vlerësimin e parë. Nëse nevojitet ndërhyrje këshillimi, Hayat-i vlerëson nëse kërkohet edhe pjesëmarrja e një pale të tretë. Hayat-i lidh personat që e kontaktojnë me institucione dhe shërbime që mund të jenë në gjendje t'i ndihmojnë, në varësi të situatës (p.sh., shkolla, shërbime sociale, dhe, disa herë, shërbimi i provës dhe policia). Ndërhyrjet e këshillimit, nëse janë të nevojshme, ndryshojnë në varësi të rastit. Mbështetja për familjen është gjithashtu një pjesë e rëndësishme e punës.²⁴¹ Ajo pranon se “ekstremistët janë të vështirë për t'u bindur kur bindjet e tyre janë të rrënjosura në teologji; për këtë arsye, ndërhyrja e drejtpërdrejt nga një i huaj, edhe kur është një këshillues tejet i trajnuar i Hayat-it, nuk ka gjasë të ketë sukses. Ndërsa familjet janë zakonisht lidhja më e mirë emocionale me individin. Marrëdhëniet pozitive janë aseti.”²⁴² Hayat-i garanton të drejtat dhe sigurinë e atyre që e kontaktojnë si dhe konfidencialitetin e komunikimeve. Megjithatë, ajo i kontakton shërbimet e sigurisë nëse përfshirja e tyre duket e nevojshme, ndonëse gjithmonë pasi ka informuar më parë familjet. Hayat-i i inkurajon familjet t'i kontaktojnë vetë agjencitë e sigurisë.

239 RAN, *Preventing Radicalization to Terrorism and Violent Extremism, Exit Strategies, Approaches and Practices Collection*, 2018, f. 48–49, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/docs/exit_strategies_en.pdf.

240 Për më shumë hollësi, shih <https://hayat-deutschland.de/english/>. 241 EFUS, “Practice Sheet”.

242 Cities of Migration, “Hayat Means Life”, 12 February 2015, https://citiesofmigration.ca/good_idea/hayat-means-life/.

Rrejt i Parandalimit të Dhunës (OJQ si pjesë e partneritetit publik - privat)

Rrejt i Parandalimit të Dhunës (VPN) është një OJQ gjermane e themeluar në vitin 2004. Ajo është pjesë e rrjetit kombëtar të këshillimit për deradikalizim, i ngritur nga Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët.²⁴³ Qendrat e këshillimit të VPN-së, të ngritura në një numër vendesh në Gjermani, janë projektuar për të arritur të gjithë personat që kërkojnë këshilla apo mbështetje për trajtimin e ekstremizmit të motivuar mbi baza fetare. Shtatëdhjetë nga 125 anëtarët e saj të stafit që punojnë me kohë të plotë janë praktikues të vijës së parë në terren. Mbështetur me fonde federale, shtetërore si dhe nga Komisioni Evropian, VPN-ja trajton radikalizimin si të ekstremit të djathtë edhe atë islamist për parandalimin (përfshirë trajnimin dhe seminare për profesionistët dhe vullnetarët në shkolla, qendra refugjatës, dhe OJQ), ndërhyrjen, dhe programe deradikalizimi/daljeje si brenda dhe jashtë kontekstit të burgut për të rinj dhe persona madhorë.

VPN-ja ka punuar vazhdimisht me 250 raste individuale që prej vitit 2016, pjesa më e madhe e tyre përfshijnë persona me historik ekstremist islamist. Programe të tjera janë hartuar për të këshilluar të afërmit e autorëve dhe ish autorëve dhe ata që kanë udhëtuar në zona luftimi (dhe janë kthyer) ose që kanë interes për grupe grupe ekstremiste të dhunshme.

Vizioni i VPN-së është që personat ideologjikisht vulnerabël dhe autorët e dhunshëm të motivuar nga ekstremizmi të mund të ndryshojnë sjelljen nëpërmjet një procesi të udhëhequr deradikalizimi dhe të bëhen pjesë e komunitetit demokratik. VPN-ja punon për të siguruar që njerëzit të kenë instrumentet dhe burimet për të pasqyruar dhe për të kapërcyer modelet e mëparshme të sjelljes. Qëllimi është që t'u mundësojë atyre një jetë në të cilën nuk dëmtojnë veten apo të tjerët.

VPN-ja ka punuar me shumë njerëz që janë dënuar për vepra terroriste, duke vepruar në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet përkatëse. Për këtë qëllim, VPN-ja ka hartuar udhëzime për sigurinë në bashkëpunim me autoritetet e sigurisë për çdo qendër këshillimi për të garantuar që punonjësit e të rinjve dhe vetë të rinjtë e përfshirë të mbeten të mbrojtur gjatë gjithë procesit të mentorimit. Udhëzimet e sigurisë përcaktojnë rregullat bazë dhe vijat e kuqe, si dhe kushtet, themelet ligjore, dhe parimet e mbrojtjes së të dhënave sipas të cilave do të duhet të ndodhë raportimi pranë autoriteteve të sigurisë.²⁴⁴

243 Për më shumë hollësi, shih faqen e internetit të VPN-së, <http://www.violence-prevention-network.de/en/>. Për një vlerësim të 2017 për rrjetin dhe Qendrën Këshillimore për Radikalizimin, që mbështet VPN, shih Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët, Qendra Kërkimore – Migracioni, Integrimi dhe Azili, *Final Report*, Research Report 31, 2017, https://www.academia.edu/38447362/Evaluation_of_the_Advice_Centre_on_Radicalisation_-_final_report.

244 EU RAN, *Foreign Fighter Returnees & the Reintegration Challenge*, RAN Issue Paper, November 2016, f. 7, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_foreign_fighter_returnees_reintegration_challenge_112016_en.pdf.

VENDET E ULËTA

Qendra për Mbështetjen e Familjes (nivel kombëtar)

Krijuar në fund të vitit 2015 si pjesë e planveprimit kombëtar të subvencionuar nga qeveria për t'iu kundërvënë terrorizmin e frymëzuar nga xihadi,²⁴⁵ Qendra për Mbështetjen e Familjes jep informacion të specializuar, këshilla, dhe mbështetje për ata që janë të shqetësuar për një pjesëtar të familjes që është radikalizuar.²⁴⁶ Ajo plotëson punën e Dutch Exit Centre, Forsa (shih më poshtë). Qendra për Mbështetjen e Familjes mbledh së bashku punonjës të shëndetit, psikiatër, mentorë, hulumtues, teologë dhe ekspertë nga fusha të tjera, të cilët takohen dy herë në javë për të diskutuar rastet. Ky model ruan një kanal të hapur komunikimi midis Qendrës, anëtarëve të familjes që janë të përfshirë, si dhe autoritetet e qeverisjes vendore, duke respektuar rregulla të rrepta të privatësisë, dhe informacioni shkëmbehet midis autoriteteve të qeverisjes vendore ose policisë kur ekziston një rrezik për sigurinë apo pasi familja ka dhënë lejen. Së pari, programi bën një vlerësim të nevojave dhe rrezikut, i cili pasohet nga hartimi i një plani për ndërhyrje në bashkërendim me anëtarët e familjes dhe autoritetin vendor. Një person i caktuar nga Qendra koordinon të gjitha aspektet e zbatimit të ndërhyrjes. Pjesëmarrja është me dëshirë, dhe rastet referohen, në mënyrë tipike, nëpërmjet njësisë së qeverisjes vendore.²⁴⁷

Forsa (nivel kombëtar)

Edhe Forsa është ngritur si pjesë e planveprimit 2015 të subvencionuar nga qeveria dhe jep mbështetje për personat në moshë madhore dhe të rinjtë që ushqejnë bindje ekstremiste apo që janë ose kanë qenë përfshirë në rrjete ekstremiste. Kjo audiencë e synuar përfshin ata që tërhiqen nga rrjete ekstremiste, njerëz që janë në kontakt me anëtarë aktivë të një rrjeti ekstremist, dhe njerëz që janë larguar nga një rrjet ekstremist dhe kanë pasur vështirësi për të rindërtuar jetën e tyre. Pjesëmarrja është me dëshirë. Forsa punon së bashku me partnerë lokalë në rajonin ku jetojnë individët, të tillë si autoritete të qeverisjes vendore, ofrues të kujdesit shëndetësor, partnerë të sigurisë, dhe partnerë nga gjyqësori, për të hartuar dhe mbështetur ndërhyrje që janë të përshtatura sipas rastit.

Shërbimet dhe mbështetje të tjera të dhëna nga organizata përfshijnë “inkurajim i reflektimit kritik; këshillim për traumat; fuqizim në lidhje me rrjetin/ish-rrjetet;

245 The Netherlands Comprehensive Action Programme to Combat Jihadism, “Overview of Measures,” August 2014, <https://www.firstlinepractitioners.com/sk/practice/the-netherlands-comprehensive-action-programme-to-combat-jihadism>.

246 Shih faqen e internetit në gjuhën hollandeze të Qendrës për Mbështetjen e Familjes (Family Support Centre), <https://www.landelijksteunpuntextremisme.nl/?lang=en>. 247 Shih, për shembull, Katalogun e programeve për LHT-të në faqen e internetit të Hedayah, <http://www.hedayahcenter.org/ftfprograms/program/family-support-unit-radicalization/>; and EU RAN, *Working with Families and Safeguarding Children from Radicalization: Step-by-Step Guidance Paper for Practitioners and Policy-makers*, RAN Ex Post Paper, February 2017, p. 18, https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-h-and-sc/docs/ran_yf-c_h-sc_working_with_families_safeguarding_children_en.pdf.

përballja me përvojat në zonat e luftës; inkurajimi i lidhjeve sociale nëpërmjet punës/studimit/vendosjeve në punë; ndërtimi/rindërtimi i rrjetit shoqëror; riparimi i marrëdhënieve familjare; forcimi i rezistencës; inkurajimi dhe nxitja e të qenit i hapur ndaj çështjeve filozofike dhe ideologjike.” Programi i Forsas mund të përfshijë punën një-me-një, ndërtimin ose rindërtimin e rrjeteve shoqërore, këshillimin për zhvillimin e karrierës ose atë akademik, menaxhim i zemërimit, dhe/ose ndihmë psikologjike.²⁴⁸

SUEDIA

EXIT Sweden – Fryshuset (OJQ)

Mbështetur më së pari me grante qeveritare dhe pjesë e një qendre për të rinjtë, EXIT Sweden ndihmon individë që të shkëputen nga grupet e supremacisë së bardhë dhe i ndihmon ata për ri-integrim social.²⁴⁹ Deri tani, programi nuk është zgjeruar ende që të përfshijë edhe forma të tjera të VERLT-it, në një masë të madhe për shkak të kufizimeve në financim. Ai zbatohet në bazë vullnetare, duke reflektuar bindjen e programit se në mënyrë që një process shkëputjeje të jetë i qëndrueshëm dhe i suksesshëm do të duhet që vetë individi të kërkojë ndryshim. Nëpërmjet qasjeve të individualizuara, të përshtatura sipas rastit, programi i ndihmon pjesëmarrësit të rivendosin kontakte me familjen dhe shokët e miqtë, të forcojë aftësitë e tyre për jetë sociale, të përballen me konfliktin në një mënyrë paqësore dhe, më e rëndësishmja, të ri-integrohen në rrjedhën e shoqërisë, përfshirë duke gjetur një punë të re. Ndonëse i përshtatur për secilin individ, puna shpesh fokusohet te ndihma për klientin që të ndërtojë një identitet të ri social dhe të largohet, në këtë mënyrë, nga ai i mëparshmi ekstremist. Programi ofron takime personale, siguron një person kontakti (që, nëse është e nevojshme, është i disponueshëm 24/7), dhe lehtëson kontaktet me agjenci qeveritare, përfshirë ato që mund të ndihmojnë për strehimin, shërbimet sociale, dhe shërbimet ligjore, si dhe policinë. Exit Sweden ofron këshillim edhe për prindërit, vëllezërit dhe motrat, partnerët, si dhe të tjerë persona të afërt me klientët.

Përtej punës me rastet individuale, Exit Sweden kërkon të edukojë të rinjtë për mënyrën se si lëvizjet e dhunshme organizohen dhe janë në gjendje të radikalizojnë individë të ndryshëm dhe ka përgatitur dy manuale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe shkëputjen nga grupe ekstremiste të dhunshme. Programi bashkëpunon edhe me tatarin lokal dhe jep shfaqje për angazhimin dhe shkëputjen nga grupet e supremacisë së bardhë si dhe tema të tjera të ngjashme.²⁵⁰

248 Në emër të Koordinatorit Kombëtar për Sigurinë dhe Anti-Terrorizmin u realizuar një vlerësim i pavarur i Forsës dhe i Qendrës për Mbështetjen e Familijes dhe u publikua në nëntor 2018; ai mund të gjendet te <https://www.landeljksteunpextremisme.nl/mediadepot/1702325ce56c/EvaluationofForsaandtheFamilySupportCentre.pdf>.

249 Për hollësi, shih faqen e internetit të EXIT Sweden – Fryshuset, <http://exit.fryshuset.se/english/>.

250 EXIT Sweden – Fryshuset, https://ec.europa.eu/home-affairs/content/exit-sweden_en.

EXIT Sweden zbaton rregulla të rrepta për privatësinë, “duke rezervuar të drejtën që të mos u japë autoriteteve dhe të mos regjistrojë ndonjë informacion për ata me të cilët punën si dhe për veprimtarinë e tyre në të shkuarën, një praktikë që ka për synim “sigurimin e shkëputjes së disa ekstremistëve që përndryshe do të mbeteshin brenda lëvizjes për të shmangur ndëshkimin ligjor.”²⁵¹

MBRETËRIA E BASHKUAR

Programi për ndërprerjen e përfshirjes dhe shkëputjen (nivel kombëtar)

Ashtu siç është përshkruar në strategjinë antiterrorizëm të Mbretërisë së Bashkuar, CONTEST, e përditësuar në 2018,²⁵² Programi për ndërprerjen e përfshirjes dhe shkëputjen (DDP) fokusohet te individët që u nënshtrohen kushteve të miratuara nga gjykata, përfshirë të gjithë autorët e veprave terroriste dhe të veprave që lidhen me terrorizmin në shërbim prove, si dhe te Masat Hetuese për Parandalimin e Terrorizmit (TPIM)²⁵³ dhe ata që janë kthyer nga zona konflikti në Siri ose Irak dhe janë subjekt i Urdhërave të Përgjithshme të Përkohshme (TEO)²⁵⁴.

Me një objektiv të gjerë për një qasje tërësore ndaj shkëputjes, programi që përfshin shumë aktorë zbatohet së bashku me agjenci të ndryshme dhe partnerë të tjerë, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, policinë dhe Shërbimin e Burgjeve dhe të Provës, si dhe OJQ. Me anë të një game të gjerë ndërhyrjesh intensive dhe të përshtatura sipas rastit, programi synon të trajtojë faktorët shtytës të radikalizimit në ekstremizëm të dhunshëm, të ndërtojë rezistencë, dhe të ndihmojë për rehabilitimin. Mbështetja mund të përfshijë mentorimin, mbështetje psikologjike, si dhe këshilla teologjike dhe ideologjike. Këto ndërhyrje janë hartuar për të dhënë mjetet më të mira të mundshme për këta individë për t’u shkëputur nga terrorizmi dhe të ri-integrohen në mënyrë të sigurt në shoqëri.

251 Nima Khorrami, “Swedish Counter-Radicalization Strategies: An Overview”, European Eye on Radicalization, 3 August 2019, <https://eeradicalization.com/swedish-counter-radicalization-strategies-an-overview/>.

252 Ministria e Brendshme (Home Office) e Mbretërisë së Bashkuar, “Counter-Terrorism Strategy (CONTEST) 2018”, <https://www.gov.uk/government/publications/counter-terrorism-strategy-contest-2018>.

253 TPIM-të e lejojnë Ministrinë e Brendshme (Home Secretary) që të vendosë kufizime për një individ me anë të një njoftimi “TPIM”, që mund të përfshijë kufizime të lëvizjes, veprimtarisë financiare dhe komunikimit. Shih Terror Prevention and Investigation Measures Act në <https://www.gov.uk/government/collections/terrorism-prevention-and-investigation-measures-act>.

254 TEO-të, të cilat zbatohen për personat e dyshuar për përfshirje në veprimtari terroriste jashtë vendit, i lejojnë Ministrinë e Brendshme (Home Secretary) që të ndalojë shtetasit britanikë që të kthehen në atdhe nga një vend tjetër.

DDP-ja vepron së bashku me procese ekzistuese staturore për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, për të siguruar se forcon dispozita ekzistuese. Rastet e terrorizmit shqyrtohen rregullisht me aktorë kyç për të përcaktuar mënyrën më të mirë për të vijuar me administrimin e rrezikut që paraqet një individ, si dhe për të mbështetur rehabilitimin e tyre.²⁵⁵

Në ndryshim nga pjesë të tjera të strategjisë kombëtare CVE të Mbretërisë së Bashkuar (PREVENT), DDP-ja është e detyrueshme në disa raste. Aty ku ka mandatin për individë që i nënshtrohen TEO-ve, TPIM-ve, ose kërkesave për shërbim prove, mosrespektimi mund të çojë në mundësinë e akuzimit për shkelje të kushteve ose rimarrjen në burg. Ndonëse informacioni i disponueshëm është i paktë publikisht lidhur me DDP-në, sipas një raporti, 116 persona ishin subjekt i programit në periudhën tetor 2016 - shtator 2018.²⁵⁶

SHTETET E BASHKUARA

Boston (nivel shteti)

Me mbështetje financiare nga Departamenti i Shtetit për Sigurinë e Brendshme (\$500,000 për dy vjet), Zyra Ekzekutive e Masaçusetsit për Sigurinë Publike ka vendosur partneritet me Departmentin Korrektues në Masaçusets për të zbatuar një projekt që ka për synim parandalimin e përshkallëzimit të dhunës ekstremiste dhe radikalizimit të individëve vulnerabël, duke vendosur besimin dhe duke ndërtuar rezistencën. Ky projekt synon të arrijë 139 burra të njohur se janë individë në rrezik të lartë për ekstremizëm të dhunshëm pas lirimit të tyre nga një burg i sigurisë maksimale. Projekti fokusohet te trajtimi i shkaqeve në themel të ekstremizmit të dhunshëm dhe thekson se forcimi i disa faktorëve mbrojtës dhe i aftësive, si zgjidhja e problemeve dhe trajtimi i konfliktit në një mënyrë jo të dhunshme, mund të nxisin një komunitet të fortë dhe rezistent. Për më tepër, projekti thekson rëndësinë e edukimit, angazhimit pozitiv me komunitetin, lidhjen me familjen dhe miqtë, dhe gjeten e një punësimi të përshtatshëm.²⁵⁷

255 Shih përmbledhje të "Disengagement and Desistance Programme" në <http://www.hampshirepreventboard.org.uk/wp-content/uploads/2016/05/Desistance-and-Disengagement-Programme-Factsheet.pdf>.

256 James Grierson, "Extremists Living in UK under Secretive Counter-Terror Programme," *Guardian*, 5 April 2019, <https://www.theguardian.com/uk-news/2019/apr/05/extremists-living-in-uk-under-secretive-counter-terror-programme>.

257 Departamenti Amerikan për Sigurinë e Brendshme, Zyra për Dhunën e Shënjestruar dhe Parandalimin e Terrorizmit, "Quarterly Update on Programmatic Performance FY16 Countering Violent Extremism (CVE) Grant Program Quarter 5: 1 July to 30 September 2018", https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/19_0703_cve_q4-cve-grant-program-summary.pdf.

Mineapolis (partneritet publik-privat)

I zbatuar nga Zyra Amerikane e Shërbimit të Provës për Distriktin e Minesotës, në bashkëpunim me një OJQ, Heartland Democracy, ai që shpesh përshkruhet si Programi i parë i deradikalizimit në Shtetet e Bashkuara u urdhërua nga një gjykatës federal dhe u hartua me kontribut nga Daniel Koehler, ekspert gjerman për deradikalizimin. Programi ka punuar me 25 ekstremistë të dhunshëm të akuzuar për krime që lidhen me terrorizmin - përfshirë 12 supremacistë të bardhë - që prej fillimit të tij në 2016. Koehler-i ndihmon për identifikimin e faktorëve që kanë çuar në radikalizimin e individëve të përfshirë në program dhe rrezikun që ata të kryejnë sërish këto vepra, si dhe për specifikimin e strategjive për t'i udhëhequr larg ideologjive radikale. Pjesëmarrësit në program janë në lirim të mbikëqyrur sipas urdhërit të një gjyqtari, në vend të dënimit me burg. Programi siguron testim psikologjik dhe këshillim, si edhe mentorim fetar. Një theks i veçantë vendoset te strategjitë e riintegritimit në komunitet me qëllim arritjen e një balance midis sigurisë publike dhe rehabilitimit. Programi synon të forcojë lidhjet me anëtarët e familjes për të siguruar që pjesëmarrësit të kenë mjedise mbështetëse ku të jetojnë pas kthimit të tyre në komunitet; punon me pjesëmarrësit për edukim të mëtejshëm, trajtim profesional, ose plane punësimi për të rikthyer mundësinë e mbështetjes në burime të veta; i ndihmon të zhvillojnë rrjete të reja shoqërore për t'u larguar nga ndikimet e mëparshme jondërtuese; dhe u jep mundësinë mentorëve në komunitet me njohuri mbi fenë që t'i këshillojnë pjesëmarrësit gjatë lirit të mbikëqyrur.²⁵⁸

258 Brandon Stahl, "Launched after Minnesota Court Cases, First U.S. Deradicalization Program Shows Promise", *Minneapolis Star Tribune*, 19 February 2019, <http://www.startribune.com/country-s-first-deradicalization-program-shows-promise/506069262/>; and Ivy Kaplan, "An Inside Look at the First US Domestic Deradicalization Program", *Defense Post*, 12 February 2019, <https://thedefensepost.com/2019/02/12/us-minnesota-deradicalization-program-inside-look/>.

Burime të OSBE-së

“As Terrorism Trends Are Evolving, We Need to Work Together to Stay One Step Ahead: Main Message from Opening of OSCE Conference in Bratislava”, press release, 25 March 2019, <https://www.osce.org/chairmanship/415163>.

“Chairmanship’s Perception Paper: Recommendations from the 2017 OSCE-wide Counter-Terrorism Conference on Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism”, May 2017, <https://www.osce.org/secretariat/327731?download=true>.

Countering Violent Extremism and Radicalisation that Lead to Terrorism: Ideas, Recommendations, and Good Practices from the OSCE Region, Peter Neumann 28 September 2017, <https://www.osce.org/chairmanship/346841?download=true>.

Declaration on Strengthening OSCE Efforts to Prevent and Counter Terrorism, 9 December 2016, <https://www.osce.org/cio/288176?download=true>.

Ministerial Declaration on Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization that Lead to Terrorism, 4 December 2015, <https://www.osce.org/cio/208216?download=true>.

OSCE Guidebook on Intelligence Led Policing, July 2017, <https://www.osce.org/chairmanship/327476>.

CiO, “The Chairmanship Interlaken Recommendations”, 29 April 2014, <https://www.osce.org/cio/118146?download=true>.

CiO, “The Reverse Flow of Foreign Terrorist Fighters (FTFs): Challenges for the OSCE Area and Beyond”, 10–11 May 2018, Rome, <https://www.osce.org/chairmanship/377557?download=true>.

Representative on Freedom of the Media, “OSCE Media Freedom Representative Welcomes Russian Supreme Court Decisions Protecting Public Discussion of Terrorism, Extremism”, press release, 13 February 2012, <https://www.osce.org/fom/88117>.

Bibliografi

Azinovic, V. *Regional Report: Understanding Violent Extremism in the Western Balkans*. Extremism Research Forum. British Council, 2018. https://www.britishcouncil.me/sites/default/files/erf_report_western_balkans_2018.pdf.

Bonta, J., and D. A. Andrews, *The Psychology of Criminal Conduct*. 6th edition. Routledge, 2017. http://www.episcenter.psu.edu/sites/default/files/community/Lipsey_Effective%20interventions%20-%202009.pdf.

Bosley, C. *Injecting Humanity: Community-Focused Responses for People Existing Violent Extremist Conflict*. Special Report. United States Institute of Peace, 2019. https://www.usip.org/sites/default/files/2019-08/20190822-sr_452-sr.pdf.

Centre for Research and Evidence on Security Threats (CREST). *Deradicalisation Programmes: An Introductory Guide*. Lancaster, UK, 2019.

Cherney, Adrian. "Evaluating Interventions to Disengage Extremist Offenders: A Study of the Proactive Integrated Support Model (PRISM)". *Behavioral Sciences of Terrorism and Political Aggression*. 2018. <https://www.tandfonline.com/doi/pdf/10.1080/19434472.2018.1495661?needAccess=true>.

——— "The Release and Community Supervision of Radicalised Offenders: Issues and Challenges That Can Influence Reintegration". *Terrorism and Political Violence*. 2018. <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/09546553.2018.1530661>.

Christensen, T. W., and T. Bjørge. *How to Manage Returned Foreign Fighters and Other Syria Travelers*. Research Report No. 1. Center for Research on Extremism (C-REX), University of Oslo, 2018.

City of Copenhagen, "Less Radicalisation through an Effective and Coherent Effort: Recommendations of the Expert Group to Prevent Radicalisation". 2015. <https://www.kk.dk/sites/default/files/uploaded-files/Recommendations%20of%20the%20Expert%20Group%20-%20Municipality%20of%20Copenh...pdf>

Choudhury Fink, N., S. Zeiger, and R. Bulai. *A Man's World: Exploring the Roles of Women in Countering Terrorism and Violent Extremism*. Hedayah; Global Center on Cooperative Security, 2016. http://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2016/07/AMansWorld_FULL.pdf.

The Commonwealth, *Supporting Families in Preventing and Countering Violent Extremism*. 2017. <http://thecommonwealth.org/sites/default/files/inline/ComSec%20CVE%20and%20Families%20Presentation.pdf>.

Cook J., and G. Vale. *From Daesh to 'Diaspora' II: The Challenges Posed by Women and Minors After the Fall of the Caliphate*. International Centre for the Study on Radicalisation, 2019. <https://icsr.info/wp-content/uploads/2019/07/ICSR-Feature-From-Daesh-to-%E2%80%9998Diaspora%E2%80%9999-II-The-Challenges-Posed-by-Women-and-Minors-After-the-Fall-of-the-Caliphate.pdf>.

Council of Europe. Commission for Democracy through Law (Venice Commission). “Opinion on the Federal Law on Combating Extremist Activity of the Russian Federation”. Opinion no. 660 / 2011. 2012.

Dean, Christopher. *Addressing Violent Extremism in Prisons and Probation: Principles for Effective Programs and Interventions*. Global Center on Cooperative Security, 2016. <https://www.globalcenter.org/publications/addressing-violent-extremism-in-prisons-and-probation>.

Eisenman, David, and Louise Flavahan. “Canaries in the Coal Mine: Interpersonal Violence, Gang Violence, and Violent Extremism through a Public Health Prevention Lens”. *International Review of Psychiatry* 29, no. 4 (August 2017): 341–49.

European Commission. *High-Level Commission Expert Group on Radicalisation (HLCEG-R). Final Report*. 2018. https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-security/20180613_final-report-radicalisation.pdf.

European Commission Radicalization Awareness Network (RAN) Centre of Excellence. *Prevention of Radicalisation in Germany*. EX POST Paper. 2016

European Parliament. *Child Returnees: Managing the Return of European Children from Jihadist Conflict Zones*. 2018. <https://alde.livecasts.eu/child-returnees-managing-the-return-of-european-children-from-jihadist-conflict-zones>

European Parliament Parliamentary Research Service. *The Return of Foreign Fighters to EU Soil: Ex-Post Evaluation*. 2018. [http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2018/621811/EPRS_STU\(2018\)621811_EN.pdf](http://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2018/621811/EPRS_STU(2018)621811_EN.pdf).

Gielen, A. J. “Exit Programmes for Female Jihadists: A Proposal for Conducting Realistic Evaluation of the Dutch Approach”. *International Sociology*, 2018. <https://journals.sagepub.com/doi/10.1177/0268580918775586>.

Glazzard Andrew, and Martine Zeuthen. *Violent Extremism*. Royal United Services Institute, 2016. https://assets.publishing.service.gov.uk/media/57a0895ae5274a31e00002c/Violent-extremism_RP.pdf

Global Center on Cooperative Security. *Recommendations for the Consideration of the Counter-Terrorism Committee in the Adoption of the 2018 Addendum to the Madrid Guiding Principles*. 2018. https://www.globalcenter.org/wp-content/uploads/2018/11/18Nov28_Recommendations-Addendum-Madrid-Principles.pdf.

Global Solutions Exchange (GSX). “10 Steps to Strengthening Rehabilitation and Reintegration Efforts for Terrorism Offenders, Returning Foreign Terrorist Fighters, and Victims of Violent Extremism”. 2017. <http://www.icanpeacework.org/wp-content/uploads/2018/05/GSX-Ten-Steps-to-Strengthening-Rehabilitation-and-Reintegration-2017.pdf>.

Hedayah and Global Center on Cooperative Security. *Thinking Outside the Box: Exploring the Critical Roles of Sports, Arts, and Culture in Preventing Violent Extremism*. Policy Brief. 2015. <http://www.hedayahcenter.org/Admin/Content/File-23201692017.pdf>.

Hemmingsen, Anne-Sophie. *An Introduction to the Danish Approach to Countering and Preventing Extremism and Radicalization*, Danish Institute for International Studies, 2015. <https://www.ft.dk/samling/20151/almdel/reu/bilag/248/1617692.pdf>.

Hertfordshire Safeguarding Children Partnership (HSCP). “The Role of the Social Worker in Tackling Violent Extremism”. No date. http://hertsscb.proceduresonline.com/pdfs/role_sw_violent_extreme.pdf.

Holmer, Georgia, and Peter Bauman. *Taking Stock: Analytic Tools for Understanding and Designing P/CVE Programs*. United States Institute of Peace, 2018.

Holmer, Georgia, and Adrian Shtuni. *Returning Foreign Fighters and the Reintegration Imperative*. Special Report. United Institute of Peace. 2017. <https://www.usip.org/sites/default/files/2017-03/sr402-returning-foreign-fighters-and-the-reintegration-imperative.pdf>.

Hummer, Liz. “Youth and Consequences: Unemployment, Injustice and Violence”. Mercy Corps, 2015. <https://www.mercycorps.org/research-resources/youth-consequences-unemployment-injustice-and-violence>.

Idris, Iffat, with Ayat Abdelaziz. *Women and Violent Extremism: Helpdesk Research Report*. GSDRC Help Desk Research Report, 2017. http://www.gsdr.org/wp-content/uploads/2017/05/HDR_1408.pdf.

Ivan, Raluca, and Donche Boshkovski *Deradicalisation in Prisons Projects in Western Balkans*. Council of Europe, 2018. https://www.era-comm.eu/radicalisation/kiosk/pdf/seminar_4/318DT65_8_Boshkovski_Ivan.pdf.

Jackson, Brian, Ashley Rhoades, Jordan Reimer, Natasha Lander, Katherine Costello, and Sina Beaghley. *Practical Terrorism Prevention: Reexamining U.S. National Approaches to Addressing the Threat of Ideologically Motivated Violence*. RAND. 2019. https://www.rand.org/pubs/research_reports/RR2647.html.

Khalil, James, and Matine Zeuthen. *Countering Violent Extremism and Risk Reduction: A Guide to Programme Design and Evaluation*. RUSI, 2016. https://rusi.org/sites/default/files/20160608_cve_and_rr.combined.online4.pdf.

Knudsen, Rita Augestad. “Measuring Radicalization: Risk Assessment Conceptualisations and Practice in England and Wales”. *Behavioral Sciences of Terrorism and Political Aggression*. 2018. <https://www.tandfonline.com/doi/full/10.1080/19434472.2018.1509105>.

Koehler, Daniel. *Understanding Deradicalization Methods, Tools, and Programs for Countering Violent Extremism*. Abingdon, UK: Routledge. 2016.

———. *Using Family Counseling to Prevent and Intervene Against Foreign Fighters: Operational Perspectives, Methodology and Best Practices for Implementing Codes of Conduct*. Middle East Institute, 2014. <https://www.mei.edu/sites/default/files/Koehler.pdf>.

Koller, Sofia. *International Tour d'Horizon of Tertiary Prevention of Islamist Extremism*, InFoEx Workshop, Berlin. German Council on Foreign Relations. 2019. <https://dgap.org/en/think-tank/publications/dgapreport/international-tour-dhorizon-tertiary-prevention-islamist>.

Lipsey, Mark. "The Primary Factors That Characterise Effective Interventions with Juvenile Offenders: A Meta-analytic Overview". *Victims & Offenders* no. 4 (2009): pp. 124–47.

Lloyd, Monica. *Extremism Risk Assessment: A Directory*. Centre for Research and Evidence on Security Threats (CREST), 2019.

Lopes, Marta, and Simon Dukic. "Repatriation of Foreign Terrorism Fighters: Cases for the West, European Eye on Radicalization." *European Eye on Radicalization*. 2019. <https://eeradicalization.com/repatriation-of-foreign-terrorist-fighters-cases-for-the-west/>.

Losel, Friedrich, and Martin. Schmucker. "The Effectiveness of Treatment for Sexual Offenders: A Comprehensive Meta-Analysis". *Journal of Experimental Criminology* no. 1 (2005): pp. 117–46. <https://link.springer.com/article/10.1007%2Fs11292-004-6466-7>.

Mankkinen, Tarja. *Proposal for Arranging Cross-sectoral Cooperation on Managing Returnees from Conflict Zones Including a Proposal for Combining NGOs' Services with the Action of the Authorities*. Finland Ministry of Interior, 2017. <http://julkaisut.valtioneuvosto.fi/handle/10024/79612>.

Marsden, Sarah. *Reintegrating Extremists: "Deradicalisation" and Desistance*. New York: Palgrave. 2017.

Marsden, Sarah, Kim Knott, and James Lewis. *Countering Violent Extremism: An Introduction*. Centre for Research and Evidence on Security Threats (CREST), 2017. <https://crestresearch.ac.uk/resources/countering-violent-extremism/>

Morton, Jesse, and Mitch Silber. *When Terrorists Come Home: The Need for Rehabilitating and Reintegrating America's Convicted Jihadists*. Counter Extremism Project. 2018. https://www.counterextremism.com/sites/default/files/CEP%20Report_When%20Terrorists%20Come%20Home_120618.pdf.

Ndung'u, Irene, and Mothepa Shadung. *Can a Gendered Approach Improve Responses to Violent Extremism?*. Institute for Security Studies. 2017. <https://issafrica.s3.amazonaws.com/site/uploads/aitwr-5.pdf>.

Presidency of the Council of Ministers, Lebanon. *National Strategy for Preventing Violent Extremism*. 2018. http://www.pvelebanon.org/Resources/PVE_English.pdf.

Public Safety Canada. *National Strategy on Countering Radicalization to Violence*. 2018. <https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrscs/pblctns/ntnl-strtg-cntrng-rdclztn-vlnc/index-en.aspx>.

Regional Cooperation Council. "A Waiting Game: Assessing and Responding to the Threat from Returning Foreign Fighters in the Western Balkans." 2017.

Renard, Thomas, and Rik Coolhaet, eds. *Returnees: Who Are They, Why are They (Not) Coming Back and How Should We Deal with Them? Assessing Policies of Returning Foreign Terrorist Fighters in Belgium, Germany, and The Netherlands*. Egmont Paper 101. Egmont Institute: 2018.

Republic of France. “Prevent to Protect” — National Plan to Prevent Radicalisation. 2018.

Richardson, C. et al. “The Role of Sport in Deradicalisation and Crime Diversion.” *Journal for Deradicalization*. 2017/18.

Rosand, Eric. *Civil Society Organisations in Preventing and Countering Violent Extremism in the Western Balkans: Mapping Report*. Forum MNE, 2019. https://organizingagainstve.org/wp-content/uploads/2019/02/regional_report.pdf.

Rosand, Eric, and R. Skellett. “Connecting the Dots: Strengthening National-Local Collaboration in Addressing Violent Extremism”. *Lawfare (blog)*, 2018. <https://www.lawfareblog.com/connecting-dots-strengthening-national-local-collaboration-addressing-violent-extremism>.

Royal United Services Institute and CIVIPOL Conseil. *EU Operational Guidelines on the Preparation and Implementation of EU Financed Actions Specific to Countering Terrorism and Violent Extremism in Third Countries*. European Commission, 2017. https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/eu-ct-cve-guidelines-20171213_en.pdf.

RTI International. *Countering Violent Extremism: The Application of Risk Assessment Tools in the Criminal Justice and Rehabilitation Process*. 2018. https://www.dhs.gov/sites/default/files/publications/OPSR_TP_CVE-Application-Risk-Assessment-Tools-Criminal-Rehab-Process_2018Feb-508.pdf.

Shapiro, Jake. *Faith and Art: Innovation in CVE (blog)*. *International Center for Religion and Diplomacy Blog*. 2018. <https://icrd.org/faith-and-art-innovation-in-cve-opinion/>.

Shtuni, A. “Western Balkans Foreign Fighters and Homegrown Jihadis: Trends and Implications”. *CTC Sentinel*, August 2019. <https://ctc.usma.edu/app/uploads/2019/08/CTC-SENTINEL-072019.pdf>.

Souris, Elena, and Spandan Singh. “Want to Deradicalize Terrorists? Treat Them Like Everyone Else?” *Foreign Policy*, November 2018. <https://foreignpolicy.com/2018/11/23/want-to-deradicalize-terrorists-treat-them-like-everyone-else-counterterrorism-deradicalization-france-sri-lanka-pontourny-cve/>.

Swedish Federal Government. “Actions to Make Society More Resilient to Violent Extremism”. *Communication no. 2014/15:144*. 2015. <https://www.government.se/contentassets/ef243295e51d4635b4870963b18bfa89/actions-to-make-societymore-resilient-to-violent-extremism-2014-15-144.pdf>.

Swiss Federal Government. *National Action Plan to Prevent and Counter Radicalisation and Violent Extremism*. 2017. <https://www.news.admin.ch/news/message/attachments/50703.pdf>.

Tapley, Marina, and Gordon Clubb. *The Role of Formers in Countering Violent Extremism*. ICCT, 2019. <https://icct.nl/wp-content/uploads/2019/04/ICCT-Tapley-Clubb-The-Role-of-Formers-in-CVE-April2019.pdf>.

Uhlmann, Milena. *Evaluation of the Advice Centre on Radicalisation - Final Report. Research Report. German Federal Office for Migration and Refugees, Research Centre – Migration, Integration and Asylum*. 2017. https://www.bamf.de/SharedDocs/Anlagen/EN/Publikationen/Forschungsberichte/fb31-evaluation-beratungsstelle-radikalisierung.pdf?__blob=publicationFile.

United Nations Development Programme. *Journey to Extremism in Africa: Drivers, Incentives, and the Tipping Point for Recruitment*. 2017.

United Nations General Assembly. Seventieth Session. *Plan of Action to Prevent Violent Extremism: Report of the Secretary-General*. 2015.

United Nations Office of the High Commissioner for Human Rights. “Human Rights and Counter-Terrorism: UN Special Rapporteur on the Promotion and Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms While Countering Terrorism Concludes Visit to Belgium”. News release, 31 May 2018. <https://www.ohchr.org/en/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=23164&LangID=E>.

United Nations Security Council Resolution 2396. 2017.

United States Government. *National Strategy for Counterterrorism of the United States of America*. 2018.

Van der Heide, Liesbeth, and Bart Schuurman. “Reintegrating Terrorists in The Netherlands: Evaluating the Dutch Approach”. *Journal for Deradicalization*, no. 17, 2018/19. <http://journals.sfu.ca/jd/index.php/jd/article/view/179/134>.

Van der Heide, Liesbeth, Marieke van der Zwan, and Maarten van Leyenhorst. *The Practitioner’s Guide to the Galaxy: A Comparison of Risk Assessment Tools for Violent Extremism. International Centre on Counter-Terrorism (ICCT)*, 2019.

Veldhuis, Tinka. *Reintegrating Violent Extremist Offenders: Policy Questions and Lessons Learned. Occasional Paper. George Washington University Program on Extremism. October 2015*. <https://extremism.gwu.edu/sites/g/files/zaxdzs2191/f/downloads/Veldhuis.pdf>.

Violence Prevention Network and the RecoRa Institute. *The Art of Seeing Promise over Risk: Perspectives from the European Practice Exchange (EPEX)*. 2019. <https://www.issuelab.org/resources/35086/35086.pdf>.

Winterbotham, Emily, and Elizabeth Pearson. “Different Cities, Shared Stories: A Five Country Study Challenging Assumptions around Muslim Women and CVE Interventions.” *RUSI Journal*, November 2016. <https://rusi.org/publication/rusi-journal/different-cities-shared-stories-five-country-study-challenging-assumptions>.

YouthPower. “Promising Practices in Engaging Youth in Peace and Security and P/ CVE”. September 2017. <https://static.globalinnovationexchange.org/s3fs-public/asset/document/Peace%20and%20Security%20Brief%209-21-17%20PRINT%20FINAL-OK.pdf?dV0v5HTaHk3AnPea6AL3145G5XbIJ2A0>.

**Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë**

Wallnerstrasse 6
A-1010 Vienna, Austria
Tel.: +43 1 514 360

pm@osce.org
www.osce.org

Ndiqni OSBE-në



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë